


LISANDRI KOLA



Deri kur me u përrallë me veprën
e Fishtës?

Pjesa e parë
(A-N)



Lisandri Kola

Deri kur me u përrallë me veprën e Fishtës?

Pjesa e parë
(A-N)

© i këtij botimi *Kolana Këns / Këns Collection-Michigan, 2023*

www.kens.al

Riprodhimi, kopjimi, skanimi a elementë të tjerë që çojnë në cenimin e pronësisë intelektuale të kësaj vepre janë rreptësisht të ndalueme. Shpërndamja e çdo sasive teksti ndalohet në çfarëdolloj forme të mundshme, pa autorizimin përkatës të bartësit e të drejtave autoriale.



Kolana

KEN'S

Shkurtime

BF – Botimet Françeskane

Bu. – Busetti

Antonio Busetti S.J.
(compilato dal) *Vocabolario Italiano-Albanese*, Scutari D' Albania: Tipografia dell'Immacolata, 1911.

BuF.-Ro. – Bufli & Rocchi

Gjorgji Bufli dhe Luciano Rocchi, *A Historical-Etymological Dictionary of Turkisms in Albanian (1555-1954)*, EUT: Edizioni Università Di Trieste, 2021.

bks. – bosnian-kroato-serbisht

De. – Dema

Át Benedikt Dema, O.F.M., *“Fjalori i fjalvet të rralla shqipe e i fjalvet të hueja të perdoruna në vepren e Át Gjergj Fishtës “Lahuta e Malcís” në Át Gjergj Fishta, O.F.M. Lahuta e Malcís/Mojs Golemi i Dibers e Delì Cena*, Shkodër: BF, 2021.

De.2 – Dema2

Át Benedikt Dema, OFM, *Fjalori Historik - Gjeografik - Mytologjik i “Lahutës së Malcís”*, Shkodër: BF, 2021.

Diz. – Dizdari

Tahir N. Dizdari, *Fjalor i orientalizmaeve në gjuhën shqipe*, Instituti shqiptar i mendimit dhe i qytetërimit islam (AIITC); Organizata islame për arsim, shkencë dhe kulturë (ISESCO), Tiranë, 2005.

El.-Ma. – Elsie & Mathie-Heck

The Highland Lute, NY: I.B. Taurus & CAS, 2005.

etc. – et cetera [etj./e të tjerë]

FGJSH – *Fjalori i Gjuhës Shqipe* [version elektronik]

fig. – figurativisht, në kuptimin figurativ etc.

Fj. Bashk. – Fjalori i Bashkimit

Fialuer i Rii i Shcypés [Perbâam prëie Shocniét t' Bashkimit], Shkoder, 1908.

fo. – folje

fr. – frangisht

f. v. – fjala vjen

gr. – greqisht

Gje. – Gjeçaj

Át Daniel Gjeçaj (ed.), Gjergj Fishta, *Lahuta e Malcís*, bot. II, Romë: Urbinati, 1958.

ita. – italisht

khs. – krahaso

KLD – *Kanuni i Lek Dukagjinit*.

Át Shtjefen Gjeçovi, OFM, *Kanuni i Lek Dukagjinit*, BF (botim anastatik), Shkodër, 2010.

Kol. – Kolgjini

Tahir Kolgjini, *Shpalime rreth Lahutës* [Shpalon disá fjalë shqip të përdoruna në "Lahuta e Malcís"], Istanbul, 1969.

kom. – kompozitë / fjalëformim

Kras. – Krasniqi

Abidin Krasniqi (Traduit de l'albanais par). Gjergj Fishta, *Le Luth des Montagnes (Lahuta e Malcís)* - Une épopée albanaise. L'Harmattan, 2019.

HD – *Hylli i Dritës*

HL – *The Highland Lute* (Elsie & Mathie-Heck trans.)

Lam. – Lambertz

Max Lambertz (Übers., eingel. u. mit Anm. vers. von). Gjergj Fishta, *Die Laute des Hochlandes (Lahuta e Malcís)*. München: Oldenbourg, 1958.

lat. – latinisht

LM – *Lahuta e Malcís* [1937, 1958, 2020]

Lu. – Luka

David Luka, *Magjia e fjalës te vepra 'Lahuta e Malcís' e atë Gjergj Fishtës*, SGJ XV, Shkodër, 2012.

mb. – mbiemën

MG – *Mojs Golemi i Dibërs e Delì Cena*

ndajf. – ndajfolje

neo. – neologjizëm

Pa.1 – Parrino¹

P. Giorgio Fishta, O.F.M.,
*Il Liuto della Montagna - Lahuta
E Malcís* (Prefazione,
Commento, Traduzione e
Note di P. Ignazio Parrino)
Fascicolo Primo: Prefazione e
Canti 1-5. Palermo, Centro
Studi Internazionale di Studi
Albanesi, Scuola Grafica
Salesiana, Palermo, 1968.

Pa.3 – Parrino³

ibid., fascicolo terzo: 1971.

përkth. – përkthim/-i, etc.

p.sh. – për shembull

s. a. – sine auctore [pa
autor]

s. d. – sine datum [pa
datë]

SE – Studime Etimologjike

SGJ – Studime Gjuhësore

s. l. – sine loco [pa vend
(botimi)]

sh. – shumë

shën. – shënim/-i

To. – Topalli, Kolec

Kolec Topalli, *Fjalor
etimologjik i gjuhës shqipe,
Qendra e Studimeve
Albanologjike, Instituti i
Gjuhësisë dhe i Letërsisë,
Tiranë, 2017.*

tos. – toskërisht/-e

turq. – turqisht

v. – vargu

vs. – versus [përballë,
kundrejt]

vv. – vargjet

0. Objekti i trajtimit

Ky punim ka në fokus një analizë përimtuese të *Fjalorit të veprës së Fishtës*, me autor z. Frano Kullin (Botimet Fishta, 2021, 288 ff.), në raport me integrimin dhe shpjegimin e leksikut të *Lahutës së Malcís*. Më 13 janar, 2022 në një televizion shqiptar pata ndjekë një intervistë të z. Kulli në lidhje me punimin e tij. Ajo çka m'është vëmendjen, në krye të herës, ishte mungesa e disa titujve bibliografikë, që nuk ishin shqyrtuar për me e përpiluar fjalorin z. Kullit. Mbase sigurova tekstin e këtij të mbramit, vëna re se dyshimi im ishte i saktë. Zotnia në fjalë, në referencat e tij nuk ka kontributin e Padër Daniel Gjeçajt, Padër Benedikt Demës dhe të David Lukës, që janë marrë drejtpërdrejt me fjalorin e *Lahutës* dhe të Fishtës, po as të Eqrem Çabejt, i cili ka përfshirë fjalë prej leksikut fishtian tue e kriptuar autorësinë—tue lanë vetëm vargjet pa autor. Pra, pa e tjerë ma hollë, mungojnë shënimet e Gjeçajt në bot. II të *LM*, (Romë, 1958); vepra e Át Benedikt Demës, OFM, *Fjalori Historik - Gjeografik - Mytologjik i "Lahutës së Malcís"* (Shkodër: Botime Françeskane, 2021); veprat e David Lukës, *Magjia e fjalës te vepra 'Lahuta e Malcís' e atë Gjergj Fishtës*, SGJ XV (Shkodër, 2012), *"Fjalorth i fjalëve të rralla në veprën 'Anzat e Parnasit' të Gjergj*

Fishtës", SGJ IX (Shkodër, 2006, 36-76), si edhe *Studimet Etimologjike të Çabejt*.¹

Kishte me qenë barrë e madhe për mue, por edhe me hangër ma shumë tallash se ç'hangra me u marrë me krejt krahasimet e mundshme mes Frano Kullit dhe autorëve të masipërm. Prandej, e kam kufizue kandvështrimin e këtij punimi kryesisht ndërmjet Lukës, Gjeçajt e Kullit, si edhe të disa punimeve të tjera, si Fjalorët e *Bashkimit*, Demës² etc. në raport me leksikun e *LM*. Pra, në interesin tim kërkimor asht vetëm analizimi i leksikut të *LM* në fjalorin e Kullit.

¹ Për ma shumë shih D. Luka, "*Fishta në Studimet Etimologjike të Çabejt*" në David Luka, SGJ VII (Shkodër: Camaj-Pipa, 2002), 69-71.

² Në lidhje me *Fjalorin Historik - Gjeografik - Mytologjik i "Lahutës së Malcís"* të Át Benedikt Demës, OFM (si edhe krahasimin mes këtij e Kullit) kam folë në një shkrim tjetër ndërkohë.

0.1. Dobia e një fjalori të veprës së Fishtës

Hartimi i një fjalori të veprës së Fishtës teorikisht ofron kodin e zbërthimit të fjalëve, një pjesë sosh arkaike ose metagrafe të arkaizueme, idiolekte por edhe variante nëndialektore si edhe leksik i huazuem prej disa gjuhëve, kryesisht turqishtes dhe sllavishtes. Përndryshe, referue “ankesave” akademike se Fishta nuk kuptohet, hartimi serioz i një fjalori të tillë e ban veprën e Poetit “të kuptueshme”. E kam thanë dhe herë tjera, se ky autor asht po aq i kuptueshëm sa ç’asht Naim Frashëri, sikurse Koliqi po aq sa Kuteli.³ Shpjegue në një përmasë tjetër, dasia kulturore mes dy varianteve gjuhësore të shqipes ose të një geqe dhe të një toske asht reciproke.

Për sa ma sipër, publikut shqiptar dhe atij shqiplexues u duhet sqarue se *Lahuta e Malcís* asht

³ Khs. “*Ne jemi të ndërgjegjshëm se Fishta ‘mund’ të ketë po aq probleme sa Naimi në lexim, ose Koliqi po aq sa Kuteli. Po të gjithë janë autorë të një letërsie kombtare, e nuk kanë asnjë problem në lexim. Sigurisht nuk mund ta bajmë ‘Lahutën’ as ‘Vjeshtën e Xheladin Beut’ si ‘Kronikë në gur’ (po flas në aspekt gjuhësor)*”, në Lisandri Kola në “*Gjergj Fishta në landfillin e letërsisë shqipe*” (Sbunker: 2018), <https://sbunker.net/op-ed/89770/gjergj-fishta-ne-landfillin-e-letersise-shqipe/>

shoshitë leksikisht pothuejse deri në përsosje nga Gjeçaj, Dema e Luka si edhe Kolgjini, i cili ka dhanë një ndihmesë të çmueshme. Problem del me veprat e tjera madhore të Fishtës, kryesisht në *Satirë* e sidomos *Gomari i Babatasit*. Mandej, shkrimet e tjera publicistike apo korrespondencat mbesin ma periferike në tanësinë e veprës së Fishtës. Sa i përket kryeveprës epike të Poetit (*LM*), asht detyrë e vonueme filologjike dhe editoriale që ajo nuk asht përditësue me komentat përkatës nga Botimet Françeskane. Fretnit shqiptarë gëzojnë një traditë sa shekullore në vadën e letrave, dhe autorë si P. V. Volaj e P. B. Dema, tue shtue dhe P. D. Gjeçajn mbesin komentuesit ma në za të veprës së Gjergj Fishtës. Prej te komentuesit e mbramë të *Lahutës*, Gjeçaj e Dema na ndajnë ndërmjet 6-8 dekada. E kur tradita nuk trashëgohet nga vetë Fretnit e mbaskomunizmit në këtë rast, asht matuní dhe detyrim me ua besue këtë barrë profesionistëve në këtë fushë.⁴

Ndërkohë, në lidhje me këtë vepër ka pasë kontribute të tjera në Diasporë, nga Kolgjini (alias

⁴ Nuk po e njehi këtu, se këtë gja e ka ba enti botues i Kullit, sepse kemi të bajmë me rast të paprecendent antishkencor. Në vijim ky mendim do të shtjellohet si duhet besoj.

Lok Limthi) apo autorë të tjerë që janë kufizue me artikuj shkencorë. Mbas viteve '90, në Shqipni e Kosovë, por edhe ma gjanë, interpretimi shkencor mbi poemën epike *LM* asht rritë ndieshëm, kjo për arsye se gjatë diktaturës komuniste shqiptare Fishta ka qenë i ekskomunikuem, i ndaluem, edhe pse në Kosovë asht lexue në kushte ma të zbutuna politike. Drejtpërdrejt mbi leksikun e *Lahutës*, para Kullit, vepra e fundit e botueme asht ajo e D. Lukës në 2012. Tek secila që përmenda ma nalt, ka vend me shtue e me përmirësue sepse të tilla janë ligjet e filologjisë. Në rrafsh krahasues, për me ndihmue interpretimin e fjalorit të Fishtës në *Lahutë* nuk kishin me u përjashtue as punët integrale të përkthyesve në anglisht, italisht, gjermanisht e frangisht. Sfida shkencore me të cilën duhet të përballet filologu ose grupi kolegjal, kam bindjen se asht e vështirë. Në krahun tjetër, Fishta nuk asht aq i motnuem sa Buzuku dhe assesi volumi pa kriter i shënimeve nuk duhet me u ba argument kinse shkencor, sepse priremi drejt një kahshikimi abuziv. Me shpjegue për lexuesin (e standardizuem ose këdo jোগegë) dallime elementare fonetike që me shtue listën e fjalëve, asht metodë antishkencore. Kjo nuk i ndihmon aspak

evoluimit të një filologjie të shëndoshtë shqipe.⁵ Këtë problem, disi të përafërt, e ka rrahë edhe David Luka lidhur me komentarin e “Entit Botues Poligrafik Fishta” krye asohere nga Tefë Topalli.

Blue ma hollë, krejt sa pohova, kishin me i ba Fretnit orientues të denjë të vlerave kombtare ku nuk dhunohet as nuk shkryhet vepra e Fratit ma të madh shqiptar. Kështu mësuesit anekand komuniteteve shqipfolëse kishin me ditë si me i edukue nxanësit dhe gjimnazisti qoftë edhe ai në Shkodër a në Lezhë, kishte me i lexue të paktën dy kangë fillim e mbarim prej 30, edhe pse e ka [ose e ka pasë të paktën deri para dhetë vjetëve] në plan mësior simbas profilit përkatës që përzgjedhë në degën shoqnore, me sa kujtoj, krejt *Lahutën*.

Nëse qëllimi i një shtëpie botuese asht vetëm me shtypë dorëshkrime apo rishtypë libra, e me ekzistue si edicione paralele në tregun e librit

⁵ Përtej kësaj, ndër shqiptarë gjenden një grup studiuesish që e kanë interpretue Gjergj Fishtë mbrenda disa sinoreve “të receptimit në letërsinë shqipe” që e klasifikojnë si të vjetruem [përkatësisht autor stili] dhe jo autor kombtar e soj “teknikash komparative” me autorë të Ballkanit, që me e reduktue veprën e Fishtës sidomos ndër sivëllaznit sllavë. Shih për ma shumë Lisandri Kola, “Gjergj Fishta në landfillin e letërsisë shqipe” (*Sbunker*: 2018).

shqiptar, atëherë misioni i saj asht i pathemeltë. Nji shtëpi botuese, simbas meje, sidomos ajo e Fretënve që janë Guttenbergu i kulturës shqipe, duhet me qenë liderë në orientim kulturor, dhe referencialë për autorët e shkollës së vet. Krahas botimeve prej Fretënve të vjetër, që kanë përshenjue letërsinë tradicionale shqipe, Fretnit e sotëm asht e mira me i lanë hapësinë kritikës dhe frymës bashkëpunuese-progresive me studiues e akademikë kudo nëpër botë, sepse siç thoshte Poeti *“Forca tok – s’ bahet rrcok”*.

Ndërkaq, e ma konkretisht, prej këtyne hymjeve—sintetike—teorike, ajo çka mbetet me u pá në lidhje me objektin e trajtimit të këtij punimi asht aspekti praktik sesi asht realizue fjalori i Kullit. Sythet ma poshtë rendisin idetë dhe vëzhgimet e mia, të cilat për kah analizimi i landës së fjalorit si edhe i kuadrit studimor muerën ma shumë kohë fizike seç e pata parashikue në krye.

0.2. Metoda e përpilimit të fjalorit të Frano Kullit

Autori i fjalorit të Fishtës, ka ndjekë një metodë pune, të cilën përpiket me e shpjegue qysh në krye të punimit përmes disa “rregullave bazë”. Kulli thotë se për çdo fjalë/shprehje janë shënue veprat e Fishtës ku janë përdorë. Kjo edhe pse ndodhë të shumtën e rasteve (jo të gjitha fjalëve u janë shënue me rigorizitet përkatësitë e veprave të Fishtës), lexuesi nuk e ka të mundun numrin e faqes/-ve ku regjistrohet fjala. Aq ma tepër, kur vjen puna te *Hylli i Dritës e Posta e Shqypniës*, ku nuk dihet as titulli i shkrimit përpos faqes/-ve. Sa i takon veprës poetike, në atë kohë kur nuk shënohet vargu gjegjës—d.m.th. në pjesën dërrmuese të fjalorit të Kullit—lexuesi pengohet prej kontekstit të drejtë, tue u abuzue shpesh me shpjegimin por edhe tue u keqkuptue prej vetë përpiluesit, siç kemi me pasë mundsia me e vû re ma poshtë. Po kështu, Kulli thotë se shêjat diakritike janë përdorë aty ku ka qenë e domosdoshme; pra, simbas tij e jo simbas Fishtës. Se sa ekzigjent ka qenë edhe në këtë kriter që ka ndjekë, ka me u pá. Kulli thotë se ka shpjegue edhe neologjizmat e Fishtës, por në të vërtetë, vetëm prej

Lahutës mungojnë saesa nelogjizma të formueme përmes kompozitash. Nësa për fjalët me burim prej turqishtes, ai thotë se ka rrujtë kontekstin kohor të përdorimit të tyre, e i asht referue edhe *Shpalimeve* të Tahir Kolgjinit. Ndërkohë, Lok Limthin (pseud. i Tahir Kolgjinit), që pat botue në *Shêjzat*, “*Fjalë turkisht ose t’ardhuna me ânën e turkishtes të përdoruna në ‘Lahuta e Malcís’*” [A-D]. – V/1961, nnr. 3-4, 86-92; [D-H]. – V/1961, nnr. 5-6, 161-165; [H-Q]. – V/1961, nnr. 9-10, 326-335. [Q-Z]. – VI/1962, nnr. 1-2, 61-67, nuk e xën kund n’gojë.⁶ P.sh. fjala e parë *adalet*, që del te Lok Limthi, dhe i cili e shpjegon “*Adalet Em. arab. (adalet) = Drejtësi, e kundërta e shtrëmbëtësis. Kjo fjalë, në malet e Shqipnis së Veriut, asht përdorun për damtime të randa, shkatrrime të mëdhaja: për masa të përmbarueme me ashpërsí*” nuk del ma vonë aspak në *Shpalimet* e 1969. Megjithëse Kulli e shpjegon në fjalorin e tij, në faqe të parë, ai e konsideron këtë leksemë si të përdorun vetëm të *Anzat e Parnasit* dhe te *Gomari i Babatasit* (Visku). Ndërkohë, kjo fjalë del në *LM* dy herë në të njeften kangë: “*Shum m’ askjer bân do adalet’*” (XXVIII, v. 569) si dhe “*Per shka don me bâ adalet’*” (v. 652). Me pasaktësi të tilla asht e

⁶ *Shêjzat*, po atë vjetë (1961) e patën botue si separat këtë cikël punimesh.

mbushun vepra e Kullit. Në këtë rast, e disa të tjerë, besoj se Lok Limthi kishte me i ardhë gjithsesi në ndihmë Kullit. Po ndalem jo ma larg se te fjala e dytë e Lok Limthit, për *aferim* i cili e konsideron si fjalë të persishtes e nësa Kulli të turqishtes. Natyrisht edhe për këtë rast duhet me pasë përgatitje profesionale, mbasi dihet se një pjesë e fjalëve turke janë me burim arab e pers. Për këtë ndoshta ishte dashtë me konsultue ma me zell Tahir N. Dizdarin dhe veprën e tij *Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe*,⁷ e cila del si referencë bibliografike te Kulli, por jo e shqyrtueme ngultas.⁸ Për veprën e Gjorgji Buflit dhe Luciano Rocchi, *A Historical-Etymological Dictionary of Turkisms in Albanian (1555-1954)*, EUT Edizioni Università Di Trieste, 2021 s'po e fajisë kush se asht botue tash së voni. Ndoshta në të ardhmen, Kulli ka me e pasë parasysh, mbasi këta autorë i referohen Fishtës shpesh në shpjegimin e fjalëve me burim turk.

⁷ Botue nga Instituti shqiptar i mendimit dhe i qytetërimit islam (AIITC); Organizata islame për arsim, shkencë dhe kulturë (ISESCO: Tiranë, 2005).

⁸ Në lidhje me T. N. Dizdarin, po shtoj se fjalën *aferim* e konsideron si turko-perse [mandej me përhapje në serbokroatisht, bullgarisht e rumanisht]. Madje ky citon dhe vargun prej *Oso Kukës*, ku përdoret kjo fjalë (shih, 5).

0.3. E meta e parë e fjalorit

Në pamje të parë, kontributi i Kullit (edhe pse jo leksikograf, e për këtë nuk e paragjykoj, mbasi as vetë s'jam i tillë), duket sensacional sepse merr në shqyrtim "krejt" leksikun e veprës së Fishtës, me gjithë fjalët e rralla, shprehjet frazeologjike, fjalorin historik-antroponimik-toponomastik e atë mitologjik. Don me thanë, punë bukur e zorshme për 'i burrë mishit! Gjithqysh, Kulli ia ka hy kësaj punë, për fatin e keq tue përdorë kolanën e tij të Fishtës, e cila s'do mend se asht e përcudnueme. Më lejoni, këtu me thanë se unë u bashkohem qëndrimeve të Padër Zef Pllumit, të shprehuna në artikullin e tij "*Falsifikatorët e veprës së Gjergj Fishtës*" (*Republika*, 18 maj, 2002, 14) si edhe të David Lukës, shprehë intensivisht në veprën e tij. Në vitin 2010, kur kam botue studimin tim *Satira në epikën fishtiane*,⁹ (Shkodër: Camaj-Pipa), në lidhje me edicionin Gjergj Fishta, *Vepra 4 – Epika*, EBP 'Gjergj Fishta' & Bibliotheca Gollettiana, 2002 jam shprehë: "*Ndërhymjet në tekstit e Fishtës, mjerisht, nuk asht se kanë ndreqë veçse përkeqë. Teksti i tij duhet të na vijë simbas botimit të parë. Madje me çdo gabim, mbasi vepra*

⁹ Vepër finaliste në konkursin e *Çmimeve Kombëtare për Letërsi 2010*, në kategorinë e kritikës. Shih *Shekulli*, e premte, 14 janar 2011, 21.

*prodhim njerëzor asht, e gabimi asht i pranueshëm.*¹⁰ Asokohe, i jam referue pjesërisht botimit të Kullit (2002), për me shpjegue disa fjalë prej epizodit të poemit “*Mojs Golemi i Dibres e Deli Cena*”, tue qenë se deri në atë kohë ato ishin kontributet mbi fjalorin e Fishtës. Por, asnjherë kolanën e këtij enti botues nuk e kam sugjerue, as kur kam dhanë mësim në gjimnaz,¹¹ se në universitet jo se jo.

Modifikimet tekstore të veprës së Fishtës, kanë dhunue çdo parametër poetik e strukturor të vargut, mos me thanë se kanë dhunue edhe të drejtën e *copyright*-it në 2002, para se vepra e Fishtës me u ba “public domain” në vitin 2010 (70 vjet mbas dekës së

¹⁰ L. Kola, *Satira në epikën fishtiane*, 120.

¹¹ Në një shkrim të 2015, “*Idhnim e t’çame krejte me t’ba me dalun fejet ose Fishtë, largomë Zot prej tejet*” [Sbunker, i pamundun të aksesohet online shkaku i një problemi të hershën të serverit portalit ku u pat botue], jam pasë shprehë, në lidhje me këtë eksperiencë “*Mbaj mend se qysh në orë të parë u pata thanë nxanësve që me pasë si tekst pune variantet anastatike të Botimeve françeskanë—meqenëse janë riprodhime të botimit të parë integral (1937)—e jo me u drejtue në disa botime të tjera të cilat janë falsifikime. Mbi këtë çështje asht një histori gjyqesh, e pasuksesshme duhet me thanë, sepse të njejtin (a të njejtët!) botim e shohim në shitore librash apo panairë të përvoitshëm qoftesh e librash. Madje botuesi për ma tepër, tash, i ka ba librat e Fishtës me lidhje të fortë. Si përfundim, askush nuk u fut të burg. Po, në burg për falsifikim. Mbase etnit françeskanë, juridikisht nuk ditën ta mbronin si duhet kauzën. Gjithsesi, ky turp raftë mbi të gjithë ne!”*

tij). Deri në atë kohë, 2010, ligjrisht Fretnit kanë qenë bartësit e vetëm për të drejtat e botimit në lidhjen me veprën e Fishtës. Kjo siglohet qartas në vitin 1942¹² në *Hyllin e Dritës*, e po ashtu në 1958¹³ në bot. II të *Lahutës* nga Gjeçaj si edhe mbrapa mbas 90-s nga Pllumi. Në dijeninë time, ka pasë një përballje ligjore, një vendim gjykate, sa i takon botimeve të Kullit kah vjeta 2002, por evidencat e duhuna publike mungojnë në këtë rast.

Sa i përket dhunimit integral të poemës në fjalë, po bie dy shembuj të vetëm prej punimit tim të 2010:

Ndreqësit e kanë keqkuptue vargun:
Edhe kali n'kâl kâ kasun, dhe e ka dhanë:
Edhe kali, n'kalë ka hasë, tue e pandehë
për gabim shtypi, e tue hupë kështu
edhe vlerat e aliteracionit. *Me kasë* don
me thanë me u çue përpjetë me dy
kambët e parme (dukuni që i gjegjet

¹² Shih “*Per njoftim! Provinçjalati Françeskan mban te drejten e plotë mbi veprën LAHUTA E MALCIS e mbi çdo veper tjeter të botueme prej Françeskanëve shqypetarë. – Prandej çdo rishtypje, edhe e pjesëshme, përkëthimet, ndërrimet, cungimet, kemi me i kerkue simbas së drejtës ligjore. At Anton Harapi, O.F.M. – Provinçjal i Françeskanvet.*” HD, 1/1942. Ky shënim në kolofon të revistës konsiderohet dhe ‘copyright data’ për LM në terma të sotshëm.

¹³ Shih frontespicin e LM (1958): “*Françeskajtë Shqiptarë në mergim ruejnë të drejtën e qëdo përkthimi a ribotimi*”.

kafshëve: kalit në këtë rast) dhe që e përplotë imazhin fishtian, sepse vargu që pason asht: *Parsmën m'parsme tue e përplasun*. Pra, me t'u ngritë kuajt qirithi, janë përplasë parzëm n'parzëm (142, fusnota 194).

Kurse për vargun tetërrokësh "*Me i pasë pasë ti nja 'i qind krena*" (në *Mojs Golemi...*), jam shprehë:

Tek varianti i këtij teksti [MG, shën. imi] në botimin e 2002-së: Gjergj Fishta. *Vepra 4 – Epika...* redaktorët e kanë paraqitë vargun në këtë trajtë: *Me i pasë ti nja 'i qind krena*, pra tue mendue se kemi të bajmë me një pasaktësi teksa asht shkruar poema. Por, ka mundësi që vargu të jetë i ndërtuëm me anën e kohës së përbame foljore, d.m.th sikurse asht paraqitë këtu, edhe pse shpesh te Fishta koha e përbame e foljes na shfaqet, bjen fjala, në këtë mënyrë: *Me i pá pasë ti nja 'i qind krena*. Ky varg njëkohësisht ruan edhe natyrën folklorike, ku shpesh koha e përbame foljore, me forcë të ndieshme të mënyrës habitore, del si tipar dallues. Po e njejtë dukuni na paraqitet edhe

tek përkthyesi Gjon Shllaku, në dy vargjet e Edipit: *Vërtet me nanën, siç kam dëgjue, / atë shtrat kobzi paske pasë shijue.* (131-2, fusnota 165).

Me përdorë një vepër të modifikueme e të falsifikueme ku asht shtrembnue pra vullneti autorial, doemos përvijimi i punës ka me dalë i mbrapshtë. Kështu z. Kulli në fjalorin e tij, ka ba ‘ë’ ku ka qenë ‘e’, ka shtue ‘ë’ kur s’ka qenë nevoja, ka ndërrue thekse simbas qejfit [*así* për *asi*; *belí* për *beli*; *bákeq* për *bákeq*, etc., Kulli: 6/12], ka ndërkallë grupe bashkëtingëlloresh kur s’kanë qenë, e me radhë plot sharte të tjera “*antishkencore*” që i quen me të drejtë Padër Z. Pllumi. Çka asht me u shënue, asht se tash njizetë e ma shumë vjet shtëpia botuese e Kullit, sa i takon veprës së Fishtës, ka prû shembullin ma atipik në botë për autorët klasikë. Imagjinoni sikur diçka e tillë me iu ba Dante-s, Goethe-s, a Shakespeare-t, etc.? Natyrisht që grupin e punës do t’i kishte pritë dera e gjykatës, me dy dyert kapak, me gjithë grada e tituj akademikë me vete. Kur tham *e gjykatës*, nuk parakuptoj institucionet e mefshta ligjore të Shqipnisë.

0.4. E meta e dytë

Kulli, si shumica e fjalorëve shqip mbas '72, e asgjason formën paskajore të foljes, tue i dhanë *vetë* e *përkatësi* asaj. Këtu nuk ia vlen me u ndalë, sepse kjo çështje asht e metë nacionale, jo individuale. Për habi, fjalori në fjalë asht i mbushun me gabime të renditjes alfabetike, çka edhe ta vështirëson leximin por edhe punën në shqyrtimin e fjalëve. Janë shumë inkonsekuenca të renditjes por unë po kufizohem në disa sosh: "*bumullon, búj*", "*burrnot, burraçoç*" (18), "*çok, çehre-suz, çek*" (25), "*fitme-ja, filuzë*" (49), "*kaçikërr-a, kacilitë-a, kaçirubë-a*: (79), "*méj, miri, m'ni-a (mëni), mengut*" (119), etc. Nji gabim tjetër elementar asht edhe rasti për germën **T**, ku Kulli ia nisë me renditjen alfabetike "*t'himit, t'hjedhta, t'pakët, t'thatët*" (195), ndërkohë që dihet se trajta e shkurtë mbrapavëndohet ndër kllapa si p.sh. "*himit (t'), hjedhta (t'), pakët (t'), thatët (t')*". Pra me këtë paraqitje, këto fjalë do ta kishin pasë vendin ndër germa të tjera e jo te ajo **T**.

0.5. E meta e tretë

Përsëritja në shpjegim e së njejtës fjalë ndodhë rëndom te Kulli, madje edhe në të njejtën faqe. Kajherë shpjegohen pa vend edhe disa fjalë, të cilat kanë të njejtin kuptim, e bile do të ishte e udhës mos me u shpjegue hiç, si rasti i “kthejnë: *vinë*; ktheu: *u kthye*” (97). Edhe logjika ma normale e një nrxanësi paragjimmnazist e peshon se asht e tepërt me u shpjegue “ktheu: *u kthye*”. Pavarësisht se Kulli thotë që *përsëritjet* e së njejtës fjalë, të cilat gjenden në vepra të ndryshme të Fishtës, janë mënjantuanë ai vetë shumë herë vepron kështu: “ç’me: *që me, që nga...* HD_{P9}, PSH_{P10}” (23) vs. “ç’me: *që nga...* HD_{P9}” (25); “dejka-t: *zogj shtegtarë shumë të shpejtë në fluturim...LM*” (29) vs. “dejke-a: *shpend shtegtar...LM*” (31); “gverrë-a: *grindje, shamatë, zënka...AP*” (59) vs. “gverrë-a: *grindje, shamatë, zënie në një familje a rreth intim njerëzish. AP*” (60); “kjur: *dhomë e posaçme ku ruhet bulmeti. LM*” (90) vs. “kjuer (kjor): *quer, qilar, vend i ndarë për roje të ushqimeve gjatë gjithë vitit. AP*” (90)— pra i njejtë kuptim, edhe pse në një faqe dhe njëmbasnjë si fjalë. Po kështu, “londitë: *lëkundur, tundur. MZ*” (108) vs. “londitet: *lëkundet, tundet. GBv*” (108); “maklladë-a: *fjalë pa vlerë, dokrra, pallavra, gjepura, profka, kuvende të kota, broçkulla. LM,*

GB" (114) vs. "maklládash: fjalësh pa vlerë, dokrrash, pallavrash, gjepurash, profkash, kuvendesh të kota, broçkullash. HA" (114); "njeti: ngjeti, gjetiu... JE" (136) vs. "njeti: diku tjetër, gjetiu. HA, HD_{P9}" (138); "rrem-i: lopatë, lugatë e varkës. AP" (169) vs. "rrem-i: lopatë vozitjeje i¹⁴ barkës, lundrës. AP" vs. "rremi: lopatës. PSH_{P10}",¹⁵ etc. Abuzimi dhe papërgjegjësia profesionale, janë pak me thanë përpara kësaj "çudie" në fjalorin e Kullit. Pra, gjenden fjalë që shënohen identike, përsëriten (përfshî edhe rasën e emnit) dy a ma shumë herë, dhe që kanë të njëjtin kuptim. Si duket këto punë të bame hallagrep, i kanë shpëtue edhe redaktorit (sic) të kësaj vepre, ish profesorit tim, Prof. Dr. Emeritus Tefë Topalli.

¹⁴ Nyja simbas veprës së Kullit.

¹⁵ Shkurticat simbas Kullit janë: MZ: Mrizi i Zanave; VP: Vallja e Parrizit; PP: Poezi e Përkthyer; LM: Lahuta e Malcis'; JM: Juda Makabé; JE: Jerina; SHQ: Shqyptari i qytetnuem; HA: Hajria; AP: Anzat e Parnasit; NK: Nikolejda; TB: Taralloqja e Ballkanit; MA: Makeronjana; GB: Gomari i Babatasit; GBv: Gomari i Babatasit, Visku; HD_{P9}: Hylli i Dritës, Publicistika, Vëllimi 9; PSH_{P10}: Posta e Shqipni', etj., Publicistika 10; LSHK: Letërshkëmbimi.

0.6. E meta e katërt

Kryehabia në këtë vepër asht edhe se shpjegohen edhe fjalë pa qenë aspak në *LM*, ose të keqshkrueme. Fjala vjen, Kulli shënon se “cekatë: prerë pak. (**me ia cekatë**)- *trungun e pemës, prerë pak. LM* (21); “cekatun (i,) e: *i cekatur, i krisur, i luajtur mendsh. LM*” (21); “ndërlikuem (i,e): *ile ngatërruar. LM*” (130); *falké* (Kulli, 47 vs. *LM, falkue, XVIII, v. 323 + v. 726; XIX, v. 241; XXI, v. 107*); “*vasí-u (tq.): personi të cilit i është besuar me ligj kujdestaria. LM, AP*” (212); “*ulqe-ja: toka, prona e pushteti i mbretit të Stambollit. LM*” (209), janë pjesë e fjalorit të poemës *LM*, ndërkohë që asnjena fjalë nuk del në këtë vepër. Kurse për fjalën “*perivol-i: kopësht*”¹⁶ (**si cirkë voese n’perivol**) – *si pikë vese në kopësht. LM*” (146), autori e regjistron gabim si fjalë dhe si varg. Leksema në fjalë, në *LM* (1937), asht në shumës dhe vargu asht: “*Si cirkë voese n’ perivoj*” (XXV, v. 895). Qe pra ku del edhe një dukuní tjetër transformuese e kolanës së Kullit, njejësi bahet shumës për kurrjasend! Njikohësisht edhe xêvendsimet nëndialektore janë të dukshme, p.sh. Kulli thotë: “shkrehë: *ardhur, dyndur (ç’ká shkrehë sonte gjith ky mot* (fraz.) – ç’ka shpërthyer e gjithë kjo histori). *LM, PSH_{P10}*” (187). Po

¹⁶ Edhe pse standardi e njeh “*kopsht*”, në veprën e Kullit del me ‘ë’.

ta krahasojmë vargun në botimin origjinal-definitiv të LM, asht “Ç’ ká shkrefë sande gjith ky mot” (XVI, v. 2). Këtu pra “me shkrefë” simbas të folmes së Mirditës asht ba në pjesore “shkrehë”, dhe “sande” zakonisht e gropës së Shkodrës asht ba “sonte”. Shpjegimi asht jashtë kontekstit të vargut: shpjegimi i drejtë duhet të ishte “ç’ka shpërthye gjithë kjo stuhi”, sikurse Gjeçaj e pohon me të drejtë (LM, 1958, 249). Tash se ku lidhet moti (si dukuní atmosferike) me historinë këtë e din veç Kulli. E prapë, shpjegimi asht i paplotë sepse folja “me shkrefë” ka edhe kontekste të tjera në Lahutë si p.sh. “Por, si kripit i rá bora / E la kama e e la atê dora / Edhè i shkrefi armët besnike” (XII, vv. 27-9) që nënkupton “i hoq, i la armët, shkak i plakjes”. Gjanësisht njihet sot në përdorim “me e shkrehë atë punë, muhabet, etc.” aq sa edhe FGJSH e njeh si formulim frazeologjik. Siç duket, nuk kemi të bajmë vetëm me shndërrime fonografematike, por edhe keqlexime e keqinterpretime, ose shpjegime të paplota.

0.7. E meta e pestë

Fjalori i Kulli paraqet jo pak raste kur fjalët, e përdoruna në *Lahutë* dhe në kontekstin e poemës, ose janë shpjegue keq ose pjesërisht. Nji gja e tillë sjellë nji dam të konsiderueshëm në kuptimin e saktë të fjalës, por edhe rrëzon mundin e pararendësve që kanë përpilue dhe stabilizue fjalorët e veprës së Fishtës.

Kulli shpjegon “fjollë: *shtëllungë*. (*fjollë n’për hatulla*) – *shtëllungë nëpër pullaz*. LM” (50). Vargu i *Lahutës* asht: “*Porsì zjarm kur t’ marre shpija, / Fjollë nper hatlla tymi s’ pari / Deperton: e nper frangija*” (XXV, 404). Këtu fjala e shpjegueme asht për “*drejt, krejtiskrejt, pa pengesa*” (Lu., 102; Gje. 567), dhe “*hat(u)llat*” nuk janë “*pullaz*” por pjesa e ndërmjeme mes trënve e çatisë. Gjithsesi, Ku. në 69-70, e ndreqë shpjegimin përkatës për këtë fjalë, edhe pse pak faqe ma nalt shprehej ndryshe. Ma tej, Ku. “*gargullue: qeshur fort...LM*” (54) nji shpjegim si ai i Gjeçajt, në shembullin ma poshtë.¹⁷ Simbas Lu. (106) dhe De. (482), asht “*me imitue gargullin*”; pra studiuesit, në fjalë të tjera, sugjerojnë se kemi të bajmë nji folje prejemnore, nji neologjizëm fishtian. Khs. vargun e LM “*Amel n’ gaz tue gargullue / Si t’ këndojshtin n’ mal*

¹⁷ Shih edhe të tjerë shembuj që përkojnë mes kësaj nyje dhe nyjes 1, lidhun me afritë e shpjegimeve ndërmjet Ku. e Gje.

bylbylat" (XXIV, 365). Fjalën "*grrêç*" Kulli e jep me kuptim të pjesshëm, tue e quejtë vetëm si "*enë ku futet qumështi ose hirra. LM*" (59). Kjo fjalë parakupton një kungull uji, në funksionin e një ene, shishe' (*Fj. Bashk.*, 133) e cila përdoret për me shfí produkte të ndryshme bulmeti. Kulli i asht referue vetëm kuptimit të drejtpërdrejtë të fjalës në *Lahutë* (khs. "*Si grreç kjumshti i mbet rrashta*", XX, v. 348), tue mënjane kuptimin figurativ. Fishta në vargjet "*Mu m'grrêç t'krës atij i a njiti: Tamth e m'tamth plumen i a qiti!*" (XXIII, 329), nënkupton "*rrashtën e kresë, kaploqen*" (shih edhe Lu. 109, Gje. 470, Kol. 71/4). Për foljen "*me u hamullue*"¹⁸ Ku. jep një shpjegim të pjesshëm kur thotë "*hamullohen: zihen, ngarriten. LM*" (67), por kuptimi figurativ asht me u lëshue si i dishruem (zakonisht në ushqim, *Fj. Bashk.* 152; De. 484; Lu. 116), por edhe me iu vërsulë, derdhë tjetrit mbi shpinë (Lu. 116, Kol. 80/2,c).

Edhe fjala "*harmagjik*" (shih nyjën 1), te Ku. del në kundërshti me disa shpjegime paraardhëse. Kështu, De. (485), Kol. (81/1), Lu. (117) e shpjegojnë si "*qepë, presh*" e jo si ambëlsinë te Gje. e Ku. Në *Lahutë*, del vetëm njëherë ky emën "*Hudra, djathë e harmagjikë*" (XXI, 287). Po njilloj fjala "*inqindi*" (shih

¹⁸ Shih nyjën 1, ku del folja në një sekuençë teksti të *LM*, i vetmi rast kur del në vepër.

nyjën 1), asht lanë pa kontekst fetar në shpjegim mbasi ajo asht lutje e besimit mysliman ndërmjet mesditës dhe muzgut (Fj. *Bashk.* 167, De. 486, Lu. 122, Buf.-Ro. 215). Khs. vargun “N’ at mbasdite n’ « *iqindí* »” (XXVIII, v. 211). Foljen “*kmye (me u)*” Ku. e shtjellon gabimisht, “*kmye: këmbyer, ndërruar, bërë tjetër. (ndërsa dhimbet shkina kmye) – ndërsa nga dhëmbja shkina këmbyer. LM*” (90), ndërkohë që e ka shpjegimin qysh te Fj. *Bashk.* “*me u çmendë*” (195-6), mandej Gje. (480), Lu. (133), “*me shkallue, me dalë mendsh*”. Vargu i LM, asht “*Ndersa dhimet shkina kmye*” (XXIII, 337). Ma tej, fjala “*korriqe*” shpjegue si “*kurriz*” (sikur Gje.), për vargun “*I bje plumja mu m’ korriqe / E e len shakull m’ do kalbsiqe*” (XX, 251), nuk gjejnë përlligje nga Fj. *Bashk.* (203), De. (490), Lu. (135) e as FGJSH, të cilët e shpjegojnë si enë për masë drithi, ose baras me një okë e treqind derhem. Edhe kjo fjalë del veç njëherë në përdorim. Nësa folja “*krepatue (me, u)*” interpretohet nga Ku. si pezmatim (njejtë si Gje. 333) e si kërcitje. Rasti i përdorimit në LM, del në këto vargje: “*Ç’ janë terbue, ç’ janë krepatue,* (XVIII, v. 817); *Ç’ t’ âsht perpushë, ç’ t’ âsht krepatue,* (XX, v. 207); *T’ â kerleshë, t’ â krepatue,* (XXI, v. 515); *Kshtû kan nisë me u krepatue* (XXIII, v. 712); *Krepaton flaka pa prâ* (XXV, v. 655)” e bartin këto ngjyresa si:

“me u çue peshë, me u vû në lëvizje, me u alarmue, me u ndezë” —kështu e pleqnojnë Fj. Bashk. (207), Kol. (106), De. (491) dhe Lu. (137). Kurse për vargun e fundit për këtë folje, të cilin e citon edhe Ku. (95), dhe e shpjegon *“kërcet flaka”*, tue iu drejtue kontekstit kisha me thanë se asht *“çohet flaka përpjetë”*. Tash sesi *“kërcet flaka”*, e din ma hollë z. Franja; ndoshta ashtu si *“duke qitur dokrra”* kur shpjegon fjalën *“adra”* (2). Për fjalën *“llogë”*, edhe kjo një herë në poemën e Fishtës, Ku. merr si mbështetje Kol. (126), tue thanë *“çardak, hajat, trapazan, ndeje, vendbanimi... drenushat kërkajnë hajatet”* (111). Vargu në LM, megjithëse Ku. nuk e citon, asht *“Ku edhë sutat kerkojn llogat”* (XXV, 398). *Hajati*, natyrisht asht jashtë kontekstit këtu, por për këtë fjalë hartuesit e fjalorëve ndahen dy mendesh, ose *pyllishtë/drizore* (Fj. Bashk. 244, De. 493, Lu. 150) ose *ndêje, strehim* (Gje. 560; e pjesërisht Kol.) Ai që e ka rrahë ma keq kuptimin e fjalës asht Kulli. Keqkuptimet vijnë edhe ma zi. Asht po prapë një fjalë e vetme në *Lahutë*, në shumës, që del në XXV *“Zotishpís, zanë vend per urë / Voters, m’ mâshna a m’ ndo’i ûnë t’zezë / Turrshim buzmin shkundullitë”* (414). Në një përkthim ma të thjeshtë, bahet fjalë për një zot shtëpie ndêjë te votra që me masha shprushë gacat e trungut. Edhe Fj. Bashk., po e tham e kam me

e thanë prapë, e ka botue vetë Kulli si anastatik, e shpjegon qartë e pastër shumësin e *mashës/mashna* (256).¹⁹ Kësaj i thonë mos me lexue as çka boton vetë, pra as Fishtë. Kulli shkruen, tue mos e citue krejt vargun e *Lahutës* ku del fjala për shqyrtim: “mashë-mashna: *stan dhensh, shtëpi në vërri, (m'mashna)-në stane. LM*” (116). Tash pyetja asht se si ka mundsia që ka marrë kaq keq m'thue? Përgjigja asht e thjeshtë. Kulli ka dashtë me e interpretue Fishtë, përmes FGJSH, dhe fjalës “mashën” jo “mashna”. Përcaktimi i këtij fjalori asht “MASHËN: 1. *Stan bagëtish të imëta. Mashna e dhenvë. 2. Kasolle ku ruhet ushqimi dimëror për bagëtitë (bar, kashtë, jonxhë etj.), kashtore. Mashnat e kooperativës. Bari ruhet në mashën. 3. Kasolle barinjsh në vërri.*” Jo mor zotni Frane nuk janë as pleme²⁰ as stane, por *masha* për gaca. E për

¹⁹ Shpjegimi i Fj. *Bashk.* “Mashe e mashen, a, vf, shum. *Mashna, t. Molla per prendere le brage*”, e neutralizon edhe pohimin e dyshimtë të Lukës, kur thotë se “*trajta mashna ngjan si shumësi i mashë*” (153).

²⁰ Nji gabim si F. Kulli e ka pasë ba edhe Lok Limthi në shpjegimin e gjysës së dytë të tekstit ndër thojëza, tue e marrë trajtën “mashna” si gabim. Ky e arsyetonte “*Mashna Ef. turk. (Masà) = Vegël e përbâme prej dy vegësh hekuri, me të cillën kapim gjacën ose përpushim zjarmin. « Tue pasë mashën, pse djeg duert? ».* Shumori: *Masha*. Pra, «mashna» e përdorun në K. 25/535, do të jetë nji lajthim. Sidomos, po të kemi parasysh se: «Mashën» = Ndertësë

habi timen e të z. Kullit, pra Tefë Topalli (2002: 490) e ka shpjegue saktë: *mashë*. Redaktori pra, T.T. nuk i ka ardhë në ndihmë autorit për këtë fjalë, pavarësisht se si botues, Kulli duhet ta kishte lexue botimin e vet.

Fjala “*misnik*”, edhe kjo teke në *Lahutë*, të cilën e shqyrtoj edhe në nyjën 1, simbas De. (495), Kol. (137) e Lu. (157) nuk asht byrek me copa mishi simbas Gje. (170), e Ku. (121) por ushqim i cili bahet me gjak berrit e yndyrë, ose edhe me miell e tëlyen.

Lista e keqkuptimeve ose e shpjegimeve të paplota asht e gjatë, kështu që po kufizohem vetëm në fjalët përkatëse, dhe lexuesi i interesuem, le t'i konsultojë e krahasojë ma tej vetë: “*mtrue (me u)*” (Ku. 124); “*ndoset*” (130); “*pëzatë (me)*” (150); “*pip*” (151); “*plantë*” (152); “*rajë*” (162); “*rrapllue (me)*” (168); “*shkujk*” (188); “*shkundullitë (me)*” (188); “*trumhasë (me u)*” (204); “*zollotë*” (224), te Ku. “*zallotë*” dhe nuk e regjistron si fjalë të LM, ndërkohë që ajo përdoret në XI, v. 147. Ky i mbrami e shpjegon si *pare sermi*, në kundërshti me *Fj. Bashk.* (511), De. (518), Gje. (189), Kol. (289/a, c), Lu. (248), Buf.-Ro.

në formë pojate ose stani, në të cillën mbajmë ushqimin e gjasë së gjallë, si bar, kashtë, tallë, jonxhë et. Skajohet me a-. Shumori: Mashna. (= Plema)” Shêjzat, separat, 20.

(528), të cilët e bien si monedhë/pare turke me vlerë të vogël krejt. Monedhat e sermit në këtë rast marrin vlerë ma shumë sesa kuptimi i fjalës. Ku. i mungon edhe shpjegimi figurativ për vargun: “*Mêrr e mûshë edhè nji gotë, / Edh’ e shpikë e e bân zollotë*” (XI, 127), i cili nënkupton “*me e ba të t’pakênë; me ia qitë fundit, me e tha*”. Të gjithë, sa ma nalt, e konsiderojnë si monedhë turke, kurse vetëm Lu. e bjen “*zollotën*” si monedhë greke. Ndërkaq Buf.-Ro. emnin e kësaj monedhe turke e lidhin me një prejardhje të mundshme nga polonishtja (*złota*) në turqishte, sikurse ma heret Dizdari (1161), i cili ia atribuon këtë ndërlidhje etimologjike Sami Frashërit.

0.8. Edhe Fjalorthi me të meta

Autori, Frano Kulli, mbasi mbyllë shpjegimin e fjalorit të veprës së Fishtës, përvijon edhe një syth “Fjalorthi i emrave të njerëzve e vendeve, zanave, hyjnjëve e personazheve mitologjikë (në disa raste sillen bashkë me shprehjen frazeologjike ku janë përdorur)”, 233-77. Një punë të tillë e ka krye ma së miri, dhe vû kapakun Át Benedikt Dema, OFM, *Fjalori Historik - Gjeografik - Mytologjik i “Lahutës së Malcís”* (Shkodër: Botime Françeskane, 2021, 144 ff.), siç e kam pohue në një artikull të maparshëm. As këtë vepër Kulli nuk e ka në shqyrtimet e tij. Nëse justifikimi është se kjo vepër është botue paralelisht me atë të Kullit, atëherë këtij të mbramit i ka takue detyra me e konsultue në dorëshkrim Demën, siç ka ba Robert Elsie, kur ka bashkëpërkthye *Lahutën e Malcís* në anglisht (*The Highland Lute*, NY: I.B. Taurus & CAS, 2005). Për me pá sesa seriozitet ka ky fjalorth, mjafton me vrejtë listën e protagonistëve zadrímorë në *LM*, si edhe me pá informacionin që ka autori për figura politike e historike. Prandej po citoj çka pata theksue kohë ma parë. Po të krahasojmë Fjalorin *Historik-Gjeografik...* të Demës me fjalorthin e Kullit, i cili u referohet emrave të njerëzve, shohim se te Kulli nuk dalin asnjë prej protagonistëve zadrímorë në *Lahutë*:

“Gjoka i Tukut (Dema: 45), Gjokë Dodë Goshi (45), Gjo’ Ndue Vokrri (46), Kin Ndoci (56), Lekë Ndoka, vëllai i Fishtës (65), Marka Kuli (75), Marka Tuku (76), Mark Pashuku (76), Mati Gjoka (77), Ndrekë Leci (84), Prênkë Matija (98), Shtjef’ Haberi (115), dhe Zef Prêçi (136).²¹ Në një gjykim të thjeshtë, kur nuk

²¹ Shih GJOKA I TUKUT: prej Pirajsh së Zadrimes (sh); muer pjesë nder luftime, qi u bânë kundra ushtris turke në Hajmel (sh), Rroboshtë (sh) e Kallmet (sh); GJOKË DODË GOSHI: prej Troshanit të Zadrimes (sh). Luftoi kundra ushtris së Turkut në Hajmel (sh) etj.; GJO’ NDUE VOKRRI: i biri i Ndue Vokrrit, prej Hajmelit (sh) të Zadrimes. Luftoi kundra ushtris turke në vend të vet, në Rroboshtë (sh) e Kallmet (sh); KIN NDOCI: prej Zadrime (sh). Muer pjesë nder luftime kundra ushtris së Turkut, qi u bânë në Zadrinë, Rroboshtë, Kallmet); LEKË NDOKA: i biri i Ndokës së Simon Ndoci, prej Fishte, vëllau i Auktorit të “Lahutës”. Edhe ky muer pjesë nder livizje të Zadrimes (sh) kundra Turkut si kryetar çete; MARKA KULI: prej Troshanit të Zadrimes (sh). Muer pjesë në livizje të Zadrimes kundra Turkut 75; MARKA TUKU: prej Troshanit të Zadrimes (sh). Luftoi kundra Turkut në Rroboshtë e tjera vende të Zadrimes; MARK PASHUKU: prej Troshanit të Zadrimes (sh). Merr pjesë nder luftime, qi ajo krahinë bân kundra ushtrivet turke; MATI GJOKA: prej Gjadrit të Zadrimes (sh); muer pjesë të gjallë në luften kundra Turkut e kundra Esad Pashës, kur ky veprohte per të shtë, me trahiti, Serbjanët në Shqipni; NDREKË LECI: prej Troshanit. Luftoi kundra Turkut në livizjen e Zadrimes (sh); PRËNKË MATIJA: prej Dajçit të Zadrimes (sh), i shpís së Milotejvet, një nder shpija mâ me randsí e mâ të pasuna. Merr pjesë në livizjen e asaj ane kundra Turkut; SHTJEF’ HABERI: prej Kallmeti (sh) të Zadrimes (sh). Muer pjesë nder luftime kundra

njuh të “lagjes” s’ke si me i njohë ata në Këlcyrë, n’Klis(s)urën e hershme bizantine, kur për çudi Kulli, tue shpjegue nji figurë historike e politike thotë: “Ali Klisura, *shtrembërim me qëllim i emrit të Ali Këlcyrës*” (234). Besoj se nuk asht faji i Ali Klissurës që e ka pasë ashtu mbiemnin e tij të vërtetë, autografin si edhe me këtë emën i paraqitet pllaka e vorrit [mbishkrue nga Organizata e Ballit Kombëtar] kur ka qenë vorrosë në Romë, më 24-IX-1963. Në këtë rast, Fishta nuk ka shtrembnue asgja në veprën e tij *Gomari i Babatasit*, edhe pse Kullit për habi i duket si e tillë. Historikisht dihet se Ali Bej Klissura asht njohë edhe si Ali Këlcyra, tue bartë kështu ndryshimet e mavonshme (turke) toponomastike në mbiemnin familjar. Mjafton fakti që sot, e bija e Ali Beut, Hana Klissura ruen epitomën paraturke në mbiemnin e saj familjar, sikurse i ati, për me ritheksue se Fishta nuk ka deformue asgja për sa ma nalt. Këto dy defekte serioze në fjalorthin e Kullit, shërbejnë si mostër për lëshime të dukshme në krejt përpilimin e këtij sythi. Përsëritjet, çuditnisht, për të

ushtrís turke, qi u bânë në vend të tij, Hajmel (sh) e Rroboshtë (sh); ZEF PRËÇI: prej Blinishtit të Zadrimes (sh). Luftoi kundra Turkut në 1912 e drejtoi kryengritjen kundra Esad Pashës në 1914-15.

njejten fjalë dalin edhe këtu, khs. “Bisht-Muzhel: *Kepi i Skënderbeut. LM*” (236 e 237); “Nicaj: *fshat në Shalë të Dukagjinit. LM*” (dy herë në 258).

Emnat e zanave të përdoruna në *Lahutë* si *Bekja, Berdona, Bjeshka, Bora, Carja, Cerrlekja, Culina, Çekja, Dakja, Dalina, Darja, Dikja, Dona, Fatalja, Galja, Gerja, Gilja, Gracia, Groshja, Jerja, Lali, Lerja, Lica, Likja, Loshja, Melja, Milja, Minja, Narja, Nazja, Razja, Sÿgrizha, Synja, Talja, Terja, Tirja, Thrake, Vacja, Vathnorja, Vocja*, mungojnë te Kulli. Me fjalë të tjera, ky autor ka ba një fjalorth mitologjik *pa zana* në të. Paradoksale, por e vërtetë.

Informacione të tjera të gabueme, në rrafshin kulturor, dalin edhe në përcaktimin e “*Fusha e Rmajve: varreza e Shkodrës. PSH_{P10}*” (243). Shkodra ka disa palë vorrezash, ndërkohë që autori nuk e sqaron se *Fusha e Rmajit/-ve(t)* i referohet vorreve katolike të Shkodrës. Të njejtin gabim e përsërit edhe në germën **RR**, për leksemën *Rrmaj* (265).

Ba me ballafaqë Demën e Kullin për një toponim në *Lahutë*, ndryshimi informativ asht i thellë. Dema shkruen: “**Mali i Shëjtit** (1 IK 8-9): *bjeshkë mbi Orosh, në Mirditë (sh), 1500 m e naltë. N’Orosh gjindet ndëja e Abatit – Ipushkev, qi mvaret drejt prej Rome e ka nen sundim 16 famullí. Këtu kje motit Abacija e Kisha e Shen*

Lleshdrit me kashen e argjandët, të punueme bukur, ku ruehen të mbetunat e trupit të Shëjtit. N'Orosh, në prenim të M. të Sh. gjindet edhe pallati i Kapitanavet të Mirditës (Dera e Gjonmarkajvet, sh); ky pallat e mbarë Oroshi kje diegë në 1877 prej Turqvet; pallati i tashem kje rindertue e zgjâ në 1925 e rrethue prej muresh së mëdhâ." (74) kurse Kulli: "Mali i Shejtit: *mal në Mirditë. LM*" (254). Nësa për *Sh'Marrabeun*, Kulli nuk shkon ma larg sesa një shpjegim edhe ma i ndërdshtë si ai i Gje.: "ndoshta âsht Shejti Bartolomé" (LM, 1958, 157) vs. Ku. "emër shenjti, formë betimi: pasha shën Marrabeun; e thirrur në gjuhë popullore. LM" (269). Për çudi, thuejse identik e përcakton kështu edhe T. Topalli si përgatitës i *Veprës letrare 4 të Gjergj Fishtës* nga enti botues i Kullit, 2002.²² Duhet thanë ma së parit, kjo nuk asht formë betimi aq popullore (për besimin katolik), si me thanë "pasha Shejtin-e Shna Ndue, a Shën Kóll", etc. Ma do mendja se z. Franja ka kalendar të sotshëm katolik në shtëpi, e le të na gjejë se ku del *Shën Marrabeu* aty. Kjo bé asht një atrofizim fishtian, dhe një aberracion i Shën

²² Shih Gjergj Fishta, *Vepra letrare 4 (Lahuta e Malcis dhe Mojs Golemi)*. Përgatitur nga Dr. Tefë Topalli. Enti botues Poligrafik 'Gjergj Fishta' & Bibliotheca Gollettiana, 2002, 126: "emër shenjti, thirrur në gjuhë popullore: pasha Sh'Marrabeun, formë betimi".

Bartolomeut, që përdoret në dijeninë time vetëm në *Lahutë*, dhe ajo veç një herë përmes gojës së bajraktarit të Shalës, Mar Lula (IX, v. 407). Këtë e konfirmon qartë, Padër B. Dema “SHEN MARRABEU: *Shen Bartolomeu, një ndër 12 Apostujt e Jezu Krishtit; i lutet krenjtja me 24 Gusht*” (110). Kurse ba me i referue datës **24 Gusht**, 1912-27 (15 vjetëve e numrave rresht), në *Kalendarin e Vietës*, [Botim i] *Vepra Pijore*, Shtyp. e Zojës së Paperlyeme, del si festë “*Shen Baltia Apostull*”. Tash këtë punë po ua lamë për me ndá ma kompetentëve në punë feje, nëse *Shen Baltia Apostull* asht *Sh’Bartolomeu*. Për mue po, *Baltia* asht aberracion gjuhësor-fetar i Bartolomeut si *Shën Mia* vs. *Shën Eufemia*, *Sh’Llezhtri* vs. *Shën Aleksandri* e me radhë, që kanë hy në traditën shqipe përmes regjistrit fetar, atij katolik. Po shtoj se në një kalendar ma të hershëm si ai *Kalendár Shqyp per sênde** (Shkoder, Shtyp. [e] Kolégjs Papnore 1898), 24 gushtin e shënon “*Sh. Sh’Bartolomé Ap.*” (18). Ndërkohë edhe kalendar katolik shqiptar (2022), e ka “*Bartolomeu, apostull*”. *Sh’Marrabeu* pra, nuk ka traditë përdorimi në të folmen masive (të hershme e të sotme), as shprehje grafike për ma tepër nëpër kalendarët a burimet fetare-katolike, por asht një

* Version i transliteruem prej meje.

konstrukt fishtian, një invencion fonometrik që as artikulesin e kësaj beje, Mar Lulën pra, nuk e lidhë kulturalisht asgjë me këtë shëjt. Siç dihet historikisht, Shala lutë natën e Shnjonit (festën e Gjon Pagëzuesit) më 26 dhjetor. E për pasojë Mar Lula si shaljan, kishte me iu referue pajtorit të fisit të vet, Shnjonit, ose ndonji *ma* popullorit, e assesi—në një deduksion logjiko-historik—një shejti jo aq të përhapun në traditën shqipe-katolike.

1. A ka marrë Frano Kulli prej Át Daniel Gjeçajt, pa e citue punën e tij?

Titulli i kësaj nyje, menjherë ngjallë diskutimin e plagjiaturës, një temë për të cilën kam folë edhe vite ma parë në raport me veprën e Fishtës. Siç e shpreha në fillim, Frano Kulli nuk e renditë në bibliografinë e vet bot. II të *Lahutës* (Romë, 1958), kujdesue prej Át Daniel Gjeçajt e ndihmue prej Martin Camajt dhe Petro Vuçanit. Mirëpo analizimi i disa leksemave si ma poshtë, të ban shumë me dyshue për një vjelje frutash n'bahçe t'huej. Po e nisim me një fjalë të keqkuptueme në tekstin fishtian, e cila përdoret veç një herë: "*allkë*" në vargun: "*Nji parë dana e t' gjata e t' randa, / Mirë nen allkë aj tue i ngujue*" (XXVI, vv. 240-1).²³ Gjeçaj e shpjegon: "*allkë: ledh arash.*" (LM, 1958, 616), e për çudi edhe Kulli identik: "*allkë-a: ledh arash*" (3). Në *Shpalimet* e tij, Kolgjini (4), me të drejtë tue u nisë prej kontekstit të vargjeve, e kritikonte Gjeçajn për këtë shpjegim. Ai sugjeron se asht fjala për *hallkë, verigë*. Njëjtë edhe Luka në *Magjia* (42)

²³ Referimet janë prej botimit definitiv të *Lahutës*, anastatik i Botimeve Françeskane (bot. XV, Shkodër, 2006. Cilësimet janë dy sojesh ose me anë të vargut (v.) ose vargjeve (vv.), ose faqes/-ve ku shënohet/-n vetëm numri/-at përkatës.

sugjeronte këtë lexim për përgatitësin e atëherëshëm të kolanës së Kullit (2002), Tefë Topallin,²⁴ i cili e shpjegonte njilloj “*ledh arash*” si Gjeçaj, e ma vonë Kulli si të dy këta. Autorët e traditës geqe, jo pak herë e bjerrin tingullin nistor ‘h’ si në rastin e “*orizon(t)*” për “*horizont*”, ose e kundërta e shtojnë aty kur toskërishtja nuk e përdorë, khs. “*hagrep*” për “*akrep*” ose “*me hecë*” për “*me ecë*”, etc. Tue iu referue kontekstit të kangës, del se Lleshi i Zi, kefalia i Gjomarkajve për me luftue me Kulshedrën merr një palë dana të gjata e të randa e i mbërthen (ngujon) nën hallkë, që për të gjallë mos me u shkapullue (shkëputë).

Gjeçaj shpjegon ndërkohë: “bushurdisun: *mbushë gojën me ujë*” (LM, 1958, 517) vs. Kulli “bushurdis: ...(*mbush goje fulqijsh n’ujë bushurdisë*) *mbushur gojën me ujë për të lagur njëra-tjetrën*. LM” (19).²⁵ Edhe kjo folje përdoret vetëm një herë në LM, por jo me atë varg që shënon Kulli, por “*E fulqijsh n’ ujë bushurdisun*” (XXIV, v. 99). Vijoj krahasimin: Gje. “*buzmi: një trup qi natën e Krishtlindjes vëhet në zjarm me disa sjellje të posaçme rituale*” (580) vs. Ku. “*buzmi:*

²⁴ Shih edhe T.T. *Vepra letrare*, 4, *ibid.*, 522: “allkë: *ledh arash*”.

²⁵ Khs. T.T. “*E fulqijsh n’ujë bushurdisë—mbushur gojën me ujë për të lagur njëra-tjetrën*”, 433.

trupi i drurit (cungu) i natës së Krishtlindjeve; (**buzmi ndë tërthuer** – hapur për së gjëri në oxhak) LM” (19);²⁶ Gje. “tue gargullue: tuj gurgullue, tuj qeshë të madhe, tuj u shkëri në...” (517) vs. Ku. “gargullue: qeshur fort. (**duke gargulluar-duke qeshur fort**) LM” (55).²⁷ Natyrisht trajta toske e përnxime nga autori, “duke gargulluar”, nuk gjendet në LM, por siç u pá te T.T. Ma tej, Gje. “hamullohen: ngarriten” (495) vs. Ku. “hamullohen: zihen, ngarriten. LM” (67);²⁸ Gje. “harmagjikë: një lloj ambëlsine, ku djathi nxen vendin e parë” (412) vs. Ku. “harmagjikë-a: një lloj ëmbëlsire e gatuar kryesisht me djathë. LM” (68);²⁹ Gje. “n’ iqindí: n’ zëmërherë, në zamër, ndermjet drekës e darkës” (649) vs. Ku. “iqindi: kohë ndërmjet drekës e darkës, zamër. LM” (74);³⁰ Gje. “Me kollçikë e me fistan: me tozllukë, kallçí: një lloj pantollonash qi mbathen nën fistan ase fustan: si një lloj rashe pëlhure së bardhë, e gjanë e palë palë, qi prej ijët mbulon trupin deri pak nën gjú” (147)

²⁶ Khs. T.T. “buzmi nde tërthuer – trupi i drurit (cungu) i natës së Krishtlindjeve, hapur për së gjëri në oxhak”, 490.

²⁷ Khs. T.T. “tue gargullue – duke gurgulluar, duke qeshur fort”, 433.

²⁸ Khs. T. T. “hamullohen – zihen, ngarritën”, 416.

²⁹ Khs. T.T. “harmagjikë – një lloj ëmbëlsire e gatuar kryesisht me djathë”, 342.

³⁰ Khs. T.T. “iqindi – kohë ndërmjet drekës e darkës, zamër”, 550.

vs. Ku. “kallçi:³¹ lloj pantallonash të ngushtë që mbathen nën fustanella burrash. (me kollçikë e me fistan) – me kallçi e me fustanella. LM” (92);³² Gje. “m’korriqe: në korriz” (364) vs. Ku. “korriqe-ja: kurriz. LM” (94);³³ Gje. “m’e mahitun: me e pezmatue, me e rrëjtë, me e gënjye” (256) vs. Ku. “mahitë: mahitur, çuditur, habitur... tue mahitë – duke e gënjyer. MZ, LM, PSH_{P10}” (113); Gje. “Çile e zamer ka ‘i « misnik »: në mëngjes e mbasdreke nga një lloj byreku (me grima mishit e me petë poshtë e nalt, i pjekun në furrë)” (170) vs. Ku. “misnik-u: lloj byreku me mish të pjekur (cilë e zamër ka ‘i misnik – cilë – ngrënie mëngjesi aty nga ora 9 dhe zamër pasdreke aty nga ora 5, lloj byreku me mish të pjekur, misnik” (121).³⁴ Shpjegimi siç shihet asht i çorganizuem, në pjesën e dytë sidomos, por

³¹ As kjo fjalë nuk ekziston në Lahutë ndërkohë, por te T.T. Shpjegimi asht pak i vaktë e nën një vizion të Gjeçajt ma shumë, por Kullit ndoshta kishte me i vleftë shpjegimi që i jep Dema “kollçik, -u (em. m.): mbëlojsë kambe (lëkure a cohe); tirk, dollak.” LM, BF, 2020, 490. Ndoshta edhe kallcë (sin. i kallçi-na), kishte mujtë me e ndihmue në përkufizim ma mirë.

³² Khs. T.T. “me kollçikë e me fistan — me kallçi, lloj pantallonash të ngushtë që mbathen nën fustanella burrash”, 117.

³³ Khs. T.T. “korriqe — kurriz”, 299.

³⁴ Khs. T.T. “cilë e zamër ka ‘i misnik — një ngrënie mëngjesi aty nga ora 9 dhe pasdreke nga ora 5, me misnik, lloj byreku me mish të pjekur”, 137.

formulimi asht dukshëm si ai i Gjeçajt. P. sh. Kulli nuk afrohet në përplim aspak me Kolgjinin, i cili shpjegon në *Shpalime* “misnik-u: *E.m., shm.: Misnikë = Nji hae, qi bâhet me miell, me tlynë e me voe dhe piqet me saç, atje ku s’ka furrë*” (137). Prapë ma tej: Gje. “mtrueju: *msÿj, deli para* (570) vs. Ku. “mtrueju: *sulmo nga përpara. (tjetri mtrueju – tjetri sulmo nga përpara; mtruhen – lëshohen hoovshëm mbi njëri tjetrin. LM*” (124).³⁵ Për koincidençë, Kulli gjen përafri vetëm me Gjeçajn edhe për këtë fjalë, nësa Dema, Kolgjini e Luka pohojnë të kundërtën: De. “**mtrue, me-** (fo.): *me u shtî, me u mëssehë, me u mbrrudhë (prej frige), me xanë pritë, me pergjue.*” (496); Kol. e interpreton si “*truemje, kushtim, dedikim*” dhe “*me true, me mallkue*”, gja e cila mendoj se asht jashtë kontekstit të vargut të Fishtës në LM. Kurse Lu. e cilëson kështu: “mtrue (me u): *tërheqje gjatë lufte për të zënë një pozicion më të mirë luftimi (Troç m’troç, mtruhen, tranden trimat)*” (161). Në fakt Dema e Luka afrohen ma saktë në shpjegim, i cili konturohet (sidomos përkufizimi i De.) simbas *Fjalorit të Bashkimit (Fjaluer i Rii i Shcypës, 1908)*, të cilin para do viteve e ka pasë botue anastatikisht edhe Kulli. *Fj. Bashk.*, e shpjegon kështu: “mtruum e mtruem, (i, e, t’), *persh. Appostato,*

³⁵ Khs. T.T. “mtrueju —sulmo nga përpara”, 480.

a; Appostamento" (279). Ky *pershtueshem* (adjektiv), simbas fillimit të *Bashk.*, ka referencë edhe ushtarake [me u mirëvendue, me u pozicionue], gjë që skena e *Lahutës* e përshkruen në vargjet e veta:

*I trënuni Gjeto Staka
N' at log Zanash neper çufëra
U dorgj turr. Trum trokollisin
Troç m' troç, mtruhen, tranden trimat,
Mendsh trullue. Lamsh hamullohen
Njani m' tjetrin; matarohen,
Ngiten, nziten me dorë njiten,
Hârokuqen nper rrgallë :
Kush terthoras, kush perballë,
Çeku qenash, quku krenash,
Llanash laskarou m' tagana:
Pergjak xhoka e xhamadana,
Gozhupë, struga e koporana.
(LM, XXIII, 349)*

Po kështu, Gje. "T' mos m' a peçase: të mos m' a prekë, të mos të pushojë mbi të" (519) vs. Ku. "peçasë: prekë, (t' mos ma *peçasë*) – të mos ma prekë, të mos i qaset.³⁶ LM" (146); Gje. "e ke penda: korrizi i shpatullës

³⁶ Khs. T.T. "t' mos ma peçasë — të mos ma prekë, të mos m' i qaset", 435.

(71) vs. Ku. “penda: kurrizi i shpatullës. (*ke penda*) – te kurrizi i shpatullës. LM. (146);³⁷ Gje. “si pezhgvja zí: zí si pisa, si korbi” (592) vs. Ku. “pezhgve-ja: peshkve, pisa (*si pezhgvja zi*) zi si korbi, zi sterr si pisa. LM” (151)³⁸ për rastin e “pezhgve” në XXV, v. 835 “Kur, qe, ‘i rê, si pezhgvja zí” – e ndeshun ma parë si fjalë qysh në Eposin e Kreshnikëve. Po prapë, Gje. “ushtuer: rojtár vëneshtash” (239) vs. Ku. “ushtuer-i: rojtare* vreshtash e fushe. LM.” (210);³⁹ Gje. “yzbashit: kryetar mbi njiqind vetë” (667) vs. Ku. “yzbash: komandant për 100 vetë në ushtrinë e Perandorisë Osmane. LM”⁴⁰

³⁷ Khs. T.T. “ke penda — te kurrizi i shpatullës”, 57.

³⁸ Khs. T.T. “si pezhgvja zí — zí si korbi, zi sterr si pisa”, 501.

* Simbas tekstit të Kullit dhe të T.T., në vend të rojtár.

³⁹ Khs. T.T. “ushtuer-i: rojtare* vreshtash e fushe”, 191.

⁴⁰ Tahir N. Dizdari, *Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe*, Instituti shqiptar i mendimit dhe i qytetërimit islam (AIITC); Organizata islame për arsim, shkencë dhe kulturë (ISESCO), Tiranë, 2005, e shpjegon kështu: “*Jyzbásh-i* m. kapiten, komandant në ushtri [...] Tur. *yüzbaşı* “oficer me gradë midis togerit dhe majorit” (461). Pra Dizdari, nuk përmendë kund se kjo gradë ushtarake udhëheqë një trupë njiqind vetëshe. Lok Limthi, e cilëson se yzbashi asht centurion (ose qindshatár, Kurti, *Testamendi i Rí*, botim nw proces, BF, 2023; qindor, Oroshi, *Shkrimi Shêjt (Katër Ungjijt dhe Punët e Apostujvet)*, përk. Msgr. Dr. Joseph J. Oroshi. Levizja Françeskane Italiane, Bologna, 1992). Shih, *Fjalët turkishte në “Lahutën” e Fishtës*, separat i *Shêjzave* (Arti Grafiche Editoriali A . Urbinati, Roma, 1961), 30.

(222);⁴¹ Gje. “Porsi me branisë zhamella: *si të ngrehshin rrëshanë koçekë, gur të mdhaj*” (619) vs. Ku. “zhamellë-a: *gur i madh, gurë të mëdhenj*. LM” (229).⁴²

Kjo asht një evidencë e mjaftueshme, mendoj, për me krahasue dhe me verifikue dyshimin e një plagjiarizmi nga ana e Kullit kundrejt shënimeve e komenteve të Gjeçajt, krye në botimin e 1958-s të *Lahutës*. Ose në një prespektivë tjetër, ky fenomen na ban me mendue se z. Kulli asht pjesë e një rrjeti plagjaturial, siç ka me u vërtetë ma poshtë.

⁴¹ Khs. T.T. “yzbash — komandant për 100 vetë”, 567.

⁴² Khs. T.T. “Porsi me branisë zhamella — *si të tërhiqnin rrëshqanë zhamela, gur të mëdhenj*”, 525.

1.1. A asht Át Daniel Gjeçaj pré e një plagjiarizmi kolektiv?

Në parashtrimin e masipërm—i cili mund të ishte edhe ma i shumtë në numër, po për arsye të fokusit të temës jam kufizue—tue iu referue edhe shënimeve në nënvijë, del se Frano Kulli përmes Tefë Topallit (2002) ka përvetësue aparatën kritik të Padër D. Gjeçajt, ba në 1958. Këtu lindë pyetja a kemi të bajmë me një plagjiarizëm kolektiv? Pra a jemi para një skeme të përvetësimit intelektual të strukturuem akademiko-editorial? Me shumë gjasë po. Siç dihet, Kulli, asht botuesi dhe investitori i një redaksie e cila e ka *tjetërsue* veprën e Gjergj Fishtës, dhe po e ban pa i hy ferrë në kambë përditë. Ky fenomen asht fryt i një *politike linguicide* që e ka *margjinalizue* autenticitetin një vepre e një autori, me të njejtin arbitraritet siç ka veprue komunizmi shqiptar përgjatë pushtetit diktatorial.

Motit, asohere Dr. T. Topalli në lidhje me përgatitjen e komentarit të epikës së Fishtës, nuk e përmendë askund botimin e Gjeçajt (njejtë si Ku. në 2021), dhe për ma tepër nuk ka asnjë referencë bibliografike se ku e ka gjetë bazën e shpjegimit të

leksikut fishtian. E vetmja gja që vrehet asht një sqarim krejt i pamotivuem e bukur i pakthjellët për punën e tij të kryeme. Në *Pasthënie*, ai shprehet:

Shënimet gjuhësore filologjike, që lexuesi do t'i ketë si footnote, jemi përpjekur t'i mbajmë brenda rrafshit të këtij publikimi (të 2002, shtojcë e imja), si botim kuaziakademik, po edhe divulgativ; duke i qëndruar parmit (erratë tekstore [parimit], shtojcë e imja) të dhënë nga linguisti Wittgenstein, që thoshte se fjalën mos e hetoni nga kuptimi, por nga përdorimi, ndaj dhe shpjegimet jepen me grupe fjalësh a shprehjesh, deri me vargje të plotë (656).

Tash në lidhje me këtë metodë pune, para se m'e thanë gjuhëtari që i referohet Profesor T. Topalli, e ka ndjekë Gjeçaj në bot. II të *Lahutës*. Po ai ka përdorë shënime në nënvijë të kangëve të *LM*, të cilat kanë thadrim filologjik dhe argumente hymëse për secilën kangë, siç kanë ba dikur vëllaznit e tij Françeskanë për *Eposin e Kreshnikëve*. Gjeçaj ka shpjegue njëkohësisht edhe disa nocione e fraza të bosnian-kroato-serbishtes që gjenden në *LM*. Për këtë po i referohem një fjale: *kapicë*, kësulës malazeze

dhe dy vargjeve që shkuhen në bks. nga Poeti. Në lidhje me *kapicën* (fjalë e bks. dhe e gjuhëve tjera ballkanike) Gje. shprehet: “*kapicen: ksulën rrafshatake të zezë me kapak të kuq dhe me gerrat fillestare SSSS, qi në gjuhën sllave duenë të thonë: « Vetëm Bashkimi Pështon Serbin »*” (6). Gje. e ban këtë koment në *Cubat*, kanga I e LM. Ndërkohë T.T. e ka segmentue këtë sqarim të Gje. mes k. I dhe asaj XXIII, ku ky i mbrami për v. 233 “*Me gjith shkrola hupë në zdram*” pohon “*hupë në baltë, lloç me gjith gerrat, SSSS qi ka kapica; shif I, 58*” (476). Nësa T.T. po për të njëjtin varg, thotë identik si Gje. veçse në standard “*humbur në baltë me gjithë gerrat që ishin shkruar në kapicë: SSSS (Vetëm Bashkimi Shpëton Serbinë)*” (398). A keni kureshtje me ditë çka thotë z. Franja për këtë varg kur shpjegon fjalën *zdram*? Kokërr më kokërr çka thotë T.T.; khs. Ku. 225.

Për v. “*Mtani! Pas vam nanu greba!* (XXV, v. 528), Gje. komenton “*Pas vam nanu greba: e shame banale*” (580), e për habi edhe T.T. “*bini më ta, he ju... (sharje e ndyrë në serbisht)*” (490). Tash etika puritane e stalinizmit gjuhësor (në rastin e T.T.) edhe mund të “*kuptohe*”, por mund të ishte mirëkuptue ma shumë nëse ai në statusin e përgatitësit (sic) të komenteve ta sqaronte saktë frazën në bks. Vargu

“*pas vam nanu greba*” don me thanë “*he jua qiftë qeni nanën*” që De. e ka sqarue si “*he ju kjasha nanen*” (499). Në dijeninë time, ky varg ka kalue pa u indentifikue si kalkim i v. “*Potkujte ih, pas im nanu greba!*” të Ivan Mažuranić, në poemën e tij *Smrt Smajl-Age Čengića*.⁴³ I vetmi që e përmendë asht Esad Mekuli,⁴⁴ i cili e pretendon gabimisht si përkthim të Fishtës nga gjysëvargu “*Potkujte ih*” (*Mbathini [patkojtë]*) në “*Mtani!*” Këtu Fishta nuk e përkthen këtë gjysëvarg, e për ma tepër e integron gjysën tjetër të vargut si *kalk* nga Mažuranić, me ndryshimin e vetëm të përemnave *ih* vs. *vam*. E këtë e ka ba në mënyrë të vetëdijshme, prejse Poeti e përdallon me kursive frazën në kroatisht. Kjo frazë te poeti kroat asht në gojën e Smajl Agës, e nësa te Fishta në gojën e Mark Milanit. E vetë ndërkohë Smajl Agë Çengiqi, citohet nga Poeti në po këtë kangë (XXIII, v. 562) se asht vra nga Kiku i Mhillit⁴⁵ (me gjasë Mirko Aleksić, dorasi i agës), hero malazez.

⁴³ Ivan Mažuranić, *Smrt Smajl-Age Čengića*, Zagreb: Tisak i Naklada Knjižare St. Kugli, Ilica 30, s. d.

⁴⁴ Ivan Mazhuraniq, *Vdekja e Smail-agë Çengiqit*, përk.: Esad Mekuli. Beograd: Enti për botimin e teksteve i Republikës Popullore të Sërbis. Prishtinë: Rilindja, 1963, 62.

⁴⁵ Ky emën shënohet nga De.² në fjalorin e tij (56), por nuk jepet emni real i vrasësit të agës turk. Krajl Nikolla ka shkruar

Dhe shembulli i fundit, për v. “*Udri, Tverdko, Bog te ubijo!*” (*ibid.*, v. 577), të cilin Gje. kthjellon: “*Mëta, Tverdko, he Zoti t’ vraftë!*” (582), e T.T. rrumbullak një copet “*mbi ta Tverdko, Zoti të vraftë!*” (492). Natyrisht, manipulimet e lehta në shqip (*mëta = mbi ta*), dhe diletantizmi në gjuhën bks. ku nuk ndërkallet *e*-ja para grupit bashkëtingëllor, gja që e imponon gjuha shqipe në rastin kur *r*-ja e bks. kryen funksionin e një zanoreje, ka ba që “komenti” me dalë edhe ma keq se vetë plagjiatura. Në lidhje dhe me një detaj tjetër, asht interesant sesi përkthyes anglezë nuk e kanë përkthye as luejtë aspak vigmën grishëse *Monjoie*, në fushëbetejë, në *Kangën e Rolandit*. Kurse te T.T. elementet substancialë emotivë *mëta* dhe *he* manipulohen ose hiqen, tue bjerrë tempo-ritmin por edhe mbarë strukturën e hipotipozës epike. Po gjithsesi, tue paramendue çdo fabrikim eventual prej T.T. rezulton se puna e Gjeçajt asht përvetësue integralisht, pa sitë gja, përveçse në sitën e standardit, e cila e ka qitë miellin të trashë shumë shpesh.

epitafin në pllakën e vorrit të Mirko Aleksić-it. Thuhet se Mirkoja ia ka pré kryet agës, e vojvoda Cerović Novica ia ka çue kryet e premë vlladikës Petar Njegoš, i njohun ndër të tjera si autori i *Kunorës së maleve*. Ndërkaq Mekuli (63) pohon se asht po Mirkoja vetë ai që e ka krye diçka të tillë.

Me anë të këtyne komenteve, enti botues dhe *redaksia linguicide* e botuesit Kulli [po i referohem botues se në vitet që pasojnë, lidhun me kolanën e veprave të Fishtës, del pa praninë e bashkëbotuesit Vincenzo Golletti], ka dashtë me prû para lexuesit se *Lahuta* po prezantohet për herë të parë me një komentari. Natyrisht e pazakontë për botën e huej akademike, por e zakonshme për atë shqiptare. Aq ma keq, habia s'ka të sosun, kur mbas sa viteve vetë botuesi, merr çka ka ba anëtari i redaksisë dhe përgatitësi i *Epikës* së Gjergj Fishtës. Në *Fjalorin* e Kullit, T.T. asht redaktor edhe pse ma heret autor i po atyne fjalëve që shpjegon sot z. Franja. Ky i mbrami thotë në frontespice, për krejt habinë e mundshme njerëzore, se i falënderohet “*mikut të tij të çmuar, Prof. Dr. Emeritus Tefë Topallin, ndihma e vyer e të cilit, meriton gjithë respektin e përunjësinë e tij*”. E siglon poshtë, qartazi, **Autori**. E jo ma larg, në IX, prapë e falënderon në mënyrë të veçantë e me veneracion T.T. prej krejt redaksisë së Kullit (Ndue Zef Toma †, Tonin Çobani, Tefë Topalli, Hamit Boriçi e Stefan Çapaliku). Atij, pra T.T., i paska ra “barra si specialist gjuhe” por edhe si “zadrimor, nga viset e Fishtës” me moniturue punën e Kullit në këtë *Fjalor*. Ndërkohë, për me ndalë çdo shqyrtim të

mundshëm, asht e nevojshme me u fillue se cila asht *ndihma* e T.T. në lidhje me leksikun e *Lahutës së Malcís*, integruet te Kulli? T.T. a asht redaktor apo autor i këtij leksiku në këtë fjalor? Dhe, a ka të rame (gjasë) që Kulli si editor, thjesht ka kompilue çka ka ba redaksia e tij në lidhje me veprën e Fishtës, dhe i asht paraqitë publikut si **Autori**? Kishte me qenë ma se komike e absurde, që si fillim komentari i Gjeçajt me u plagjiarue nga redaktori-përgatitësi e botuesi në 2002, dhe botuesi mandej me plagjiarue po përgatitësin në edicionin e entit të tij, tue lanë me kuptue se kemi të bajmë me një *delikt intelektual në seri dhe kolektiv*. Në mbyllje, asgja për vënerim s' duket në këtë mes.

2. Fjalët që mungojnë prej fjalorit të *Lahutës së Malcís*

Deri në këtë moment që flasim, vepra e David Lukës, *Magjia e fjalës te vepra 'Lahuta e Malcís' e atë Gjergj Fishtës* (SGJ, XV, 2012, 253 ff.), mbetet punimi ma serioz për shpjegimin e fjalëve të Fishtës në poemën e tij epike. Luka gjatë jetës së tij la të botueme një kolanë të pasun në fushën e studimeve gjuhësore, prej 20 vëllimesh, nën titullin *Studime gjuhësore* (I-XX); si edhe vëllimin *Studime për historinë e gjuhës shqipe* (vepër e zgjedhur). Ndërkohë edhe dy tekste mësimore universitare: *Fonetikë historike e gjuhës shqipe* dhe *Histori e gjuhësisë shqipe (Albanologji)*, përfshî edhe një aktivitet të gjanë artikujsh shkencorë (141 tituj) dhe pjesëmarrje në veprimtari shkencore (73 të tilla). Praktikisht, siç e kam thanë në *Nekrologjinë* e tij (*Hylli i Dritës*, 2020), Luka ka ba punën e një katedre—të paktën prej 1990 deri më sot. Profesor David Luka, me rigorozitetin e pashoq shkencor, sikurse pohojnë familjarët e tij, ka lanë të përfundueme e gati për shtyp: 1. *Vëzhgime, kërkime dhe studime në lëmin e gjuhës shqipe I-X* [punim shkencor në 10 vëllime] dhe 2. *Publicistikë*.

Magjia e fjalës... asht një kontribut që merr në shqyrtim punët e maparshme të Kolgjinit, Demës, Tefë Topallit, artikujt shkencorë të Tomor Osmanit, T. Topallit, Rezarta Muratit e Merita Hysës, Shefkije Islamajt, Orjeta Bajës, Gjovalin Shkurtjat, Jorgo Bulos, të vetë tij (D. Lukës pra), etc. mbi *Lahutën e Malcís*. Natyrisht një korpus fjalorësh si ai i *Bashkimit*, Antonio Busetti-t, FGJSH (1954, 1980, 1984, 2006), Gustav Meyer, e veprash mbi punën e Fishtës si ato të Sabri Hamitit e Kujtim M. Shalës. Shto këtu edhe SGJ e SE të Eqrem Çabejt. Domethanë një bibliografi të lidhun drejtpërdrejt me poemën *LM*. Vepra që mungon, dhe që nuk del e motivueme pse në studimin e Lukës, asht ajo e Gjeçajt (1958). Në bindjen time, prania e këtij të fundit, kishte me e ba veprën e Lukës edhe ma të plotë dhe të gjanë në disa leksema. Si çdo vepër njerëzore, edhe kjo ka disa lëshime, por të cilat dalin me një përqindje krejt minimale. Në dallim me krejt fjalorët e *LM*, Luka krahas shpjegimit të fjalës jep vargun/-gjet përkatëse nga vepra e Fishtës, si dhe jep shpeshstinë e përsëritjes së tyre (aty ku ka) përmes shënimit të faqes/-ve të edicionit të parë të *Lahutës*, 1937. Një gjë të tillë, Dema nuk e ka ba në fjalorin e tij shpjegues, pjesërisht e ka ba Kolgjini e mbas tij krejt pak Kulli.

Rasti i Gjeçajt asht ndryshe, sepse shpjegimet e tij kryejnë funksionin e një komentari të kangëve nën vijë. Komentari mbi *Lahutë* i Volajt, të cilin e kam shqyrtue motit (2009) në drs. në arkivin e Fretënve, si edhe ai i Marlekajt, pjesë e këtij arkivi, po të ishin të botuem,⁴⁶ kishin me shënue një kunorë interesante të *Cometantarii Fratrum* përkrah Demës e Gjeçajt. Ndërkohë flitet edhe për një fjalor [përmendet një skedar rreth njëmijë fjalësh] të Karl Gurakuqit mbi poemën *LM*, në korrespondencat e tij me Mustafa Krujën, por fati i tij nuk dihet, me sa jam në dijeni.⁴⁷

Simbas Lukës (SGJ VII, 69), Kolgjini ka shpjegue në *Shpalime* 1274 fjalë prej *Lahutës*, e Dema 1350 (SGJ XV, 41), por tek ky i mbrami thotë se mungojnë edhe njëmijë të tjera,⁴⁸ pra tue lanë me kuptue se janë rreth

⁴⁶ Një punë shqyrtuese e hollësishme, ende nuk asht ba prej studiuesve, për me mbërritë në përfundimin nëse këto dy materiale arkivore janë projektue për një botim të mundshëm nga ana e Volajt dhe e Marlekajt, apo thjesht kanë shërbye si evidentime personale pa pretendimin e një botimi. Nëse ka me pasë një botim të tyne në të ardhmen, kujdesuesi dhe botuesi, duhet me e peshue këtë aspekt.

⁴⁷ Shih Mustafa Merlika – Kruja, *Kuvend letrash me miqtë*, vol. 2. Tiranë: Omsca 1, 2013.

⁴⁸ Luka e cekë me të drejtë, se hartimi i asokohshëm i fjalorit të Demës (s.d.) me gjasë nuk ka pasë nevojë për ma shumë fjalë,

2400 fjalë të shpjegueme në *Magjia e fjalës*. Për me qenë ma i saktë, po jap një evidencë për çdo gERMË dhe totalin e fjalëve të shpjegueme nga Luka, në veprën e tij.

A 63	B 141	C 43	Ç 48	D 100	DH 10
E 19	F 62	G 87	GJ 38	H 94	I 17
J 16	K 267	L 84	LL 16	M 165	N 72
NJ 23	O 20	P 220	Q 35	R 48	RR 77
S 98	SH 148	T 134	TH 15	U 31	V 97
XH 20	Y 3	Z 57	ZH 29		TOTAL 2397 ⁴⁹

Pra nëse vetëm *Lahuta* ka afro 2500 fjalë, sa duhet të ketë krejt vepra e Fishtës atëherë? Intervista me Kullin,⁵⁰ thekson se vepra e këtij ka mbi 15 000 fjalë. Po sa do të kishte sikur autori mos me përsëritë të njejtat fjalë abuzivisht, dhe me integruë çka ka lanë jashtë prej *Lahutës* e me gjasë edhe prej veprave të

se: a) janë kuptue prej publikut të atëhershëm, dhe b) lexuesi mund t'u referohet fjalorëve të ndryshëm për me kuptue leximin e drejtë të tyne. Të dy pikat, për lexuesin e sotëm, nuk kontekstualizohen. Sot për sot, lexuesi shqiptar kupton përditë e ma pak prej shkrimtarëve shqiptarë klasikë e sidomos gegë, dhe se vetëm specialisti [për fat të keq, edhe këtu përditë e ma pak] hapë fjalorë për me zbardhë kuptimin e fjalëve.

⁴⁹ Germat **Ë** e **X**, s'registronë fjalë.

⁵⁰ <https://www.youtube.com/watch?v=PDwNYf5dIN0>.

tjera? Si bje' fjala nja 40 emna zanash e nji mori luftarësh zadrिमorë prej LM. Shtjellimin e kësaj nyje, po e nisi me pyetjen: cilat fjalë janë lanë jashtë prej *Lahutës së Malcís* nga Frano Kulli? Krahasimi, simbas mendimit tim, lypet me u ba me kontributin e mbramë mbi leksikun e *Lahutës*, e njiherash ma me volum në numër fjalësh, pra atë të David Lukës. A janë lanë angllisht a jo këto fjalë jashtë? Ndoshta zotni Franja tash kthen xhevap, pse asht e pamundun m'e hamendsue. Këtu, ndërkohë, nuk po trajtoj fjalët që Kulli i shënon si të veprave të tjera, e jo të LM si: "*hore...AP*" (Ku. 71), kur në *Lahuta* asht "*Si t' kish' kenë ti nji grue hore*" (VI, v. 153); "*ngërthye...MA*" (132) vs. "*Vetllat trashë ngerthye kulár*" (LM, I, v. 302), "*Ngerthye vetllat m' shtek të ballit*" (IV, v. 43), "*ldhtë ngerthye ato vetlla t' trasha*" (VI, v. 478), "*Ngerthye Lleshi, bâ si grep*" (XVI, v. 203), "*Qafen krrabë e ká ngerthye*" (XVI, v. 276), "*Edhë qafa i âsht ngerthye*" (XVI, v. 300), "*Kuk ngerthye kthetrat gjaksore*" (XVII, v. 376), "*Ngerthye kuk, dj duert mbí varrë*" (XVIII, 154), "*Kerleshë ftyrës, ngerthye kulár*" (XVIII, v. 660), "*Kuk turînit ngerthye 'i pllamë*" (XX, v. 486), "*E ngerthye vetllat m' shtek t' ballit*" (XX, v. 486), "*Ngerthye shllungë do vetlla t' trasha*" (XX, v. 714), "*Me nji hundë si shpuer ngerthye*" (XXI, v. 546), "*Nji pash*

brynat hânë ngerthye” (XXII, v. 293), “*Por sÿ’n zjarm, vetllat ngerthye*” (XXII, v. 807), “*Doren m’ hundë e kuk ngerthye*” (XXIII, v. 325), “*E ká pá si atÿ, ngerthye / Shtatit...*” (XXIII, vv. 365-6), “*Qi u bje shqypja, ngerthye kthetërat*” (XXIII, v. 717), “*Ngerthye m’ ballë vetllat si rrfëja*” (XIV, v. 234), “*E vetllat ngerthye kulár*” (XXV, v. 128), [tash si ndajfolje] “*Vithet drejt, bishtin ngerthyet*” (XXV, v. 179), “*Ngerthye vetllat shllungë n’ mes t’ ballit!*” (XXV, v. 783), “*Me ‘i dhâm n’ gojë ngerthye si capë*” (XXV, v. 1088), “*Strehë ngerthye do vetlla t’ trasha*” (XXVII, 120), “*Idhtë ngerthye ato vetlla t’ trasha*” (XXVII, v. 247), “*Qafen kuk, bishtin ngerthye*” (XXVIII, v. 391). Pra një folje që del me intensitet të naltë prej kangës së parë e deri tek njëzeteteta, **26 herë** dhe **1 herë** si ndajfolje, e për ma shumë si konstrukt frazeologjik, nuk del si përdorim në LM simbas Kullit. Mungon shënimi për *Lahutën* në fjalën “*pushkaliqe....PSH_{P10}*” (Ku. 158), e cila gjendet në vargun “*Bâjn « novicat » pushkaliqe...*” (XVII, v. 562). Gjithashtu, “*rabush...AP*” (Ku. 162), e në *Lahutë* asht me kuptim figurativ (me e ba hesapë, e me nda mendjen, me e marrë parasysh; jo si në kuptimin e parë çetele, turq., si në shqip, a *cedola*, ita.) në “*Qi e ká vû ka dit m’ rabush*” (XI, v. 277). Zotni Franja përpos se nuk e cilëson si fjalë të LM, hyn nëpër megje të

Toskërisë tue e shpjegue si bishti i trashë i qepës që nuk hahet. Drue se edhe kjo punë i ka dalë *ngallicë* pasha bukën! Ai e shpjegon si fjalë në *Anzat e Parnasit*. Le ta shohim a e ka përdorë Fishta në këtë vepër në kontekstin e toskërishtes. Me çka kam evidentue, në AP, “rabush” del katër herë, khs. “*Pse mund t’ dalë kushdi se kush / Qi merr fjalët* e i vën n’ rabush*” (*Gjuha e mësimit*, 36);⁵¹ “*Pa kqyrë m’ rabush sá i randë ásht napoljoni*” (*Palokë Cuca*, 138); “*Pa vû oroe se kû isht’ tue qitë rabushi*” [edhe këtu fig. pa e llogaritë se ku po e çon kjo mendje], (*ibidem*, 152); “*Ka nji ka nji t’ i vête m’ rabush*” (*ibidem*, 158) — i merrte parasysh nji kah nji. Pra askund nuk lidhet mashkulli i qepës me vargjet e Fishtës, përveçse në shpjegimet e Kullit. Nëse autori i ka vû qëllim vetes me shpjegue fjalët e përdoruna në veprën dhe kontekstin e Fishtës duhet me iu përmbajtë këtij kriteri dhe jo me e mbushë me handrak të *fjalorëve të kuqë* (tradiës komuniste shqiptare), të cilët kanë ardhë mbas Fishtës në traditën shqipe. Shembuj të kësaj natyre, ku nuk cilësohet përdorimi i fjalëve në

* errata, lexo: *fjalët*.

⁵¹ Citimet nga P. Gjergj Fishta, O. F. M., *Anzat e Parnasit*, bot. III, Shtyp. Shkoder “A. Gj. Fishta”, 1942. Anastatik i BF (bot. VIII, Shkodër, 2007).

LM, ka prapë por nuk e shoh të arsyeshme me u zgjatë ma.

Po kaloj, në shtjellimin e çështjes se çka mungon prej fjalësit të *Lahutës*, në fjalorin e Frano Kullit. Kriteri i ndjekun në këtë hulumtim asht si vijon **1**-shënimi i fjalës që mungon prej tekstit fishtian, *LM*; **2**-shpjegimi kontekstual i tyne; **3**-shënimi i vargut përkatës me krejt frekuencën e saj në tekst (ku asht e nevojshme), në mënyrë që me u pá ngjyresa stilistikore dhe probabiliteti i një a ma shumë kuptimeve, qoftë edhe aspekti figurativ.

Në fjalorin e Kullit, prej poemës epike *Lahuta e Malcís*, mungojnë:

admiral-i: “kryekomandant flotash ushtarake, gradë ushtarake”; khs. Gje. 700, Lu. 69. “*Kû Admiralat m’ breg sa dolen*” (XXX, 314). Mbi prejardhjen etimologjike të kësaj fjale shih To. 73-4.⁵²

argjan-i: “argjend”; khs. Lu. 72, Gje. 21-passim “*Krejt n’ argjan kandakut ngrí*” (I, 374); “*S’ bâhet pushka: e falë Rrushmanit / I a ep, me namli prej vedit, /*

⁵² Kolec Topalli, *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2017.

Rrushit at herë një pip argjanit" (XX, vv. 801-3); *"Qitun ballin, qëth argjani"* (XXIV, v. 735);

argjantë (i, e, të): "argjendte (i, e, të)". "E për rreth t' argjantë t' currilit" (VIII, v. 125); "N' ujna t' gurra vet t' argjanta" (XXIV, v. 96).

bijoc/i-as: "ushtar/ë në LM, prej fshatit Bijoc (Lu. 77)/Bioca (Gje. 62) në Malin e Zi, ose vllazni malazeze rreth malit Rioce, ndërmjet lumit Pive e Vernica, De.² (22)". Ma saktë toponimin duket se e jep El.-Ma. në *Glosarin e HL*, (405), Bioçe. Khs. "Katerqind Bijoca t' ri" (IV, v. 163); "Një taborr Bijocash s' ri" (XXV, v. 646); "Turr Bijocasit pik s' pari" (*ibid.*, v. 659); "Bijocasit n' luftë kan rá" (*ibid.*, v. 668).

breme (i, e, të): "bré ose damtue tëjet a vemjesh"; khs. Gje. 449, Lu. 78 për "T' breme krîjet e t' tanë plasa" (XXI, v. 531).

breshkujzë-a: "breshkë ujit"; khs. Fj. Bashk. 51, De. 474, Lu. 79 për "Qi, si ushujzat e breshkujzat" (XXVI, v. 298).

bryna: "brîna, sh."; te Fishta përdorë në kuptim figurativ për matje ndërmjet luftarësh, me bartje kuptimore sikur brinat e kafshëve: demi, kau etc. (përpos XXII, v. 293). "Kapërthye brynash n' mjet vetit" (VI, v. 431), me u kapë shoq me shoq; "T' ketë

ky bryna, si ká kau." (XIX, v. 68), fig. të ketë fuqi sa të dojë, Gje. 339; "*Nji pash brynat hânë ngerthye*" (XXII, v. 293); "*E me bryna tue e dermue*" (XXIII, v. 616).

brynatak-u: "që ka brîna të mëdhaja"; khs. Kol. 19, Lu. 79 për "*N' qafë t' nji skjapit brynatak*" (XXVI, v. 250).

bubitë (me u): te Fishta ka kuptimin "me u goditë, ndreqë a zbukurue"; khs. De. 474, Lu. 80. *Fj. Bashk.* (54), si edhe ai i FGJSH (1954). Ky i sprasmi, simbas Kol. (19-20), foljen *me u bubitë*, ose *bubis*, e jep *me u çmorritë*, me pastue morrat, sikur *Fj. Bashk. spidocchiare*. Këtë shpjegim e cekë edhe Lu. i cili porsi De. sugjeron përdorimin figuracional, pse konteksti në *LM*, në të vërtetë, asht si ma nalt. "*Floçka e Kshetza ndëjë n'shullâ, / Tuj u krefë, tuj u bubitë, / Shoqja shoqen tue ngallitë*" (XXVI, vv. 291-3). Nësa edhe Gje. (618), e paraqet shpjegimin e tij si ai i *Fj. Bashk.*, e FGJSH 1954, kur pohon "*tuj u pastrue, dli rë krejet*". Kol. e nënkupton si folje vetëm për shpezët, dhe kontekstin e *Lahutës s'e rrahë aspak*.

bunjet-i: "toka me busha, bushnjesh (De. 474, Lu. 81), e shpjegueme ose edhe si tokë me bungje, bungajë (Gje. 400, 567, Kol. 22)". Khs. "*T' mbetne shkret neper bunjet*" (XXI, v. 87); "*Gallamarde kthellitë bunjetit*" (XXV, v. 190). *Bushnjesh*, me këtë trajtë, del

edhe tri herë të tjera në *LM*. Për De. (474) e Lu. (82) *bunjëti* asht baras me *bushnjesh*. Nësa për Gje. (372) e Kol. (23) jo. *Bushnjesh* ndërkohë del e shpjegueme te Ku. (19).

cecatë (me): “me e grimcue, me e dhambçue, me e therrmue (me mjet prés)”. De. e shpjegon “*me ndá copa-copa, me e pré*” (475); Gje. “*me e dermue*” (477); Kol. e interpreton si “*vizatje thike para e mbrapa*” (43). Ku. siç e shpjegova ma nalt e ka “*cekatë*” që nuk ekziston askund në *LM*. Nikollë Gazulli në *Fjalorthin e rí*,⁵³ e shpjegon kështu këtë variant fonetik të kësaj fjale, të përdorun në Malsinë e Madhe: “*cëkue (M.M.) ckue, cëkatë, v. akt [verb aktiv, shtojcë e imja], me gicë (MR-Mirditë, ibidem) me dhambçue lehtë*”. Kulli veç dy fjalë ma poshtë se “*cekatun*”, shpjegim thuejse identik si i Ga., e ka pasë me e gjetë foljen “*me cecatë*” [*cekatë*], e cila del unike për kah aspekti grafik e fonetik te Fishta në dallim me fjalorët, a shpjegimet e masipërme. “*Si kasapi e ká zanát / Kúr pret mish, aj me tagan / Ká nisë m’ arrç me i a cecatë*” (XXIII, vv. 246-8).

⁵³ *Fjalorth i rí (Fjalë të rralla të përdoruna në Veri të Shqipnis)*, Visaret e Kombit XI, Tiranë, 1941, 81.

Cernagore-a: “Mali i Zi”, me një shpeshitë prej 17 herësh në *LM*; e panevojshme me u shënue krejt evidenca e saj, sepse asht referencë standarde, e pandryshueshme për kah ngjyresat stilistikore. Në vijim, nëse një fjalë del e arsyetueme si ma nalt, ka me u shënue me këtë simbol ||. “*Qi shka âsht Turk i Cernagores*” (I, 295). Po ashtu IV, v. 80, v. 189; VI, v. 91; VII, v. 63; XV, v. 156; XVII, v. 248, v. 258, v. 272; XVIII, v. 96; XX, v. 109, v. 188; XXI, v. 185, v. 199, v. 419, v. 464; XXX, v. 317.

cirikokë-a: “stërqokë”; khs. Gje. 324, Lu. 84. Te Ku. del vetëm varianti tjetër i këtij emni “cilikokë” (21), përdorë tri herë në *Lahutë*. “*As me trêmë do cirikokë*” (XX, v. 262).

cingare-ja: “cigare duhani”. Shih “*Kryet e burrit p’r’i cingare*” (X, v. 78) || XXI, v. 501.

cyklopik-e: “vigane, katallane, të stërmëdhaja”; khs. De. 476, Gje. 612-3, Lu. 85. Shih “*Ngrefë mbí ledhe cyklopikë*” (XXVI, v. 154).

çapok-u [*çapue-çaponi*]: “soj thoni i trashë e i fortë, kthetër te shpezët grabitqarë apo kafshët e egra”; khs. De. 476, Kol. 35/1, Lu. 86. Shih “*Vorri Tringës kû do t’i u çilte: / E kû ato, me do çapokë / N’ thoj-çengela mirë t’ forcuem*” (XXIV, v. 417-9). **Çapue**, sh. **çapoj** –

përdorë te Fishta në kuptim figurativ për *grabitës*, *plaçkitës* ose *dhunime*, *grabí* si f.v. “*Shqyptarín se si m’ e pshtue / Prej çapojve t’ Malit t’ Zi’*” (IX, vv. 8-9); “*Kshtû at herë Shkjau i u rras Shqyprnís / M’ Kaçanik, e m’ Adrjatik, / Veleçik, e Salonik, / Tue ndrydhë vendin nder çapoj’*” (XXIX, vv. 285-8); “*Kí mishrirë per ta, pra, o Zot! / E mos lën qi hasmi sot / T’i bâjë dâm: por pshtoi rrezikut / E forcë epu kundra anmikut, / Qi po u rrin shqype mí krye / E m’ çapoj, gjithmonë n’ gjak zhye’*” (XXIX, vv. 384-9). Kuptimin e *kthetrës* (së luanit e tigrít/es), e ilustronjë vargjet në vijim: “*Me do dhâmë porsì kortela, / Do çapoj thue janë çengela’*” (XXIII, vv. 138-9). Ku. (24) e ka “*çapua-çipua* (sh. *çapoj*)”, dukshëm trajtë e toskizueme, dhe shprehet se përdoret në *AP* dhe *HD*, e jo në *LM* çka u vertetue ma sipri. Por kjo trajtë, sikurse e propozon Ku., as në *AP* nuk del. *Çapoj* edhe në këtë vepër, del si në kuptimin figurativ në *LM*, te vargjet “*Nen hajat të Parrîzit’*” (98), “*...e atë pëllambë vend Shqyprnijet, qi kishte pshtue prej çapojve të Slavit e të Grekut...’*”

çibuk-u: “llullë, kamish; fjalë e turqishtes dhe me përdorim në shumë gjuhë sllave, si edhe në gr. të re

dhe fr. (shih Diz.⁵⁴ 168, To. 338)". Khs. "Nji me çallmë, si me kênë turk, / Me tesbih e me çibuk" (XI, vv. 60-1).

çilibar-i: përndryshe "qelibar", e shpjegojnë si De. 477 dhe Lu. 88, por shpjegimi i Lok Limthit (8) më duket ma përplotës: "Em. pers. (*kehlibar, kehribar-keh* = *kashtë, rubá* = tërhjekës) = Kelibár. Përpunohet prej rrëshine e thëngijsh toke dhe asht një landë gjymës transparente, e fortë dhe e brithët, qi thehet shpejtë. Përdoret, në vendet t'ona në çibukë, në cigarishte dhe në tesbih (rruzare)". Shih shpjegimet e Diz. 789, si dhe To. 1210 në lidhje me prejardhjen etimologjike të *kehlibar*. Khs. LM "Atí i fali: pip telishit, / Me 'i çilibar m' tê sa i voe" (XX, v. 805), kokërr, rruezë qelibari për me zbukurue çibukun.

darë (me): "me humbë, me bjerrë, me tretë, me shkapërdâ"; khs. Fj. Bashk. 80, Gje. 578, De. 478, Kol. 39, Lu. 90., To. 358. "A mos doni m' e vendue / Me mue n' rrogë, per t' m' ruejtë do lopë / N'Palabardhaj?... Mjaft po drue / Se m' i darë, orë-ligu, n' shkjojë..." (XXV, vv. 489-92). Ku. e ka "darej" (28) dhe e regjistron si folje me përdorim në VP, PP, LSHK.

⁵⁴ Tahir N. Dizdari, *Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe*, *ibid.*

dejlan-i: ose edhe *dajlan*, “rrethojcë kallamash a hûjsh, që bahet nëpër derdhje apo gryka lumejsh, për me xanë peshk”. Fj. *Bashk.* e shpjegon si “*ksolle me zânë peshk*” (78), njilloj dhe De. 478, Gje. si “*prita të punueme për të nxanun peshk*” (493), Lu. “*pengesë... e ndërtuar me hunj e thurimë në formë trine për të nxënë peshq me shumicë*” (91). Khs. edhe shpjegimin e për afërt, me sa ma nalt, në Buf.-Ro. 120. Gjanësisht këtë fjalë me burim pers e turk, e shpjegon Diz. (189) tue citue edhe Fishtën. Khs. LM “*Se s’ po i’n krep me u zânë dejlanash*”. Lidhun me këtë varg po shtoj se fjala *krep* sh. i *krap* (s’ di a mund të jetë ndeshë në studime gjuhësore ky rast kund) asht ndërtue me anë të metafonisë si të tipit *dash-desh*. Shembulli i fundit, përkon me përdorim të mbarë shqipes. Ndërkohë, shumësi i përdorun nga Fishta këtu, ka formësim analogjik kisha me thanë me gegënishten e hershme të tipit *kat-kete*, që ndeshet edhe në *Eposin e Kreshnikëve*. Për këtë shembull ka folë edhe studiuesi Kolë Ashta.⁵⁵ Fjala *krep* në këtë kangë të LM, nuk duhet me u ngatërrue me rastet e tjera

⁵⁵ Shih K. Ashta, “Elemente të lashta gjuhësore në Këngët e kreshnikë”, në *Çështje të folklorit shqiptar 3*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, 1987, 314.

homofonike “*Bâne zêmren gúr e krep*” (VIII, v. 46). “*M’ krep t’ Rragamit neper prita*” (XV, v. 80); “*Ká bâ zêmren gúr e krep*” (XXIII, v. 742) etc., që ka kuptimin e *shkambit* ose të një toponimi që lidhet me këtë emërtesë. Rasti *krap-krep*, asht shndërrim fonomorfolojik si në shumë nëndialekte të gegënishtes, sikurse janë disa raste në Dukagjin, shembuj gjuhësisht të neglizhuem, si *krah-krihë, shtrat-shtriten*. Nësa lidhun me Ku., asht interesant se tue shpjegue fjalën *krap* (95) dhe vargun e Fishtës, i cili u dha ma sipër, çuditnisht ka shpjegue dhe fjalën *dejlan* edhe pse i mungon si leskemë e renditun në fjalorin e tij. Por kjo nuk asht hera e parë.

div-i: “vigâ, shumë i madh”. Khs. “*Shtatin div, e sý’n si zhgjeta*” (II, v. 123). Nuk shënohet kund nga komentuesit apo leksikografët e Fishtës, por ngjanë se Poeti e ka përdorë edhe në trajtë ndajf. “*tejet, jashtë mase*”, si “*N’ pellg të detit div shperthye*” (XXV, v. 255), ose mund të kemi një afrim me atë që thotë Diz. (217) për ngjyresat që gëzon kjo fjalë (me burim pers > turk) në gjuhët sllave: me *duf*.

djelmni-a: në LM ka kuptim përmbledhës, “tanësia e djemëve, grup-mosha e të rijve” si “*Bukë djelmnija kan marue*” (V, v. 32) [edhe shtatë herë të tjera|| XIII, v. 98; XIV, vv. 309, 310; XVIII, v. 355; XX,

v. 199; XXI, v. 378; XXVIII, v. 515]. Ndërkaq kjo fjalë ka edhe koncept kanunor si “N’ krye të vendit Bajraktarët, / Mandej Krént, mandej Gjobarët, / Me djelmni e me Vogjli, / Mbas kanunit në Malci” (XXI, vv. 376-9). Ky term, në *Kanû të Lekës* asht institucion, përfaqsi që merr pjesë ndër kuvende, gjyqe e peshime; ata janë edhe *giobtarë* (persona të caktuem në vjeljen e jobës).⁵⁶ Khs. në KLD § 875, 1106, 1111/e, 1170.

doradoras: ndajf. “kapë dorë për dorë”. “*Doradoras tue këcye*” (XXVI, v. 210).

eburn-e: “prej fildishi”; khs. De. 479, Gje. 541, Lu. 97 për “*E me t’ shmajten llanë eburne*” (XXIV, v. 748).

Empir-i: “kupa e qiellës, selia e Perëndisë dhe e të Lumve, pambarimi”; khs. De. 479, Gje. 66-passim, Kol. 52, Lu. 97. To. 445, e interpreton me të drejtë si fjalë të regjistrit poetik, dhe citon vargun pasues të Fishtës nga LM. “*Ravës s’ amshueme t’ t’ naltë Empirit*” (IV, v. 261); || IX, v. 366; XXI, v. 6; XXIV, v. 124; XXIV, v. 737. To. po ashtu e nënkupton si huazim të

⁵⁶ Shih §1171 “*Giobtarë thirren ata, të cillt n’ êmen të kuvendit mbarë reshten në vath të gjâs së të giobitunit, per të mârrë aq krenë desh a qé si mbas së premes së gjygjit të krenvet, të Pleqve, e të Vogjlis.*” Át Shtjefen Gjeçovi, OFM, *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, botimi III, Shkodër: BF, 2010 [anastatik i bot. I, 1933], 140.

shqipëse prej ita. *empireo/empiro*, e ma heret prej gr. *ἐμπύριος* [*i përflaktë*]. Në fakt, ky i mbрами, nuk e shënon se lat. e ka huazue ma parë se ita. në trajtën *empÿrÿu(m)*, fjalë e cila në kulturën mesjetare të krishtënë, parakuptonte dritën shpirtnore të qiellit. Shih për ma shumë Tullio de Mauro, *GDIU*.

eshitim-i: aferezë e “heshtim-i”, tipike në traditën geqe të Shkodrës si f.v. *orizon(t)* për *horizont* (Camaj etc.), kur *h*-ja nistore bjerret. E kundërta ndodhë, kur ky tingull shtohet në fjalë që të folme të tjera të shqipëse nuk e njohin, si *hagrep* për *ak(lg)rep*, me *hecë* për *me ecë*, *halá* për *alá* etc.; gja që u cek ma sipër. Shih edhe Gje. 587, Lu. 98 “*Shukë âsht zani, e ‘i eshtim vorrit*” (XXV, v. 714).

faculetë-a: “italianizëm për *shami-a*” në “*Muamedant në luftë s’ kan dalë, / Veç per t’ shitun faculeta*” (XXX, vv. 241-2).

falme-ja: *falxë* [Fj. *Bashk.* 105] a *falëz* [Ga. 125 dhe FGJSH], “*gypthi ku futej baruti për me krye shkrepjen ndër armë të vjetra*”; khs. gjithashtu Gje. 496, De. 480, Kol. 56, Lu. 99 “*M’ ka pasë kë në një falme agzotit*” (XXVII, v. 420). Kudo në *Lahutë* përdorë me sintagmën *falme agzotit* (barutit), dhe me të njëjtin kuptim. || XXIII, v. 739; XXV, v. 88; XXVIII, v. 49.

faltor/e-ja: “tempull, vendi ku besimtarët shkojnë me u falë”. “Kuerdo t’ jetë kysmet me i dalë / Turkut dore Shqyptarija, / Posë falsoresh, ku me u falë, / N’ Shqypni ‘i shêj a e lën Turkija?...” (XXVII, vv. 99-1-2).

falmeshndet: “trajtë e përngjitun urimi, formulë e gatshme në krye të letrës apo kuvendit mes palëve”. Shih “Falmeshndet Cari i Rusís” (I, v. 212), || IX, v. 519; X, v. 246 dhe XVIII, v. 791.

famullí-a: “njësia ma e vogël administrative (nën një dioqezë) e kishës katolike, ku komuniteti përkatës asht nën kujdesin shpirtnor të meshtarit a ndryshe famullitarit.” Shih “Qi, per krah me famullí”, (XIX, v. 120 + v. 135: *Famullí e miqasí* + v. 213: *Por miqsí edhè famullí*).

farue (me u): “me u shfarue, me dalë a me u qitë fare; me u asgjasue”, përdorë në “Kta per mue, Zot, u farojshin! Kurr mos kndojshin! mos vallzojshin!” (XXIV, vv. 782-3).

feksue (me): “me ndriçue, me ba me mendue”. Khs. Fj. Bashk., 107 [Ga. *feskue (me)*, 129], Gje. 620, De. 480, Lu. 100. “Kan rysë gjinden me feksue” (XXVI, v. 335).

fergue (me): “me skuqë në fultere, tos. *tiganis*”. Khs. “Ndoj déll ujkut per t’ fergue” (XXVI, v. 264).

ferlik-u: “berr, bagëti e imtë e pjekun në hell.” Shih “*Drekë e darkë ka nji ferlik*” (X, v. 140). Po ashtu khs. || XVI, vv. 429, 442; XIX, vv. 216, 264.

fershllue (me): “murmurima, zhurma që përftohet prej lëvizjes së gjetheve, flatrave të shpendëve a zjermit në kontekstin e LM”. Shih “*Edhe dushku ç’ fershllon malit*” (XVIII, v. 741); “*Trêmshim zogjt prej lisash dalin, / E nji fushen, nji merr malin, / Neper muzg fershllajn me fletë*” (XXII, vv. 199-201); “*M’ voter flaka kah fershllon*” (XXII, v. 705).

fesat-i: “ngatërresë, davá, tolloví”. Ku. (49) e jep identik sikur Gje. (648: *kryengritjen*). Besoj se konteksti i vargjeve të *Lahutës*, asht ma shumë simbas shpjegimit të De. (480) e Lu. (i cili e jep gabimisht *fesad*, 100) që mbështet me sa kuptohet në *Fj. Bashk.* (108), interpretue si *pështjellim, kundërshti*, si dhe Diz. 272. Vargjet janë: “*Bedri Pasha, kúr ká ndí / Se ç’po bâte ajo Malcí, / Per liri e per Shqypní, / Fort â mbushë aj me mëní, / Grushta krés, besa tue i rá, / Askjer n’ Shkoder ke s’po ká, / Fesatin n’ Malcí me dá*” (XXVIII, vv. 180-6). Pra me dá “punën”, në kuptimin e *çështjes, davasë*, tue peshue (pleqnue) sesi me e shue kundërshtinë, *kryengritjen e Lekëve*. *Kryengritja*, nëse i besojmë Ku. e Gje., simbas strukturës së vargut fishtian, nuk *dáhet* (në kuptimin *me shestue a*

caktue). Në botëkuptimin e Fishtës në LM, dáhet *gjygi e pleqnia* (khs. I, v. 286) ose: “N’ at Berlin u dá *pleqnija*” (VIII, v. 155); dáhet *mejdani* “M’ breg t’ *Moraçës tue dá mejdantin*” (III, v. 225), *kanuja*: “Me *prità peng, me dá kanû*” (X, v. 292) apo *kuvendi*, si në “*Foli Çuni e u dá kuvendi*” (XIII, v. 282). *Me dá mandej*, si folje, merr tjetër kuptim në *Lahutë*, si: *me coptue, me shkëputë, me e ftillue*.

filtár-i: “shishe e vogël, shishke e përdorur zakonisht për barna likuide”. Tue iu referue ndërtimit të vargut e vargjeve ma poshtë të *Lahutës*, e simbas shpjegimet të Gje. (290), *helmi* në këtë kontekst ndoshta duhet peshue si lloj antidoti përdorë prej barnatorëve popullorë, kur një person pickohet prej ndonji tokësi apo araknidi, si p.sh. *voji i akrepit* njëhej gjanësisht ndër shqiptarë si shërues ndaj pickimit të mundshëm të këtij të mbramit. Në lidhje me *filtár* khs. *Fj. Bashk.* 110, *De.* 480, *Lu.* 101. *Kol.* (63), e konteston shpjegimin e Gje. Struktura e vargut në të cilën kjo fjalë përdoret (vetëm një herë në vepër) asht një strukturë simetrike si në disa vargje të tjera në poemë. Khs. “*T’ idhtë si helmi ruejtë n’ filtár*” (XXIII, v. 392) me “*Idhtë si helmi ruejtë në shishe*” (XVII, v. 376) dhe “*T’ idhtë si helmi ruejtë n’ gastare*” (XXV, v. 625).

fillue (me u): “e përdorun me anë të foljes *jam*, në vend të *kam* (sikurse në disa të folme të shqipes: *jam shkue, jam ardhë* etc.), dhe që bartë kuptimin e *jam nisë*”. Shih “*Prej Sutjesket janë fillue*” (XIX, v. 399); “*Malit thik na janë fillue*” (XXIV, v. 1100).

fiskajë-a: te Ku. shpjegohet si përdorim vetëm në HD_{P9}, PSH_{P10} e me të drejtë si “curril uji” apo ndryshe “cerlek a çuterr”. Por në LM, kjo fjalë ka edhe përdorim të figurshëm: *të holla* e *mbase* edhe *të drejta* [thuprat a degët] sikurse vargu prej *Eposit të Kreshnikëve* (“*Martesa e Halilit*”, Palaj & Kurti: 1937, 27, v. 86) në “*Vetulla e saj ndrejt si fiskaja*”; khs. te LM “*Me ato vetlla si fiskaja*” (XXIV, v. 131). Po shtoj se Elsie dhe Mathie-Heck, të njejten fjalë (*fiskajë*, pra) kur kanë përkthye dy vargjet që sapocitova e kanë dhanë për *Eposin “tree branches”* e ndërsa për *Lahutën “willow branches”*.

flat/er-ra: “krah, fletë”, përdorë te Fishta për figurat mitologjike, Zana ose Ora, disa herë dhe vetëm një herë për shpend. Khs. “*Edhë e Mira, nalt prej kepit / Kû kisht’ zanë, e thik perpjëtë / Ndë ajo flatrat e prarueme*” (XXIV, vv. 259-61) ose “*Luften tue soditë të Lumet, / I a kan behë ato vetimë, / Disa vetmas, tjerat plimë, / Tue rrahë flatrat nper ajri*” (*ibid.*, vv. 315-7) || në po kjo kangë, vv. 689, 692, 1067 si dhe në kangën XXV, vv. 66, 1003; “*Si turflon rosa n’ shirok, / Tue rrahë flatra neper Drî*” (XXV, vv. 409-10). Shih për ma

shumë shpjegimin e Kol. 63-4, mbi arsyet pse Poeti ka parapëlqye me e përdorë këtë fjalë për figurat mitike.

flok-irig-i: “kompozitë, neologjizëm fishtian i cili përshkruen karakteristikën e flokëve të personazhit në *LM*, si të ashpra e përpjetë”. Shih edhe Lu. 103; khs. “*Atÿ at herë Pipo Gërrzhiqi, / Mustak shtupa, flok-irig-i*” (XXIII, vv. 863-4).

flok-prarueme-ja: “kom. e përdorun për krijesat mitike, që mund të konsiderohet edhe një rast eufemistik”, khs. “*Zana e Madhe e Vizitorit / Me ato tjerat flok-prarueme / Motra t’veta Shtouzovallet!*” (XXIV, vv. 672-4). Mbiemni (*i, e të*) *prarueme*-e regjistrohet edhe në *Fj. Bashk.* (361), “i lamë, ose në ngjyrë të artë”. Natyrisht ma herët ky mbiemën asht përdorë edhe nga autorë të tjerë, këtu po xa shembullin e K. Kristoforidhit, alias Elbasanasit, në *Sbulesa*, 481: “*Edhe përaruem me ár e me gúr të nderëshim e me margaritarë*” [transliterimi im, + || 484] në *Dhiata e Ré* (Konstandinopol, 1872), përkth. në gegënishte. Shih edhe shpjegimin e Lu., 103, mbi këtë kompozitë.

flladitë (me u): “me u freskue”, shih “*E vetë ftyret tue u flladitun*” (XXIV, v. 163); || *ibid.*, v. 293; XXVI, v. 49 e v. 276.

flligjë (me): “me fëlliqë, me ndye, me përlye, me zhye etc.”, përdorë në vargun “*Rrxo, rreno, e vendin*

flligj" (XXVIII, v. 28). Kol. (60) e ka konsiderue gabim shtypi këtë trajtë nëndialektore të zonës së Mirditës, tue hamendsue se ka një mospërkim me rimën e vargut që i paraprîn: *"Veç pre e rip, e digj e piq"*. Ngjanë që konstatimi për hir të rimës, mos me qenë i peshuem mirë nga ana e Kol. Fishta e përdorë rëndom trajtën *i, e, të flligët* (*"Bujari II"* [Anzat, 70]: *"Nji lngatë të flligët, mizore"*) ose *flligshtë* (*"Gomari"* [Satira, 2020: 187]: *"Zhytë ndër vese e ndër flligshtë"*), çka asht normativë e gegënishtes së asaj kohe. Këta dy shembuj që po cek janë ilustrues, dhe nuk asht në interes timin me zbulue variantistikën e një lekseme në shkrimet e Fishtës. Si rrjedhojë, përderisa grafikisht në këto raste del grykorja /g/ si pjesë ndërtuese e fjalës, duket e pazakontë që autori me zgjedhë variantin *flliq*, por një trajtë nëndialektore, siç e thashë ma sipër, e cila asht edhe pjesë identitare e origjinës së tij. Kur tham origjinës, i referohem Mirditës: topos që e ka përmendë vetë në veprën e tij autori. Khs. *"Shka do t' thotë, tash, "Hylli i Dritës" / Edh'aj Frati i dheut t' Mirditës"* (*"Gomari"/Satira, 67*).

forue (me): *"me zoritë, me ngushtue, me detyrue"*, mungon si fjalë te Lu.; del e shpjegueme te Gje. *"kur t'a ngushtojë ûja në muejin e dhetorit (Shën Ndrë)"*, 172. Edhe De. 481, për afërsisht e paraqet kështu, tue pasë parasysh rrajën emnore ofrue në Fj. Bashk. (113), *fore: "me i u kercnue, me i u vû kuj, me*

ngushtue, me i a perplasë kuj (me fjalë), me njeshë kend (me fjalë)". Kol. 61, dyshon për gabim shtypi, tue e pandehë për *me farue [a-o]*, mirëpo del se mendimi i tij asht i gabuem, për pasojë krejt deduksioni interpretues. Bahet fjalë për vargun "*Kur në Shndré t'a forojë zija*" (X, v. 179), ku kjo folje del vetëm këtu në krejt poemën e Fishtës. Në lidhje me këtë fjalë të shpjegueme nga Gje., si edhe komentarin e tij, Karl Gurakuqin në letërkëmbimet me Mustafa Merlika – Kruja, shkruen: "*Kishem me dashtë me t'i rreshtue disá nga këto shtjellime, por po shkoj gjatë e po të mërzis; fjala vjen me forue (shif "Lahutën" f. 172, rr. 179) në ket skedarin t'em spjegohet kështu: me shtërngue, me ngushtue, me vû në një gjendje të vështirë; të krahasohet fjala fore, qi d.m.th. ngushticë e madhe: e kapi forja, u ngushtue për së tepri*". [Letra e datës 4 nânduer, 1958.] Siç shihet, Gje. nuk ka ba ndonji lajthitje në këtë rast. Simbas mendimit tim, Gurakuqi ka manifestue një shêjë xhelozie për ribotimin e LM nga Gje., tue e konsiderue vepër me të meta (që natyrisht janë, sidomos në inkosekuencat ortoepike, apo mungesa në aparatën kritik), dhe se Gje. ishte "i ri" e nuk dinte shumë në zeje gjuhësie. Për sa i dëshmon K. Gurakuqi M. Krujës, ai thotë se i ka shkruar një letër vrejtesh, "predikim" Gje. [e njeita

letër ma sipër], mbasi ka dalë botimi, por ky i mbrami nuk i asht gjegjë ma. Madje i konstaton marrësit të letrës në lidhje me punën e Gje. se *“aq i ká punue të ngratit kërçiku; e ká shkundë thesin dhe ká qitë miellin qi ká pasë mbrendë”*. Ende pa dalë botimi, Gurakuqi, në një tjetër letër [Palermë, 10 prill 1958] i shkruen Krujës: *“Át Gjeçaj, qi e ká marrë përsipër kujdesin e ribotimit ástht i zoti, por, mbasi ástht i rí, kam frigë se mos del i mangët.”* Kësisoj kritikát e edicionit të dytë të LM, ba nga brezi ma i madh i Gurakuqit dhe i Krujës kundrejt Gje., ma i ri në moshë, asokohe 45 vjeç, përbajnë edhe një *“querelle de anciens et des modernes”* të botës së vogël shqiptare, edhe pse në ekzil. Simbas Gurakuqit, edhe Camaj, pothuej gjenerata e Gje., në botimin e romanit të tij *“Djella”* asht i mangët, madje *“shkjepon”* në pikëpamje gjuhe. Khs. letrën e Gurakuqit dërgue Krujës *Palermë, 27. 7. 1958*. Po shtoj se, në lidhje me foljen *me forue*, ngjanë ma se e habitshme që Ku. nuk e shënon këtë fjalë në fjalor të tij kur T.T. *“e shpjegon”* (138) dhe shprehet pothuej identik si Gje. veçse në standard: *“kur të ngushtohet nga uria gati për t’u shfarosur në muajin dhjetor (Shëndre)”*. Me sa duket, kriteri i pacak i përvetësimit ka sjellë dhe një problem tjetër këtu: arnimin e gegënishtes me

standardin/toskërishten. Nuk njihet asnjë toskë mbi këtë dhë që *ngushtohet nga uria*, sepse atë natyrshëm, e idiomatiksht, e *merr/grin uria*.

fregull-a: “flegër, bira hundësh”; khs. *Fj. Bashk.* 114, Gje. 570, Kol. 61, De. 481, Lu. 103 përdorë në “*Aj pa vesh e ky pa fregull*” (XXV, v. 285). Ga. 138 ka kontekst tjetër shpjegimi.

freskue (me, u): “me u flladitë, freskue ose me ba fresk”. Khs. “*Kë gjetë gurra me u freskue*” (VIII, v. 206) || XXIV, vv. 69, 558; “*S’ m’ kan freskue gurrat prej akullit*” (XXIV. V. 507) || XXIV, v. 880.

frÿtë (i, e): “të fryeme prej idhnisë” (shih Lu. 104); përdorim figurativ. Khs. “*Zëmërs s’ frÿt me i lânun dalë*” (XII, v. 98) || XXIII, v. 324.

fukara-ja: “i vorfën, skamnor” për “*Qi, ‘i grusht gjind e fukarë*” (XXIX, v. 20).

fyshek-u: “fishek për armë”. Khs. “*Sá per bukë e per fyshekë*” (I, v. 247) || XIII, v. 188; *ibid.*, 197; XXI, v. 548; *ibid.*, 717; XXII, v. 788; *ibid.*, v. 873; XXIII, v. 115.

fytafytyt: “ndajf., kapë fyt për fyt”. Shih “*Fytafytyt, ofshe! tue u pré*” (I, v. 87) || XXIII, v. 561; XXIX, v. 21; *ibid.*, 147.

gajtan-i: “spik, gjalmë leshi, kordon vû anash teshave si zbukurim”; khs. *Fj., Bashk.* 119, De. 482, Lu. 105, përdorë në “*Giatë s’ po e tierte, jo, gajtan*”

(XXIII, v. 832). Përdorimi këtu asht figurativ, në kuptimin “nuk po e çonte ma ndej këtë punë”.

galan-i: “dash i zi”, në “*Si dy bishta deshsh galana*” (XVIII, v. 653).

gardhiq/e-ja: “shumësi i gardh”, khs. *Fj. Bashk.* 121, Kol. 66, Lu. 106. Shih “*Shkapercè ledhe e gardhiqe*” (XXII, v. 249) || XXVIII, v. 419.

gdhî (me): “me çilë drita, me ague, me u çue prej gjumit” në “*E un do t’ gdhîj neser me dritë*” (XI, v. 129); “*Dër qi drita t’ nisë me gdhî*” (XXI, v. 175) || XII, v. 409.

gêmeholla: “kompozitë, mbiemën ndërtue nga gem + (i) hollë; neologjizëm i Poetit”. Khs. “*Kû nper molla gêmeholla*” (XXVI, v. 126).

gerthicë-a: “kërthizë”, në “*E t’ a muer mu nën gerthicë*” (XVII, v. 452)

gervishtë (me): “çjerrje e lëkurës, lendim i saj” në “*Gervishtë duer e gervishtë ftyrë*” (XXI, v. 632).

gostë-a: “banket i shtruem në raste të caktueme festive”, në “*Gostë as darsem nuk do t’ ngrifte*” (I, v. 158). Huazim sllav, shih To., 561.

grafë (me, u): “me grahë, vû përpara; në këtë rast me orientue kafshët”, në “*Mbandej dhît i vên perpara, / Edhë u grafë nper rrege e ara*” (III, vv. 53-4).

grënzë-a: “anzë, greth; idiomatike dhe figuracionale që mos me kërkue sherr, në mënyrë që mos me e pësue”; shih Gje. 121, Kol. 70. Khs. “*E mos*

nguc grênzat me krande / Perse ngucë të zezen t' ande" (VII, vv. 148-9).

grop-i: "çengel, grremç ose ganxhë, përdorë edhe si mjet luftimi në kontekstin e *Lahutës*". Shih "*Ngerthye Lleshi, ba si grep*" (XVI, v. 203); "*Kah me shkrepë edhe me grepa*" (*ibid.*, 327).

grizë (me): "Me hangër buzën dhambë, ose me kafshue, me çaraveshë". Khs. "*Grizë ká buzen nen mustak*" (XVIII, 471); "*M' dhamë i a grizshin misht e shtatit / Per gazep...*" (XXV, vv. 1125-6)

grrye (me): "fig. me germue, me kapë, me pervetsue diçka që nuk të përket" në "*Msue gjithmonë n' gjâ t' huej me grrye*" (I, v. 171); "*As me grrye pse due m' gjâ t' huej*" (XVII, v. 253); || XIX, v. 6, XXIII, v. 7. Fishta e përdorë prapë edhe në një kuptim tjetër figurativ, për *me verbue, me çukatë, lanë pa sy*, kur i drejtohet Malit të Zi në "*Serbin shqype ké mbí krye: / Ká per t' lânë ky 'i ditë pa sý, / Kthelltë në rrashtë, po, tue t' i grrye*" (XXI, vv. 339-41).

guna-zí: "kompozitë, *gunë-a + (i) zi*; dhe i referohet zhgunit françeskan të Pater Gjonit" në "*Veç ti a e ngef njat guna-zí*" (XIX, v. 111). Termi asht me randësi të posaçme letrare e historike. Si aspekt letrar prania e një kleriku katolik në luftë, afrohet si motiv me *Kangën e Rolandit*, ku Arkipeshkvi Turpin merr pjesë në luftën kundër saraçenëve. Asht përfolë

ndër kritikë si ndërlidhje autobiografike, ose si autoprojektion i Fishtës, por tue iu referue Demës, mësojmë se Pater Gjoni i Fishtës asht P. Giovanni Russo, i lemë në Frattamaggiore më 21.11.1831, e i cili u shugurue më 10 qershor 1853. Më 10 korrik të 1859 u dërgue prej eprorëve të vet me mision françeskan në Shqipni (zonën e Kastratit). U kthye në Itali, në moshë të shyeme, në 1915, mbas shërbimeve baritore në Shqipni. Ndërroi jetë e u vorros në Napoli, në 1924.⁵⁷

gungë-a: “bullungë; e përdorun edhe me intensifikim ritmik ose ndërtim të thjeshtë për me përshkrue përçudnim, shëmti” në “*Kryet e tij t’ tanë gunga-gunga*” (XVIII, v. 477); || XXV, v. 590; “*Kryet e tij si një rrâjë bunge, / Të tanë neje e të tanë gunga*” (XXIII, vv. 85-6);

gurabí-ja: “lloj ambëlsine e përgatitun me miell, gjalpë etc., e që piqet në furrë; një version pak ma

⁵⁷ Shih Sosio Capasso, *Due missionari frattesi: Padre Giovanni Russo (1831-1924); Padre Mario Vergara (1910-1950)*. Istituto Di Studi Atellani, 2003 dhe *Raccolta Rassegna Storica dei Comuni*, Vol. 29/Anno 2015, Istituto Di Studi Atellani, 2016, 139. Dhe L. Kola (recension), “Át Benedikt Dema, OFM, *Fjalori Historik - Gjeografik - Mytologjik i “Lahutës së Malcís”*, Shkodër: Botime Françeskane, 2021, 144 ff.” *HD*, Vjeti XLIII - Janar - Qershor 2022 - Nr. 1 (305), 100-5.

hershëm i biskotave të sotme". Të vjetrit e kanë quejtë edhe *kulaç i ambël*, shih *Fj. Bashk.* 135 dhe *De.* 483. Poeti e përdorë figurativisht (për hiçgja) tue iu referue madhësisë së saj kur thotë: "*Na ká shitun Malit t' Zí / Per një rrotull gurabí*" (*X*, vv. 216-7).

gurní-a: "kurní, vorbull, tallaz, dallgë" në "*N' gurní t' prrojevet shkumuese*" (*XXV*, v. 855).

gvê-ni: ... Ku. e ka *gavyell* (?) "(shum. *gavej*) *Secila nga katër pjesët e rrotës së qerrit*" dhe e shpjegon pjesërisht si FGJSH i cili thotë: "**GAVYELL** *m. Secila nga të katër pjesët e drunjta të rrethit të rrotës së qerres; rrethi i drunjte i rrotës së qerres, mbi të cilin mbërthehet rrethi prej hekuri, vëng.*" Mandej Ku. përpiqet me rrahë dhe kuptimin e *Lahutës*, por për fat keq, qysh në krye, rrota e qerres asht jashtë kontekstit të kësaj poeme. *Gvêni*, e jo *gvyelli* (siç thotë *Lu.* 111), asht *gdhê*, lloj pishë a çetine, e këtë shumë mirë e shpjegojnë *Fj. Bashk.* 134, *De.* 484, *Gje.* 516, *Kol.* 72. Ndërsa *Lu.* e interpreton si zgavër nëpër trungje, shkaktue prej kohës. Mendim që nuk gjen pajtim me mue, për sa arsyetova ma sipër, dhe nuk përlijet me vargjet e autorit dhanë në vijim. Fishta e përdorë në shumë këtë fjalë, shih për ma shumë kontekstin që i referohet në vv. "*Zana e Madhe, strukë nder zgavrra /*

Gvêjsh jetikë, a nper gallushtra / Bigash s' mrazta..." (XXIV, vv. 79-81).

gjaje: "gjoje, gjueti" shih. Lu. 111, në "*E sikur njatà gjuetarë, / Me shumicë qi dalë per gjaje*" (XII, vv. 128-9).

gjakfalë: "kom. e pamotivuese grafikisht në LM, sikurse edhe *gjak hupcë*; strukturë paralele me të këtë fundit, ndoshta neologjizëm fishtian që don me thanë *gjak i falun*" në "*Si gjak hupcë s' shkoi Gjur Kokoti: / Si Milloshi s' mbet gjak falë*" (XXIII, vv. 306-7). Kurse në "*Por gjak-hupës nuk ka shkue Shkjau*" (XX, v. 83) motivohet kompozita, trajta tipografike-arkaike me vizë në mes, gjurmë e shkrimeve të kohës.

gjaksore: "mb., këtu kthetrat e përgjakshme" në "*Kuk ngerthye kthetrat gjaksore*" (XVII, v. 367).

gjallue (me): "me jetue". Ku. (61) nuk e njehë si fjalë të LM, por të HD dhe PSH. khs. "*Tue punue e tue gjallue*" (XIII, v. 129).

gjarpnushë: "eufemizëm për pistole, armë brezi" përdorë në "*Vllá e moter dý pistolet / Dý gjarpnusha prej Stambollet'*" (XII, vv. 19-20). Shumica e punimeve marrë në shqyrtim, në këtë studim, janë pajtue se referimi lidhet me formën (e përdredhun) dhe cilësinë (e idhtë, helemuese, ose vrastare si në *Fj.*

Bashk., 138, Kol. 74) e femnes së gjarpnit. De. (482) e përkufizon edhe si *rod arme*. Edhe FGJSH e njeh çuditnisht si lloj arme: “GJARPËRUSHE... 3. poet., vjet. Kobure me tytë të gjatë që është përdorur deri në shek. XIX.” Me gjasë përcaktimi i *Fj. Bashk.*, dhe ilustrimi i fjalës prej Fishtës në poemën e tij, asht shndërrue si ma sipër në *Fjalorin e Gjuhës Shqipe*, ba në komunizëm. Po të mbajmë parasysht botimin e Blënit të parë të *Lahutës* (1905), në kangën *Marash Utsi*, Poeti shkruen: “*Dyy gharpnusha préje Stamollét*”.⁵⁸ Prej botimit të parë e deri në atë përfundimtar (1937), ky varg nuk ka ndryshue aspak përveçse në pikëpamje fonografematike, ku përfshihet periudha para dhe mbas Kongresit të Monastirit. Sikurse me *taralloqen*,⁵⁹ edhe kjo fjalë

⁵⁸ *Lahuta e Maltsiis* (Kânge Populloré), Blëe i pare; s. a, s. d., s. l. Autori, data dhe vendi i botimit nuk dalin në këtë edicion, por ky tashma asht i përcaktuem nën autorësinë e Gjergj Fishtës, shtypë në Zarë (1905).

⁵⁹ Në lidhje me këtë rast kam folë gjanë në “*Fishta, Poet Etern*”, në *Át Gjergj Fishta, O.F.M. Satira [Gomari i Babatasit, Anzat e Parnasit, Nikolejda (dhe krijime të tjera), Taralloqja e Ballkanit]*. Me parathanie dhe nën kujdes të Lisandri Kolës, 5-59 dhe “*Gjergj Fishta nuk asht tallash për koshiqa gazetash*” (*Sbunker*: 13 janar, 2022); <https://sbunker.net/botime/91245/gjergj-fishta-nuk-asht-tallash-per-koshiqa-gazetash/>

mund të jetë kontribut i vetë Fishtës në Fjalorin e Shoqnisë së Bashkimit. Në dijeninë time, *gjarpnusha* nuk di të jetë përdorë kund tjetër në letërsi shqipe, simbas kontekstit fishtian (i cili përshkruen armatimin otoman të shek. XIX), aq sa me u “stigmatizue si fjalë e vjetrueme poetike”. Marash Uci, i cili mbante këto armë, flitet se kishte luftue kundër turqve në betejën e Urës së Rrzhanicës (1880). Shih De.2 (75) dhe *Glosarin e HL*, anglisht (456).

gjedh-i: “bagëti e trashë”, në “*Kúr bâjn gjedhet mritz prej s’ t’ zetit*” (VI, v. 430) ||XXII, v. 253; *ibid.*, v. 219; XXIII, v. 603; XXV, v. 774.

gjí-ja: simbas Lukës (112), kjo fjalë në vargun “*Kam pasë tokë e kam pasë gjí*” (VI, v. 26), asht një shumës i singularizuem prej bazës *gjâ-ja, gjie-ja*. Ky studiues e cilëson si përdorim të rrallë dhe me interes për historinë e gjuhës shqipe. Studiuesi në fjalë nuk e kthjellon shumë, por me sa kuptohet i referohet *gjasë së gjallë, bagëtisë së trashë*. Burimet e masipërme që kam shqyrtue nuk e trajtojnë këtë varg e as këtë fjalë. Logjikue prej kontekstit të vargjeve të Fishtës “*Kam pasë tokë e kam pasë gjí, / Kam pasë dhën e kam pasë dhí, / Kam pasë plemet me tagjí*” (VI, vv. 26-8), referimi lidhet me bagëtinë e trashë

(*gjânë*), e mandej atë të imtën. *Gjâ-ja*, asht shpjegue edhe në *Fj. Bashk.* (137), edhe si *bagëti* por edhe si *kamje*, të pasunit material, begati. Këtë koncept të fundit e ka deduktue përkthyesi gjerman, kisha me thanë, në versionin e tij, siç mund të shihet ma poshtë.

Dy përkthimet në italisht (Parrino,⁶⁰ fasc. II, 4) dhe anglisht e kanë *bestiame* (*ho avuto terre, ho avuto bestiame*) dhe *cattle* (*I owned land and I owned cattle*, 47), që në shqip asht *gjâ*. Së mbrami edhe versioni frangisht i Krasniqit⁶¹ përkon me dy versionet ma nalt: *bétail* (*J'ai eu des terres et du bétail*). Kurse ma heret, versioni gjermanisht i Lambertz-t, 1958, jep një imazh tjetër që nuk përputhet shumë me origjinalin po as me tri variantet e sipërme: "*Hatte Haus und Hof und Boden*"⁶² (42).

⁶⁰ P. Giorgio Fishta, O.F.M., *Il Liuto della Montagna - Lahuta E Malcís* (Prefazione, Commento, Traduzione e Note di P. Ignazio Parrino) Fascicolo Terzo: Prefazione e Canti 16-25. Palermo, Centro Studi Internazionale di Studi Albanesi, Scuola Grafica Salesiana, Palermo, 1971.

⁶¹ Gjergj Fishta, *Le Luth des Montagnes (Lahuta e Malcís)* - Une épopée albanaise. Traduit de l'albanais par Abidin Krasniqi, L'Harmattan, 2019.

⁶² Gjergj Fishta, *Die Laute des Hochlandes (Lahuta e Malcís)*. Übers., eingel. u. mit Anm. vers. von Max Lambertz. München, Oldenbourg, 1958.

gjikue (me, u): “me ndodhë, me qenë shkrue, me u vendosë”. Khs. “*Mbi djelm t’ uej ká me gjikue*” (IV, v. 258); “*N’ kjoftë gjikue me m’ pré Harapi*” (V, v. 111); || XII, v. 173; XIII, v. 280; XIV, vv. 101; 185, 210; XVIII, v. 335; XIX, v. 109; XX, v. 668; XXVIII, v. 38.

gjurmë-a: “për hap, njetas; fig. me shkue mbas veprimt të dikujt; gjurmim, ndjekje”. Shih “*Kah per gjurmë po ndjekë anmikun*” (III. V. 145); || VI, v. 454; XV, v. 43; XVII, v. 576; “*Kah janë lshue mas gjurmve t’ Fratit*” (XIX, v. 320); “*Me sa gjarpnit s’ i a dán gjurmen*” (XVIII, v. 707).

gjyktor/e-ja: “gjykatë, këtu sh.” në “*Tha, pa e çue nder gjykatore*” (XXVII, v. 327).

gjyl/e-ja: “sferë metalike përdorë për artileri, topa luftarakë, në funksionin e një predhe ose si e shpjegon Fj. Bashk. “*brumbullak, bume*” (144)”. Shih “*Gjylja e topit mos me t’ ra*” (VIII, v. 242); || XVII, v. 448; XVIII, vv. 36, 463, 827; XX, v. 775; XXIII, v. 1095; XXIV, v. 280; XXV, vv. 29, 295; XXVIII, vv. 228, 517, 755; XXIX, v. 192.

gjymtue (me): “me sakatue, me lanë të gjymë”, në “*Se trí krena i kan gjymtue*” (XVI, v. 384).

gjyemtuet (i, e, të): “i, e, të sakatuemit, të gjymtuemit, ata që janë lanë me gand” në “*Dnes t’ varruemt, gjimo t’ gjyemtuet*” (XXV, v. 282).

gjytetní-a: “qytetni-a” në “As per t’ marë në gjytetni” (IX, v. 480); || XIII, v. 42; XXVI, v. 354; XXVII, v. 338; XXX, v. 118.

gjytetnim-i: “qytetnimi, civilizimi” në “E giatë shtegut t’ gjytetnimit” (IX, v. 263).

hafiz-i: [përdorë edhe me aferezë *afiz*] “titull fetar në hierarkinë e klerit mysliman; ai që ka nuanë përmendësh Kuranin”. Shih De. 484, Lu. 114; për ma shumë Diz. 324, To. 609. Khs. “Shtrinë t’ ngratin Hafiz Myslimin” (XXVII, v. 343); “Sado qi ishte një “hafiz” (*ibid.*, v. 353); *Jâm shqyptár pergjegjte afizi* (*ibid.*, v. 359).

hân/e-ja: “lloj loje e hershme popullore; konsiderue edhe si lojë barijsh”. Shih De. 484, Lu. 116, Gje. 70, Lam. 184, Pa.¹ 66, El.-Ma. 426 dhe Kras. 92, japin një shpjegim përkatës të kësaj loje. Të gjithë versionet në gjuhë të huej të LM (Lam. 34; Pa.¹ 66; El.-Ma. 35 dhe Kras. 92) e rrujnë shqip këtë leksemë në përkthimet e tyre, së bashku me lojën tjetër në këtë varg: *cic-mic*. Khs. “Kush tue luejtë cic-mic e hâne” (V, v. 34).

haraç-i: “taksë, të dhetat, tribut; pague (simbas kontekstit) prej popullatës së krishtenë ndaj sunduesit, Perandorisë Osmane. Fjala në shqip nënkupton edhe *detyrim* por e cila nuk e përmbushë

peshën kuptimore në tekstin fishtian”. Shih *Fj. Bashk.* 153; De. 485, Gje. 581-2, Lu. 116, Diz. 353, To. 617 dhe Buf.-Ro. 188. “*Kishte dalë me mledhë haraçin*” (XXV, v. 565)

hardallinë-a: “prej *hardall*; përdorë në femnore me gjasë edhe për ekzigjencë rimore: shtatmadh e i përçudnuem”. Shih Gje. 471, Kol. 80, Lu. 117. De. (485) e shpjegon jashtë kontekstit të vargut, sepse Poeti përshkruen personazhin malazez Millosh Pera, e jo një femën si e kthjellon ai kuptimin e kësaj fjale. Si duket ky i mbrami ka ra pré e shpjegimit të *Fj. Bashk.* 154, i cili ruen krejt strukturën e interpretimit që ban De. Khs. “*Betêrr burrë e hardallinë*” (XXIII, v. 97).

hasharí: “mb. i panyjëzuem; i, e, të mbrapshtë, pandigjueshëm; gjaknxhtë”. Shih De. 485, Gje. 38, Lu. 118; ndërkohë edhe shpjegimet e Diz. 366, To. 623 dhe Buf.-Ro. 195 për “*Hasharí, djelm kapisuza*” (XX, v. 632). Kurse *Fj. Bashk.* (27) e paraqet me aferezë *asharí*, por ka një kuptim të ndërdyshitë (*nnoshta ashikrii*) që i referohet epshit, pulsioneve seksuale. Referue vargjeve të Fishtës, kur përshkruen protagonistët e *Lahutës*, termi *belaçuer/or* kishte me i shkue ma për shtat, konotacionin semantik të autorit:

Çuli e Beci, shkrel prej Bzhetet,
 Ki'n pasë kë në dy hasem t' Mbretit,
 Qi kurr dá s' i a ki'n gazepin:
 Herë the xhâden, herë pré telin,
 Gjuej zaptit, nizamin vraja,
 Nis degame kot se i'n gjallë
 Me spahí e me myltazima:
 Hasharí, djelm kapisuza,
 Kahdo shkojshin, kahdo vîjshin
 Dy gur njitë kund nuk i lîjshin. (XX, vv. 625-34)

hat/er-ri: “dëshira, vullneti; qejfi”, jo si te Lu. 118
 “anë, pajë” por te Diz. 368 e To. 623. Khs. “M' a don
 hatri, qi ti m' Shkrel / T'vîjsh e djalit t' m' i a mârrsh
 flokët” (XX, vv. 793-4); “Veç se 'i gjâ deshta me t' poetë,
 / N' kjoftë se hatri s' ka me t' mbete” (XXI, vv. 257-8).

hingllue (me): “zani britës i kalit, i gjokut, i
 kulshedrës, i atit/atkinës, a i mazit në kontekstin e
 LM”. Shih “Kû rrin kali tue hingllue” (VI, v. 259);
 “Hingllojn kualt, turflllojn katanat” (XXIX, v. 190); “Kur
 nisë gjoku me hingllue” (VIII, v. 276); “M' at Bigë
 t'Shalës ká dalë Kulshedra, [...] Tue hingllue e tue
 turfllue” (XVI, vv. 11.16); || *ibid.*, vv. 189.91; “Hingllojn
 mazat, shkrefin vrapin” (XXII, v. 256); “Fort hingllon i
 biri i atkinës” (XXIII, v. 991); “Ç' po shkon ati tue
 hingllue” (XXVIII, v. 390). Kjo asht ndër foljet ma
 interesante të FGJSH, kalue në vetë të parë—

natyrisht si tana tue eleminue infinitin—sepse dukunitë e kafshës (kalit ma së shumti) i kalohen direkt njeriut. FGJSH e ka *hingëllij/hingëlloj*. Të kësaj natyre janë edhe fo. *pëllas, leh*, etc.

his/e-ja: “përkatsí, përpjesí; idiomatizue në formulacionet gjuhësore të mallkimit te LM”. Shih “*Shkimja, Zot, hisen e diellit!*” (XXIII, v. 1051). Khs. *Fj. Bashk.* 161; *Gje.* 508; *Lu.* 119; po ashtu shpjegimet e *Diz.* 391; *To.* 637 e *Buf.-Ro.* 202.

hor/e-ja: “e pandershme, e pamoralshme” në “*Si t’ kish’ kënë ti një grue hore*” (VI, v. 153).

humbatë (me): “me humbë; ndërtim simbas përlijjes së *Fj. Bashk.* (163): *Humas/-atël/-ata, me humatë*”. Shih edhe *Lu.* 120, i cili me sa duket ka ardhë në këtë përfundim, sa i takon vargut “*Serbi vllá do t’ a humbasë*” (XXI, v. 337).

humnerë-a: “hon, greminë” në “*Pse kisht’ kënë vendi humnere*” (XVI, v. 360); || XX, v. 31; XXV, vv. 643, 865; XXVII, v. 753.

hyjzuem (i, e, të): “me yje” në “*Kah t’ u endë shkon rrës s’ hyjzueme*” (XXI, v. 4).

imë: “ndajf. imët” në “*Imë punue, mirë sendergjue*” (XXIV, v. 434).

ileri: “turq. thirrore: përpara, bini” De. 486, Gje. 669; Diz. 414-5; te Lu. mungon. Khs. “Ileri! *vrret komandari*” (XXVIII, v. 746).

istiqam-i: “fortifikim, llogore, istikam”. Shih De. 486, Lu. 122 si edhe Diz. 427, To. 663, Buf.-Ro. 216. Khs. “*Si edhë askjerin, qi ‘istiqamin’*” (XXVIII, v. 173); “*Me u a shperthye turqve ‘istiqamin’*” (*ibid.*, v. 290).

jetshkurtë: “kom., jet(ë) + shkurtë” në “*Por jetshkurtë djali m’ kisht’ lé*” (XXIII, v. 424).

jetshkurtuemja: “kom., jet(ë) + shkurtuemja” në “*Me u stervitë, po, jetshkurtuemja*” (XXIV, v. 52).

kaçorr-i: “kolibe, kësollë, kaçorre”; khs. *Fj. Bashk.* 173, De. 478, Kol. 89, Lu. 124 për “*Shpija e tij ngrefun kaçorr*” (XXIII, v. 178).

kaherë/kahera: “ndajf. para disa kohëve; motit”. Khs. “*Kto kaherë kan kënë vendue*” (X, v. 188); || XVI, v. 116; XII, v. 548; XXV, v. 196; “*Murit t’vrastë i a njeshë. / Kahera Âsht tue u matë me u çue, e mjera*” (XXII, vv. 710-1).

kallamoqisht/e-ja: “arë e mbjellun me kallamboq, misër”, Kol. 91, Lu. 126; për ma shumë shih To. 701. Khs. “*Para shpís, n’ kallamoqishte*” (XXI, v. 479).

kallm-i: “kërcell bime a barishteje, në këtë rast e purrinit/prasit” në “*Si me shkulë ndoj kallm purrinit*” (XXV, v. 861).

kallnduer-i/kallndor-i: “janari, mueji i parë i vitit” në “*Porsi bisha në Kallnduer*” (XIV, v. 299); || XVIII, v. 238.

kamot: shih *kaherë*, në “*Me t’ hasë sot, qi tash kamot / Kam dishrue, manà, me t’ pá*” (XX, vv. 716-7).

kamsí-ja: “term ushtarak, kambSORÍ”, Lu. 127; khs. “*E kamsí, e kalori*” (XXIX, v. 131).

kamsor-i: “te Fishta përdorë për lajmsin a korrierin” në “*E aj kamsori, si vetima*” (XV, v. 23).

kandak-u: “pjesa e mbrapme e drunit të pushkës; qytë”, De. 488, Gje. 21, Lu. 127; shih edhe Diz. 551, To. 791, Buf.-Ro. 269. Khs. “*Krejt n’ argjan kandakut ngrí*” (I, v. 374); || XVII, v. 135; XVIII, v. 625; XX, v. 477; XXII, v. 154.

kandun (me u): “me të pëlqye, me të pasë anda” përdorë në strukturë të përbame foljore në LM: “*Po i isht’ kënë kandun mishi i dhís*” (VIII, v. 29).

Kaos-i: Kjo fjalë në vargun “*Edhë n’ Kaos t’ pa skáj shqimi*” (XXV, v. 890) asht interpretue nga studiuesit—të vetmit ndër sa ma sipër—Gje. 594 e Lu. 127 si rrumujë ose mungesë rëndi. Edhe To. 712, e jep shpjegimin etimologjik nga gr. *xáoç* > [i

mungon lat. *chaos*] > ita. *caos* në përputhje me FGJSH. Nji shpjegim i ngjashëm del edhe te Lu. e Gje., i cili mund t'u jetë referue fjalorëve të kohës së tij ose kuptimit në italisht.⁶³ Mirëpo ajo që nuk kanë vû re komentuesit e Fishtës, asht se emni asht i përveçëm në tekst: **Kaos**. Po paraqes pak ma gjatë vargjet ku ban pjesë vargu ma nalt, që me e kuptue ma mirë kontekstin: “N’ at thellim, po, e n’ at tufâ / Qiella e toka ashtë perzî, / Kishe thânë, se rruzullimi / N’ flauri e n’ leskra po shkatrrohet, / Edhë n’ Kaos t’ pa skáj shqimi / Po sodomët e dermohet” (XXV, vv. 886-91). Për sa ma sipër, shpjegimi i fjalës *kaos* i përket nji botëkuptimi ma modern. Kështu që, Fishta asht autor që e njeh dhe e ka transfigurue klasicizmin botënor në veprat

⁶³ Ndër botimet shqip, para se me u botue ed. i LM nga Gje. me siguri, ka pasë ekzistue dhe nji *Fjalorth Shqip*: përmban fjalë të hueja e të përdoruna ndër libra, fletore, ligjë, shkresa etj. Botime të Shtëpis Botuese “Ora”. Shtypun në shtypshkrojen e Shtëpis Botuese “Ora”, Shkodër, s. d., ku në 47 shpjegohet fjala “kaos” si “*paujdi, të përzim*”. Vrehet se po kështu, identik, del edhe përcaktimi te fjalori i Busetti-t. Shih P. Antonio Busetti S.J. (compilato dal) *Vocabolario Italiano-Albanese*, Scutari D’Albania: Tipografia dell’Immacolata, 1911, 22. “Ora”, ka pasë botue edhe revistën “Cirka” drejtue prej Cuk Simonit, para viteve ’40, kështu që dyshoj se data e botimit të këtij fjalorthi asht para 1945.

e tij. E për pasojë, besoj, se Poeti në këtë varg ka konceptualizue kozmologjinë greko-romake: tanësinë e elementëve pa rënd e pa trajtë gjendë në kozmos. Madje, imazhi fishtian mund të jetë edhe ovidian (prej te *Metamorfozat* e Ovidit). Vargu i tij në librin e parë “*quem dixere chaos: rudis indigestaque moles*”⁶⁴ jep në njëfarë mënyre paskajsinë totale të thellimit: ku ma tej ndërlihet me *abisin* në teologjinë kristiane [shih *Zanafillën*, 1: 2].⁶⁵ Kjo ndërlihdje, me sa duket i ka shpëtue edhe Gje. vetë si përkthyes i Biblës në shqip, e njëherësh si përgatitës i *LM*, botimi

⁶⁴ Khs. një version përkthimor në anglisht “[...] *men have called Chaos: a crude, unstructured mass*” në Ovid, *Metamorphoses*, A New Verse Translation Translated by David Raeburn with an Introduction by Denis Feeney, Penguin Books, 2004, 24. Për fat të keq nuk e kam doresh përkthimin e Henrik Lacajt në shqip (Onufri: 1998), që me e citue.

⁶⁵ Shih versionet gr. vj. e lat. “*Terra autem erat inanis et vacua, et tenebrae super faciem abyssi, et spiritus Dei ferebatur super aquas*” [*Vetus Testamentum, Liber Genesis*. Nova Vulgata, Bibliorum Sacrorum Editio. Libreria Editrice Vaticana, 1979. “*ἡ δὲ γῆ ἦν ἀόρατος καὶ ἀκατασκεύαστος, καὶ σκότος ἐπάνω τῆς ἀβύσσου, καὶ πνεῦμα θεοῦ ἐπεφέρετο ἐπάνω τοῦ ὕδατος*”. *The Septuagint Version of The Old Testament, With An English Translation: And With Various Readings And Critical Notes*. London: Samuel Bagster and Sons, 15, Paternoster Row, 1879, 2. Në shumicën e versioneve shqip të *Zanafillës*, leksema e përdallueme në tekstet ma nalt mungon.

II. Po shtoj se T.T. nuk e ka shpjegimin e fjalës *kaos* në komentarin e tij, e s’do mend as Ku. s’kishte sesi me e pasë.

Kapidan-i: “ita. *capitano*, prijës, princ, drejtues ushtarak ose simbas konceptit kanunor *derë e parë*; antonomazi për Kapidanin e Gjomarkajve të Mirditës”. Shih *Fj. Bashk.* 181, Lu. 128, Diz. 498 e To. 716, për “*Oso Kukë nuk bân mâ nâna / As n’ Begllerë as n’ Kapidana*” (III, vv. 352-3); || XIV, v. 260; “*Mark Milani Kapidani*” (XIV, v. 112); || XVIII, v. 34; XXV, vv. 787, 792; “*Hodo Begu e Kapidani*” XV, v. 57; || *ibid.*, v. 61.

Kapitan-i: “shih ma sipër”. Khs. “*Njata krenë e kapitana*” (III, v. 142); “*Kshtë tha Mirkja, Kapitani*” (IV, v. 173); || IX, vv. 93-4; XV, v. 93; XVI, vv. 59, 236, 454; XX, v. 247; XXIII, vv. 1047, 1072, 1084; XXV, vv. 172, 291, 560; XXIX, v. 189.

kapzherr-i: “gabzherr, gërgilac”, në “*Edhë shi rrânzë njëj kapzherrit*” (XVI, v. 292). Poeti e përdorë edhe në formën tjetër *gabzherr-i*, kur ndërton strukturën simetrike të vargut “*I rá pushka rrânzë gabzherrit*” (XVIII, v. 104) ose idiomën “*Me një zâ sa ká n’ gabzherr*” (XXV, v. 578).

Karadak-u: “turq. Mali i Zi, *kara + dag*” shih Gje. 6, Lu. 129, Diz. 504-5, To. 720. Khs. “*Me bâ Shkodren*

Karadak" (I, v. 59); *ibid.*, v. 150; III, v. 36; V, v. 326; VI, vv. 106, 300, 413; VII, v. 182; XII, v. 24; XIII, vv. 202, 232; XIV, vv. 48, 70; XV, v. 194; XX, vv. 136, 799, 828; XXI, vv. 305; 583; XXII, vv. 9, 153, 190, 274, 497, 632, 765; XXIV, vv. 354, v. 1003, 1122; XXV, vv. 46, 129, 370, 461, 512, 626, 635, 953, 1014, 1121, 1173; XXVII, v. 78; XXVIII, v. 260.

karadake-ja: "mb., malazeze" në "*Mjera nana karadake*" (XIV, v. 343); "*Njekjo Ora karadake*" (XXV, v. 57).

karshi: "ndajf., përballë" në "*Guzon t' dalë karshì nji Mbretit: / Karshì Mbretit e Xhemjetit*" (XXVII, vv. 192-3).

karvan-i: "varg, rreshtue në varg", jo si te Lu. (129), i cili e shpjegon jashtë kontekstit të vargjeve të *Lahutës*, e simbas kuptimit të parë të FGJSH. Vetë ky fjalor e ka huazue shpjegimin me sa duket prej fjalorëve të italishtes. Fjalë me burim pers (Diz., 514/6; To. 727) që ka hy në ita. mandej si *carovana* e gjuhët e tjera neolatine. Shih *Fj. Bashk.* 184, Bu. 178, De. 489, Buf.-Ro. 254. Khs. "*Para e mrapa ushtrín karvan*" (XXVIII, v. 397).

kasap-i: "mishtar, që therë e pret bagëtinë dhe e shet mishin e saj; përdorë figurativisht edhe si i pamëshirshëm, gjakbâs." Khs. "*Po a ti jé, mor', njaj*

Prêlë Tuli, / Qi kasap jé bâ mbi né" (XVIII, vv. 664-5); || XXV, v. 334; "*Si kasapi e ká zanat*" (XXIII, v. 246).

kasaphan/e-ja: "thertore; zakonisht përdorë edhe në kuptim fig. si ma sipër: thernajë", shih "*Po ishte çilë ndo'i kasaphane*" (XXIII, v. 903).

katermdheçe: "mb., formue prej numrit themelor katërmbëdhjetë; dhe në kontekst i përgjigjet *hanës së plotë*", Gje. 541, Lu. 130 për "*E si hana katermdheçe*" (XXIV, v. 733).

kathed/er-ra: "karrige", shih Gje. 418, Lu. 131. Kol. ban një përcaktim krejt jashtë kontekstit të vargut fishtian, tue e nënkuptue kathedrën si "*vend ku jep mësim profesori*" (94). Gjykye nga vargu i Poetit, imazhi asht për dikënd që ka varë fishekët e pushkës në mbështetësen (shpinoren) e karriges: "*Vjerrë fyshket m' kapyell t' katheders*" (XXI, v. 548).

kaurri-ja: "em. prej rrajës *kaurr*; simbas perceptimit të besimit mysliman popullatë e pafé, jomuhumedane, e zakonisht me referencë për kristianët. Kjo e fundit asht gjanësisht e përdorshme, në rënd historik por edhe në gjuhën e sotme shqipe, atë të përditshmem". Shih *Fj. Bashk.* 188, Gje. 369, Lu. 131. Për *kaurr* shih *Diz.* 523, *To.* 737, *Buf.-Ro.* 257. *Khs.* "*Bullat shitë i pat n' kaurri*" (XX, v. 257). Koncepte të tilla kulturore, ndeshen edhe me

nocionin *barbarë* te grekët e vjetër, secila popullsi jogreke; *saraçenët/harapët* te *Kanga e Rolandit*, popullsia muhamedane, *polovcianët* te *Princi Igor* (epikën kievian-ruse të shek. XII), popullsia joorthodokse, muhamedane. Saraçenët dalin edhe në poemën e mavoshme të letërsisë kalorësiake italiane, te *Orlandi i çmendun*.

kerbaç-i: “kamxhik” në “*Kishte dalë me mledhë haraçin / Neper “rajë”, e njânin m’ shkop / Rrah e mbyt: tjetrit kerbaçin / Njeshja ftyrës e varë m’ konop*” (XXV, vv. 565-8).

kercnueshim: “ndajf. arkaike, në mënyrë të kërcnueshme” në “*Qi, kercnueshim ardhë kular*” (XXV, v. 170).

këputë-a: “em. shputa, çorapë të shkurtë leshi”, shih Gje. 421, Lu. 132 në “*Shtjerrë këputa e shtjerrë opanga*” (XXI, v. 630); “*Bâte kputa: a se me shoqe*” (XXIV, v. 49), “*T’ msojshe kputat si me nisë*” (*ibid.*, v. 528).

këputë (me): “fig. me vra dikënd, m’e këputë këso jete; me e lëshue vdekun përtokë”, shih Lu. 136, për “*Matiniqin t’ cill’n e kputi / Gjeto Marku, zëmer-nguti*” (XIV, v. 262-3).

kime-zí: “komp., mb. (qime) kime + (i) zi; i zeshktë, me qime të zeza; del edhe pa motivacion

tipografik [pa vizë në mes, ose përngjitje] *kime zî*" në "Po a thue e ngef njat kime-zî" (II, v. 149); IV, v. 49; IX, v. 228; XVII, v. 550; XVIII, v. 621; XXIII, v. 405; "Rrahman Duli, 'i kime zî" (XVII, v. 385).

kjahmet-i: "kiamet, fundi i botës; dita apokaliptike. Ndërtue te Fishta me tingull epentik (-h-)" në "E njikjo âsht dita e kjahmetit" (XXVIII, v. 634).

kmesë-a: "mjet për me pré ferra a degë të njoma, me bisht të gjatë druni; në krye me teh të kthiyem metalik" në "Grát me kmesa e me supata" (VI, v. 295); "Me kortela, kiza e kmesa: / Gjáll nuk t' lânë me pshtue, qe besa! / Edhe m' kmesë i âsht hapun Shkjau" (XVIII, vv. 442-4).

Knjaz-i: "titull nderi, i përkthiyem zakonisht në shumë gjuhë evropiane si *princ*; hy në sllavishte prej gjuhës së vjetër kishtare; përdorë dendun në LM për Nikollën, princin e mandej mbretin malazez. Kryepersonazh në *Lahutë* dhe te *Nikolejda* dhe personazh i sa kompozimeve të tjera artistike të Fishtës. Në LM del edhe me ë fundore si *knjazë*". E pavend me e dhanë krejt intensitetin numerik të kësaj fjale, e cila përdoret 145 herë në poemën epike. Knjazi nuk duhet me u ngatërrue me Krajlin (mbretin; sllav. *Kralj*, ardhë prej Karlit të Madh si burim) siç vepron Gje. 5, 21, 25, passim. Fishta me të

vërtetë i referohet mbretit të Malit të Zi, por në harkun kohor kur asht kompozue *Lahuta*, 1905-37, Nikolla ka qenë edhe princ edhe mbret, por edhe ka ndërrue jetë në 1921, vitin kur Fishta shkruen *Lugatin*. Sa i takon analizës tekstore, prania gjithkund e *Knjaz*, mundet me çue edhe në një qëllim autorial: për m'ë lanë *Knjaz Nikollën* me status të reduktuem (pra fuqi monarkike të vogël), jo si të shtatë Krajlave në *Lahutë* d.m.th. mbretnit e fuqive të mëdhaja: ai i austro-hungarëve, i gjermanëve, francezëve, italianëve, anglezëve, rusëve dhe turqve.

kobshem (të): “mb., mbëlue me fatkeqsi të madhe” në “*Prej t' kobshmit trishtim qi ká*” (XXII, v. 534).

kobshme (të): “shih ma nalt” në “*Vrrimet t' kobshme, m' nja perzi*” (XXV, v. 669).

kobshim: “ndajf. arkaike, me ndërtim *-shim*; shih si ma nalt” në “*Mâ kobshim randon rreziku*” (XXV, v. 443); || XXVIII, v. 670; XXIX, vv. 228, 269.

kobzâne: “mb., me të njejtin funksion kuptimor si ma nalt, veçse neologjizëm i ndërtuem me kom. *kob + zâ*: me za të kobshëm, ogurzi”; shih De. 488, Gje. 63, Lu. 133 për “*Zû me krrokë një sorrë kob-zâne*” (IV, v. 197).

koçak-u: “kaçak, i arratisun, kryengritës” në “Do koçakë, do cuba malit” (X, v. 98).

Komandar-i: “komandant në ushtri; funksion ushtarak” në “Komandár âsht Mark Milani” (XVII, v. 33); || XXI, vv. 192, 709, 745; XXV, vv. 811, 927; XVII, v. 203; XXVIII, v. 746.

korsull-i: “konsull”, në “Kan hjekë korsull e bajloz” (XXIX, v. 108).

korum/e: “mb., person i gjatë dhe i zi në fëtyrë; te Fishta përdorë për me përshkrue një figurë femnore malazeze në LM: e zeshkët, e mnershme në pamje, me cilësina amazone kisha me shtue” shih *Fj. Bashk.* 203, De. 490, Gje. 478, Lu. 135. Khs.:

Ndersa Janja, e fortë si mushkë:

Nji korume e zezë, shakshine,

Msue me tjerrë e me qitë pushkë,

Ardhë dika’ andej prej Cetine:

Dishkà grue kjo mashkullore:

Âsht turrë shtriga si shkerbé,

Per m’ i a xjerrë taganin dore,

E me têt, po, me i a pré

Gjetos kryet, ajo korume (XIII, vv. 287-94)

kreshtë-a: “1. kurriz mali; 2. qimet në kurriz të dërrit”, shih De. 487, Lu. 137. Khs. “Mas njaj shiut të randë, prej kreshtet” (XVII, v. 319); || XX, v. 573; XXIII, vv. 27, 1076; XXIV, v. 181; XXV, vv. 65, 371, 838, 878;

“Porsi kreshtë dërrit bugár” (XVIII, v. 138); || *ibid.*, v. 177; XXV, v. 127; XXIX, v. 154.

kryekcyem: “gjaknxehhtë, me u nxé shpejt; tosk. *kokëkrisur*” në *“E ká pá, nji Shkjá kryekcyem”* (XXIV, v. 843); *“Mâ kryekcyem e mâ bela”* (XXIX, v. 19).

kryqalí: “dikush që beson në kryq, asht i krishtenë; përdorë edhe *kryqelí*”; khs. *“Shka â Shqyptár e kryqalí”* (XX, v. 759); *“Per « dintár » e « kryqelí »”* (X, v. 378); || XIII, v. 121.

kryqeterthuer: “ndajf., gjithkah, në çdo anë” *“Si me thânë, kryqeterthuer”* (XXIII, v. 474); *ibid.*, v. 679.

krrabë-a: “1. grremç ku varet mishi i copëtuem; 2. qafa e grremçueme e kulshedrës” në *“Edhe mue m’ man mish per krraba”* (VI, v. 35); || X, v. 302; XIII, v. 304; XX, v. 467; XXI, v. 302; *“Qafen krrabë e ká ngërthye”* (XVI, v. 276).

kthet/er-ra: “shih *çapue-çaponi*; nji sinonim i mundshëm vlen për të edhe për rastin figurativ”; khs. *“Mâ s’ do t’ bijte n’ kthetra t’ tija”* (I, v. 126); || *ibid.*, vv. 160, 170; XVIII, v. 599; XXII, v. 190; XXIII, vv. 285, 568; XXV, vv. 416, 985, 1076; XXVI, v. 64; *“E me dhâmbë edhë me kthetra”* (V, v. 405); || XVI, vv. 12, 150, 170, 190, 312, 369; XVII, v. 367; XXIII, v. 717.

kthellhtë: “ndajf., thellë”; khs. *“Per me u strukë mâ kthellhtë nder karpa”* (XVI, v. 296); || XVIII, v. 161; XX,

vv. 411, 773; XXI, vv. 341, 586; XXIV, vv. 394, 421; XXV, vv. 190, 673, 703, 867, 896; XXVI, v. 326; XXVIII, v. 141.

kubur/e-ja: “1. armë brezi; 2. fig. idiomë: kryefortë”; khs. “Çatallue i ká dý kuburet” (II, v. 119); || IX, v. 229; XI, v. 187; XVII, v. 361; XVIII, v. 279; XX, vv. 411, 471, 472, 516; XXII, v. 154; XXIII, vv. 339, 378, 545, 687; “Menden qi m’ a ki’n kubure” (XXV, v. 922).

kullosë-a: “vend me bar ku çohen me kullotë bagëtia” në “Kur, tue i pá n’ kullosë nper arë” (XXII, v. 126); || XXIII, vv. 58, 129, 610; XXIV, v. 612; XXV, v. 775; XXVII, v. 214;

kum/e-ja: gjykue si shkurtim i *kumbar* nga Gje. 479, Kol. 111 e Lu. 141. Kisha me e intepretue si fjalë parazitare si në shprehje *lum miku, loci*, etc., në disa autorë të asaj kohe, e nësa si formë qoftë edhe e shkurtueme ajo ngjanë si huazim prej bks. nga *kum* emën mashkullor, *kumbar*. Ku. e përmendë (123) kur shpjegon pasthirmën “more”, por vend rendor në fjalor të tij nuk i jep. Shih “Edhë, besa, more kume” (XXIII, v. 296); “Besa, or kume, nji trimneshë” (*ibid.*, v. 319).

kung(u)ll-i: “1. bimë barishtore, fryti i së cilës përdoret për ushqim; te Poeti përdorë në formë krahasimi gjithmonë, e me efekt komik, për kryet

ose rrashtat; 2. idiomë, “nuk ecë kungulli mbi ujë”: nuk shkojnë punët (e mendueme mbrapasht) gjithnji në vijë; 3. punim argjendarie, stolim, si në rastin e “gjelave” të sermit”. Khs. “*Si me thye kunguj nper arë*” (I, v 122); || X, v. 332; XX, v. 779; XXIII, vv. 252, 478; “*Dër t’ u hecë kunglli mbí ujë. Porse kunglli, si po thonë, Aj s’ po hecte mbí ujë gjithmonë...*” (XXII, vv. 311-3); “*Me atà « kunguj » sermit shkrî*” (XXIII, v. 692).

kuprrac-i: “koprrac” në “*Njani brac, tjetri kuprrac*” (XXIII, v. 396).

kurvë-a: “1. femën e përdalë; me cene morale; 2. paraqitë në strukturë krahasimi, dhe idiomë njiherësh. Ekziston edhe një shprehje frazeologjike, bisedimore, në zonën e Shkodrës, në lidhje me ngatërresa apo sherre të pamëshirshme: “me e shkye si kurva kopilin”. Edhe Poeti, besoj në një kontekst idiomatik e ka prû: “me u xanë për pemë pakokrra (punë kot) dhe që s’kanë ekuilibër”. Shih “*Uh! Europë, ti kurva e motit*” (XIII, v. 40); “*E rri e haju shoq me shoq, / Si ato kurvat n’ punë kopilash*”. (XXIV, v. 1037).

lakmí-ja: “dëshirë e ethshme për diçka të huej, zili” në “*Qi po kisht’ Knjazi lakmí...*” (XVII, v. 104) || XXII, v. 64; XXVII, v. 226;

lakmue (me): “fo., si ma nalt, me dishrue”. Shih “Mos lakmoni pares s’ huej” (IV, v. 256) || V, v. 484; XIV, v. 125.

laku/uer-ori: “lloj byreku i mbushun me barishte zakonisht, qepë a mish” në “Xueren bukë, xuerën laknorë” (XXI, v. 382).

laskarue (me u): “me u zhelue, me u shkye teshash, petkash si pasojë e dyluftimeve; tos. *lecko/s-hem*”; khs. Fj. Bashk. 226, De. 492, Gje. 328, Kol. 116/3,c dhe Lu. 144. për “Llanash laskarou m’ tagana” (XXIII, v. 728).

lav/er-ra: “puna e kryeme në arë; levrin i tokës, me levrue” “Veç si ‘i dëm, vû n’ laver s’ pari” (I, v. 12); “M’ ká mârrë qét, po, per nêl laver” (IX, v. 441).

leçí-ja: “1. me vû leçí, me ndalue; sanksionim”; 2. Shpallje, sanksion, rregull në “Edhè sod m’ká vû leçí” (IX, v. 446) “Si vû u kisht’ Knjazi leçí” (XVII, v. 19) || XVIII, v. 6; XXVII, v. 319. Të mos ngatërrohet me fo. *me leçitë*, e cila ka nocion kanunor dhe asht e përshkrueme në Kanû të Lekës në nyjën 156 (§ 1179), dhe don me thanë përmbledhtas, përpos përcaktimit në këtë nyje: “me zhbî prej vendit dikënd, me e i heqë çdo tagër e të drejtë; me e përjashtue ose edhe me shkishnue nëse ka referencë fetare”. Për fat të keq kështu e ka kuptue Kol. (117), por ky interpretim

nuk i përgjigjet asnjë vargu në kontekstin e *Lahutës*. FGJSH e njeh vetëm si *lexim*, *këndim* të një letre, libri, etc.

leqe-leqe: “mungon një shpjegim i kësaj fjale nga materialet e shqyrtueme; jepet vetëm te Lu. 145, po atij i mungon si duhet kontekstualizmi si edhe gjetja e krejt frekuencës së këtij mb. ose ndajf. në LM. Tue pá vargjet e poemës në total, ku del kjo pjesë e ligjratës, ajo parakupton ndërtimin paralel *dredha-dredha*, meqë *leqe* asht sh. i *lak-u*. Fishta e përdorë këtë ndajf. për 1. *musteqe* ose *flokë* dhe 2. *punime argjendarie*” Khs. “*Edhë i ká një parë musteqe / Kaçarrel e leqe-leqe*” (IV, vv. 51-2); “*E lavjerrë ato musteqe / Toje toje e leqe leqe*” (XX, vv. 739-40); “*Ajrit flokët lshue leqe leqe*” (XXV, v. 1089); “*Hollë punue në trajtë t’ një gjarpni / Leqe-leqe, prej t’ permendunit / Kujunxhi, Tuke Jakova*” (XX, vv. 806-8).

lerë-a: “shpat me gurë, zallinë, leranë”; shih. *Fj. Bashk.* 229, *Gje.* 448, *Kol.* 119 e *Lu.* 145. Khs. “*Thirr shoshoqes lerë e m’ lerë*” (XXII, v. 491) || XXIII, vv. 224, 367, 383, 417, 533, 566, 600, 635; XXV, vv. 11, 70, 105.

létas: “ndajf., lehtas” në “*Létas nieri mund t’ a dajë*” (XXVI, v. 318).

likurazez: “me lëkurë të zezë, kom. *likurë* + *zez*; përdorë te poeti si etnicitet” në “*Turq, manovë, likurazez*” (I, v. 105).

lkuqë (me): “me u kuqë, marrë ngjyrë të kuqe, formue prej *l* + *kuqë* simetrikisht si në *skuqë, s* + *kuqë*”; shih De. 493, Kol. 120 e Lu. 146. Khs. “*Lkuqë janë kullat e Gusís*” (XVII, v. 224); “*N’ flakë e n’ shkndija lkuqë rri shpati*” (XXII, v. 157).

lmashk-u: “myshk, lym; lloj bimësh të njoma, që dalin nëpër mure” në “*Urth e lmashk per rreth u mlojshin!*” (XXII, v. 583).

lmashktë (e): “mb., fig. të shkuem motit, që i ka mblue lëmashku, vû përsipër koje, shtresë, prej jargëve a gjandrrave pështymore”; khs. Kol. 120 e Lu. 147 për “*Si atà dhâmët e lmashktë t’ kulsheders*” (XXI, v. 549).

loke-ja: “emën në përkëdhelí për nanë, ose një grue të shtyeme në moshë” në “*Se s’ t’ kuritë, jo, lokja e jote*” (V, v. 114); “*N’ at Vraninë, kû t’ zezat loke*” (II, v. 95) || V, v. 110; VIII, v. 16; XIV, v. 328; XVIII, v. 236; XXIII, v. 829.

London-i: “Londra, përdorë nga të vjetrit me këtë ortoepikë. Te LM, kanga e fundit, XXX, mban titullin *Konferenca e Londonit*”. Khs. “*Në London na me u bashkue*” (XXIX, v. 329) || XXX, vv. 25, 38, 46, 86, 329.

lpî/lpÿ/lpye (me): “1. me u lëpî, fshî me gjuhë, dukuní zakonisht për kafshët; këtu, lopa, qeni, ulkoja [dy ulkoja i lëpijnë dorën të Bukurës së Dheut; khs. shembullin e mbramë, ma poshtë]; 2. edhe si idiomë dy herash a) ‘lopët lëpihen me rend’, b) ‘Lpÿshin kryet e xjerrshin sÿt!’ simetrikisht edhe në ‘krue(f)shin kryet e qitshin trutë’, zakonisht përdorë në Shkodër”. Khs. “E se lopët lëpihen me rend...” (XV, v. 166); “Lpÿshin kryet e xjerrshin sÿt!” (XIX, v. 169); “Lpÿhen lopët, po thonë, me rend...” (XXI, v. 600); “M’ tē me lpye qējt e Nokshiqit” (XXIII, v. 838); “Lpÿja doren, lpyja kamen, / Çou m’kamë t’mbrame me i lpy ftyren” (XXIV, vv. 405-6).

luhatë (me): “1. me luejtë bishin majtas-djathtas në shejë lazdrimi, këtu qeni me dangë të bardhë—baloshi; 2. me lëvizë, me tundë” në “Lehtas bishtin tue e luhatë” (XX, v. 729); “Shalë e krahë aj tue luhatë” (XXV, v. 508).

lul/e-ja: “përveçse si emën i përgjithshëm, del edhe si: 1. idiomë, në lule (midis) të ballit, dhe 2. si emën që përshkruen bukurinë apo pashinë fizike të protagonistëve”. Khs. “Tue i a njitë shi m’ lule t’ ballit” (V, v. 248) || XV, v. 107; XXII, v. 877; XXIV, v. 582. “Po, Nikë Daka i Vat Cubakut, / Lule djalit prej zamakut”

(XIV, vv. 278-9); || “Mbasì lule e falka Zoti” (XXIV, v. 160); *ibid.*, vv. 886-7.

lumja (e): “eufemizëm për figurat mitologjike: zanën në këtë rast” në “Pse edhè, e lumja, jam tue pá” (XVII, v. 539).

Ivor/e-ja: “lëvore, lëkurë drunore në kontekstin e v.”; shih “Mjelca bâ me lvore blinit” (XVI, v. 437).

llogje-t: “sh. i llogë-a, shih shpjegimin në 0.7.” Khs. edhe Pa.³ 265, krahas studiuesve citue në nyjën e sipërme. Shih “Me u flakruem trimat rrfé / M’ llogje t’ grisuna t’ mejdanit” (XXV, vv. 48-9). Mb. t’ grisuna, te Fishta dhe në këtë varg duhet me u kuptue si të mundimshme, të thyeshme, të rrëpita, etc. Po të merret parasysh Gje. (561) që llogje e interpreton si logje, pa arsyetim si në llugje vs. lugje ma poshtë, jemi para një momenti të errët interpretimi. Kjo më shtyn me khs. edhe botimin e kësaj kange para se të kryhej në botimin final (1937). *Gjaku i marrun*, asht botue në HD në dy fragmente/epizode (1935, XI/4, Prill, 207-218 dhe 1935, XI/5, Mâj, 245-252). Rezulton se edhe këtu fjala dhe vargu janë identikë (208) si ma nalt, pra në LM, versioni definitiv. Sa i takon ndonji lajthitje të mundshme shtypi, nuk verifikohet. Pra asht llogje, jo logje sh. i log siç ka Poeti shumë

sintagma në poemë me *log mejdani*: “*M’ urë t’ Stutjekës, m’ at log mejdani; Mirë ushtrues n’ at log mejdani; Njekshtë Shkjët n’p’r at log mejdani; Hupë i kan n’ at log mejdani; E t’ i qiti n’ log t’ mejdani; T’ cillt pa rrâ m’ at log mejdani*”. Në këtë pikë, *Fj. Bashk., De., Lu. dhe Pa.*³, janë ma afër një kuptimi se *llogje* asht pyllishte.

llokm/e-ja: “huazim prej turq. *lokma*, e zakonisht shpjegue si *thelë, copë mishi*”. Nji interpretim që e ban edhe Lu. 150 (e me kaq kufizohet dhe To. 919). Por në kontekstin e v. të LM, kjo fjalë duhet me u kuptue si *grykësi*, kafshatë e madhe sikurse e shpjegon Gje. 82. Interpretimet prej te *Fj. Bashk., 244-5, De. 493*, deri te Diz. 596/1, si *qelepir, muft, qyl* etc. jam i mendimit se janë jashtë kontekstit të v. fishtian. Khs. vv. ku përshkruhet *gopçia* e mbretit/zotnisë (Gospodar) e cila asht paralele tham me v. tjetër të po kësaj kange “*N’ thoj t’ pangîshem t’ Gospodarit!*” (V, v. 493):

*Po, a dro, ’imend, mori ju shkina,
I rritët djelmt ju kah Cetina
Per me u mbetun ke Vranina?
Per me u mbetë nen armë t’Shqyptarit,
Veç prej llokmes s’ Gospodarit?... (V, vv. 304-8)*

llomitë (me, u): “fo. prej *llom-i*; me (u) ba llo; me u zbrû m’hû, në dajak, me (u) shkallmue”; shih *Fj. Bashk.*, 245, De. 493, Kol. 127, Lu. 150. Khs. “*Me u rá shpinës e me u llomitë*” (XXI, v. 265); “*Ujë djersitë e krejt llomitë*” (*ibid.*, 631); “*Po u shkelvitishin e u llomitshin*” (XXV, v. 1025).

llugje-t: “sh. i *llugë*; kënetë, batak, baltinë, llucë”; shih *Fj. Bashk.*, 245, De. 493, Lu. 150. Gje. (312) e shpjegon si *lugje*, *lugina*. Nuk arsyetohet kalimi i *l* në *ll*, por as nuk ka përligjje përdorimi në gegënishte e për pasojë sugjerimi asht i pavend. Prania e *ll-së* në disa fjalë si *llogjik/isht*, *ethnollogjik*, *arqeollogji*, etc. asht tipar i autorëve toskë. Kol. (127-8) shpjegon *llugë-a*, e cila nuk ekziston në *LM* dhe zbërthimin e ban jashtë kontekstit të poemës. Khs. “*Por shka kndon njaj zog i zí / N’ ato llugje mí Gusí*” (XVIII, v. 288-9).

llullë-a: “shih *çibuk-u*” në “*Mbasi llullen shkundë i a ká*” (XI, v. 150).

madhnueshim: “ndajf., me mbaresën arkakike - *shim*; në mënyrë madhshtore” në “*Nper mes t’ hyjvet bjen madhnueshim; / Rudinës s’ blerë, në lule shtrue, / Kshtû madhnueshim bjen e Mira*” (XXIV, vv. 738-40).

mahallë-a: “prej turq. *mahalle*: lagje, pjesë qyteti, katundi”; shih Lu. 151, Diz. 602, To. 927 në “*Kush me djalë, kush me mahallë*: (XXVIII, v. 559).

majko: “bks. nanë” në “Kuku, majko! *Gjuka bâni*” (V, v. 251).

majtë (me, u): “1. me trajtue, me ushqye; 2. me mbajtë; 3. me msye, me u drejtue; 4. me qëndrue, mos me u dhanë”. Khs. “*Dý javë vehten e ká majtun, / Bukë prej djerrit aj tue hanger*” (V, vv. 87-8); “*Edhè atin e ká majtun / Tagji urizit n’ strajcë tue i qitun*” (ibid., vv. 91-2); “*Me t’ majtë rob ajo si motit*” (VI, v. 123); “*Na edhè besen i a kem’ majtun*” (X, v. 66) || XVIII, v. 834; XIX, v. 281; XXVI, v. 78; XXVII, v. 257; “*Ke po majshin kah Ponari*” (III, v. 173); “*Tue rritë fmí, tue u majtë fisnike*” (XXVI, v. 314)

malok-u: “malsor; zakonisht përkeqsuese për i pagdhendun, i pacivilizuem” në “*Me malokë cuba shqyptarë...*” (X, v. 105).

mallkue (me): “1. me shkishnue, me leçitë; akt që e kryen meshtari; shih ma të detajuem shpjegimin e Gje. 349; 2. përdorë edhe në konstruke gjuhësore mallkimi”. Khs. “*Me i mallkue pa qiri e leter*” (XIX, v. 294) dhe “*Ehù! mallkue kjoftë njaj n’ Shqypní, / Kjoftë mallkue, po, a plak a i rí*” (IV, vv. 236-7) || V, v. 496; XIII, v. 37; XX, v. 283.

mandaferrë-a: “manaferrë, frut shkurreje, i zi e në trajtë mandi” në *“Molla, urtyta e mandaferra”* (XXVI, v. 217).

mârrtas: “ndajf., me za të marrun, të mekun, përnënza” në *“E si ‘i herë mârrtas ká fsha”* (XXII, v. 628).

mârrët (të): “mb., i marrtë; i pakët, i mekun mezi me u ndigjue” në *“Me ‘i zâ t’ mârrët e si n’ merzí”* (XXII, v. 580).

masë-a: “1. enë që përdorej si njisi matëse e likuideve, zakonisht e venës, shih Lu. 153; 2. përmasë”. Khs. *“Shtatë masë vënë per ditë me i pí”* (V, v. 67); *“Gjanë e giatë per masë të vorrit”* (XXIV, v. 473).

Mash-i/-o: “shkurtim i Marash Ucit”. Shkurtime të tilla në dashamirësi ka disa në LM, si *Rrustja* për Rrustem Ukën etc., por nuk janë hulumtue me qëllim që me i listue në fjalë të mungueme. Për Marash Ucin ndryshon puna se asht protagonist që themelon strukturën e 30 kangëve të *Lahutës*, tue mbajtë vetë emnin e tij. Shih *“Prore Mashi djelmve t’ Hotit”* (XII, v. 34) || *ibid.*, vv. 51, 120, 135; XIII, vv. 97, 155, 161; *“Fol tash, Masho, ç’po na thue?”* (XIII, v. 92); || *ibid.*, v. 255; XXVIII, v. 62; *ibid.*, v. 73.

Mashi përdoret nga Poeti edhe për një protagonist tjetër prej Selce (shih De.² 77), mes

kangëve XX-XXVIII. Khs. “*Por e pá njaj Mashi i Cokut*” (XX, v. 162) || *ibid.*, v. 167; XXI, vv. 222, 223; XXV, vv. 599, 637; XXVIII, v. 90.

mashkullore: “virile, grue me vetí mashkulli; shih *korume*” në “*Dishkà grue kjo mashkullore*” (XXIII, v. 290)

matarue (me u): “me u shtÿ me duer; imazh dyluftimi”. De. 494, Lu. 153 kanë një shpjegim të njëjtë me FGJSH: *me mbarështue, me rregullue*; Gje. 495, e ka *me u ndjekë*. Kol. 132-3, i kushton një vend të gjanë kësaj fjale, i cili për mendimin tim e ka rrokë kontekstin e vargut të *Lahutës*. Ai propozon se kjo fjalë asht ndërtim i *m'+at+anue (me e qitë m'atë anë)*, por ma vonë ka pësue një rotacion e ka dhanë *me matarue*. Shkaqet e këtij rotacioni që përdoret nga autorët gegë, nuk kthjellohen sa duhet nga Kol. Në këtë aspekt çështja lypë një ekspertizë ma të thellueme prej gjuhëtarëve. Gjithsesi Kol. (133/e) argumenton me : “Me u matarue, f.p. = Me u shtymë palët për të largue njëna tjetrën; për t'a shtërngue njëna tjetrën qi të shkoje mâ n'at anë, mâ përtej”. Ndërkohë khs. në poemë “*Njani m' tjetrin; matarohen*” (XXIII, v. 723). Shih njëjën 1 në fo. *me true* ku jepet një pasazh ma i plotë në të cilin gjendet ky varg.

matë (me u): “me u sprovue me dikënd, me u matë, me u përballë ” në “*Turru, gurru, matu, shmatu*” (XXV, v. 283).

mauzerr-i: “lloj pushke, emni i të cilit asht marrë prej kompanisë gjermane që e ka prodhues ‘Mauser’”; shih De. 494, Lu. 154. Khs. “*Vên « mauzerren » mbi sup t’ krahit*” (XXVIII, v. 42) || *ibid.*, vv. 478, 745, 749.

mâz-i: “zogu i pelës; kalë në tre-katër vjetët e para; del edhe pa *a* hundake në *LM*”; shih “*Si ata mâzat neper lâinë*” (VII, v. 141) || VIII, v. 202; XVIII, v. 47; XIX, v. 246; XXII, v. 256; XXV, v. 281.

mehlêm-i/melhêm-i: “në *LM* në sh., ardhë prej turq. bar, medikament në formë pomade që përdoret me lye plagët e me shërue dhimbjet”. Khs. *Fj. Bashk.*, 259, De. 495, Gje. 444, Lok Limthi, 20, Lu. 155, Diz. 638, To. 965, Buf.-Ro. 303. Shih “*Dlirju varrë, vênju mehlêm*” (XXI, v. 366). Te Ku. (118) ky v. del i manipuluem prej origjinalit: “*Dlirju varrë, venju melhem*”. Ai ka shpjegue veç këtë rast, por ka manipulue (sikurse TT. 341) versionin e dytë të kësaj fjale e cila ka grup bashkëtingëllor të ndër-këmbyem -*lh-* vs. -*hl-*; shih edhe v. tjetër në poemë “*Blé melhême i ká edhè bare*” (XXII, v. 396). Rezultati i Ku. tregon edhe për mohim historik-tradicional të një lekseme:

e legjitimueme me dy përdorime. Kështu i ka rëndesh *Fj. Bashk.* që ka anastatikue vetë, *jo për herë të siç pretendon ai*, por mbas edicionit të Prishtinës (Rilindja, 1978).

mejhera: “ndajf. menjherë” në “*Mbi lkurë viji, a çue mejhera*” (XXVIII, v. 66).

mejdani: “log dyluftimi, beteje”. Intensiteti i kësaj fjale asht afro 40 herë në LM [e tepërt me u shënue krejt frekuenca përdoruese] dhe ruen gjithkund të njëjtin kuptim si në “*Kta mâ t’ parët janë n’ fushë t’ mejdanit*” (II, v. 55), përfshî edhe fig. “fitorja” (khs. Gje. 240) për v. “*Shqyptarve u ka mbetë mejdani*” (XV, v. 37).

mejdaxhi-ja: “nji person që asht i vaditun në punë të mejdanit” në “*Vuksan Leka, mejdaxhija*” (XXIII, v. 407).

mendehollë: “mendjemprehtë” në “*Nji kryetollë, por mendehollë*” (XXIX, v. 83).

mengjisë (me): “me sherue, me mengjitë, me u kujdesue, me përtrî”; shih *Fj. Bashk.* 260, De. 495, Gje. 406, Ko. 134-5, Lu. 155. Kjo fo. në thelb ka kuptimin e shorteve popullore: me sherue përmes barnave të përgatituna në formë empirike, pa recetë të mirëfilltë medicinale. Konteksti i vargut nuk e rrahë bërthamën e emnit prej ku vjen, simbas gjykimit tim,

mëngji (magji). Mëngjia asht tjetër ojnë, dhe i afrohet një konteksti kulturor të gjanë ezoterik. Në një formë të tillë deduktive Kol. (135/e), mendon se Poeti e ka përdorë këtë fjalë, me çka nuk jam dakord. Fishta e ka përdorë substancën e mëngjisë, e njohjes praktike të disa fuqive mbinjerëzore, 'alkimiste', në formë satirike të *Dijsja*, por jo në epikë. Unë gjykoj se Fishta në këtë fo. i përgjigjet përdorimit të *Fj. Bashk.*; d.m.th. *me mjekue të plagosunit*, khs. "Të varruemët prap tue *mëngjisë*" (XXI, v. 245).

merdhitë (me): "me pasë shumë të ftohtë" në "Neper shtat e tue merdhitë" (XXII, v. 518).

mifë (me): "trajtë nëndialektore e zonës së Mirditës; me mihë, me rrëmihë me shat, bel", përdorë në poemë në trajtë idiomatike "Per mos daçim me mifë n' ujë" (XXVII, v. 124); pra me ba punë kot.

miqasí-ja: "lidhje ndërfamiljare, që kanë dhanë e marrë njeni me tjetrin: me u miqsue" në "Le t'a dajë me miqasí..." (XVIII, v. 801); "Famullí e miqasí" (XIX, v. 135).

miqsue (me u): "fo. shih ma nalt" në "Me ndo'i Shkjá me u miqsue" (XXII, v. 336).

Mirat (të): "herë përdorë edhe si emën i përgjithshëm, jo i përveçëm [inkonsekuencë

tekstore], i cili nënkupton figurat mitike (në formë eufemike) të Zanave/Orëve" në "*Kishin dalë t' mirat per lule*" (XXIV, v. 466) || *ibid.*, v. 687; "*Kan me i lodhun sÿt, të Mirat*" (XXIV, v. 610) || *ibid.*, vv. 720, 1066.

mirfillit: "ndajf. shumë mirë, ua din mirë fillin, me siguri". *Fj. Bashk.* (268) e bjen si përdorim të Bogdanit për herë të parë në letërsinë shqipe". Khs. "*Punët e njerzve i njef mirfillit*" (XIV, v. 120).

Miri (i): "Zoti, Perëndia; neologjizëm i Poetit"; shih Gje. 129, Kol. 137, Lu. 157 në "*S' din kush gjâ, posë njetij t' Mirit*" (VIII, v. 67).

mishrir(ë): "metagrafe e arkaizueme për mëshirë". Khs. "*Kí mishrir, deh ! per kta t' mjerë*" (XIX, v. 365); "*Kí mishrirë per ta, pra, o Zot !*" (*ibid.*, v. 365) || "*Zot, mishrirë të keshë per mue*" (XXII, v. 769).

mitraljoz-i: "mitraloz, armë automatike" në "*M' mitraljoz ç' t' i a dha atÿ askjeri*" (XXVIII, v. 301) || XXIX, v. 107; *ibid.*, v. 129.

mixhë-a: "axhë, tosk. xhaxha" në "*Ká thânë plakut: Halláll, mixhë!*" (XXI, v. 589).

mizë-a: "1. insekt, thnegla (këtu); ndërtim identik në tri rastet e LM; 2. neo. fishtian, *mizë me mizë* si sturkturat paralele *turra-turra, hova-hova, vrunduj-vrunduj, mendoj*"; khs. edhe Lu. 158. Shih "*Porsi miza per kercunë*" (X, v. 170) || XXIII, v. 1057;

XXV, v. 116; “*Msÿn Bozhiqi mizë me mizë*” (XVIII, v. 480).

mjekerr-bardhë: “kom. *mjekerr* + *bardhë*; kuptim fig. një i ditun, që i pleqnon punët” në “*Pse pat thanë një mjekerr-bardhë*” (XIV, v. 356).

mjellmë-a: “shpend ujit e kangëtar” në “*Dejka, mjellme e n’ shtek kojri*” (XXVI, v. 104).

mjesditë-a: “mesditë” në “*Ka një dash n’ mjesditë m’ i a pjekun*” (V, v. 69); “*Prej mjesditet tue rá dielli*” (XII, v. 130).

mkâmë (me, u): “me (u) përtrî; me (u) ngjallë, me (u) çue në kambë”; inkonsekuencë ortografike (*mkâmbë, mkâm, mkam*)” khs. “*S’ âsht me mkâmbë veç gjûhët e hueja*” (IV, v. 264); “*Por nuk mkâmet, jo, ‘i Shqypni...*” (VI, v. 244); “*Qÿsh s’ t’ u mkam ky turp një hera*” (XXII, v. 622) || XXVII, v. 196; XXX, vv. 106, 272.

mlysh-i: “lloj peshku” në “*Mlysha, njila e krapuliq*” (XXIII, v. 1013).

mindash-i: “mëndafsh” në “*Shllungës së flokvet, fijos s’ mindashit*” (XXIV, v. 726).

mnijti (i): “i urryemi, i përnmijti” në “*Se po e msÿte i mnÿti Shkjá*” (XVIII, v. 488).

Moskov-i/Miskov-i: “Rusia, cilësue simbas emnit prejardhë prej Moskës”. Khs. “*M’ qafë per ditë tue i mbetë Moskovi*” (I, v. 34); *ibid.*, vv. 64, 152, 153;

IV, vv. 76, 94, 192; V, v. 222; XIII, v. 146; XV, v. 142; XXIII, v. 744; XXV, v. 250; XXVII, v. 241; XXX, v. 114; “*Me Miskov Turku ka’ u prë*” (VII, v. 16).

msÿ (me): “me sulmue, me i ra në qafë dikujt për dicka” në “*N’ dashtë t’ a msÿjn Krajl edhë Mbret*” (I, v. 118). Simbas këtyne kuptimeve del edhe 129 herë të tjera në LM.

mshâme (t’): “me një të ngulun të fortë” në “*E me ‘i t’ mshâme Shtozovallet*” (XXIV, v. 966).

mshî: “me fshî, me kuptim fig. me farue, me rrafshue” në “*Fund e maje tue e mshî mbarë*” (XXVII, v. 243); “*Me gjith t’ bir’ dikur e mshiu*” (XXVIII, v. 733).

m’tëni: “variant i *mtani*: thirrje për luftë, *bini*” në “*M’ tëni, burra, e mos e lshoni !*” (XXV, v. 161).

muhamedan-i: “pjesëtar i besimit mysliman”. Khs. “*Pse, si t’ kshtënë, si muhamedan*” (XXI, v. 288) || *ibid.*, v. 365; XXX, v. 254.

mullë-a: “1. mullëz, stomak, zhabë, mullëza e barkut; 2. kuptim fig. në strukturën *cullë e mullë*, rropollí; githçka”; shih *Fj. Bashk.*, 280, Leotti 126,⁶⁶ De. 496, Gje. 462, 544, Lu. 161. Khs. “*I âsht derdhë*

⁶⁶ Dott. Angelo Leotti, *L’Albanese parlato [cenni grammaticali/vocabolario albanese-italiano – italiano-albanese]*, Ulrico Hoepli, Milano, 1916, 126.

mulla nper rragam" (XXII, v. 866); "*Cull e mullë, shka i kisht' shpëtue*" (XXIV, v. 810).

mullar-i: "grumbull sane, dushku etc., i rrasun në hû rreth e rrotull, e që përdoret për bagëti në kohën e dimit. Këtu përdoret fig. për madhësinë trupore, gjithmonë me anë të një krahasimi sasior 'sa'". Khs. "*Betër shtatit sa 'i mullár*" (XVIII, v. 659); "*Ësht purë Shkjau sa i mullár dushku*" (*ibid.*, v. 761).

mundash-i: "shih *mndash-i*" në "*Lnuru flokësh fijesh s' mundashit*" (XXIV, v. 335).

mustakgiat(ë)-i: "kom. ndërkue prej *mustak + giatë*, me funksion mb. dhe përshekruen, cilëson tiparet e një personi me mustakë të gjatë; del edhe me vizë në mes por edhe pa të"; shih "*Ndalo, Vulo, mustak-giati!*" (III, v. 32); "*Mark Milani, mustakgiati*" (XXII, v. 99).

mustakshgup(ë)-a: "kom., neo. fishtian simbas *mustak + shtupë*, në funksion cilësues për shpeshinë e mustakut; mungon viza në mes e kom." në "*Mustak shtupa, flok-iriqi*" (XXIII, v. 864).

musteqezi-u: "ndërtim si ma sipër, *musteqe + zi*, tue cilësue ngjyrën e mustakut; kom. me dhe pa vizë"; shih "*Kaleshan musteqe-zí*" (XIV, v. 74); "*Me 'i t' Plaonjanë, musteqezi*" (XXI, v. 38).

mzdrak-u: “mëzdrak/mazdrak, topuz”. Te Ku. (127) asht dhanë vetëm për PP, dhe asht shpjegue gabim si *heshtë*. Khs. Gje. 612, Lu. 154 për vargun leonin “*Njani m’ mzdrak, tjetri m’ çomak*” (XXVI, v. 144).

namë-rrfé-ja: “kom., neo. i Fishtës përmes *namë* + *rrfé*; kondensim kompozicional me efekt metaforik tue eleminue simbas meje krahasimin cilësor ‘si’ e tue sjellë një debat në mungesën strukturore të 8 rrokëshit këtu. Vargu ka rimë oksitone, por në njehjen metrike fjala *namë* [herë edhe me hundake *nâmë* në LM]” del nji rrokëshë, pra “ë-ja fundore nuk llogaritet rrokje. Khs. p. sh. *Kur t’ i ndiejsh tue nâmë martinat* (XIV, v. 104), i cili asht tetësh i pastër. Po ndryshe ndodhë me të njejtën strukturë, e cila ashtë në pozicion rime *T’ mos t’ i lâinë çikat me name* (III, v. 124)”. Në lidhje me këtë kom. khs. “*Qi na rá kjo namë-rrfé*” (XX, v. 399).

ndollë (me): “trajtë arkakike gegë, zakonisht ndër autorët katolikë, me ndër këmbim (*ll* vs. *dh*) sikurse edhe për *xh* vs. *gj*, *ç* vs. *q*. Shih për ma shumë, *Keze të hueja* [Fiorentia, 2020], shënimet e mia. Në LM në kuptimin: me qëllue, me rastisë, me u ba”. Shih modelin e v. “*Pse edhë i urtë aj kishte ndollë*” (I, v. 312)

i cili përsëritet simbas kuptimeve na nalt edhe 30 herë të tjera në poemë.

ndermjetsí-ja: “titulli i kangës XXI në poemë, e përdorë dhe dy herë të tjera në LM; ndërhyrje për me zgjidhë një mosmarrëveshje; akt i ndërmarrun me mbyllë një çështje konfliktuale”. Khs. “*Se po lypi ndermjetsí*” (XXI, v. 173); “*Ndermjetsí as peng nuk priten*” (XXIX, v. 110).

ndjegull-a/njegull-a: “mjegull, në trajta të shkrueme” Khs. “*Forta ndjegull paska rá*” (XIV, v. 3); “*Hypi tym e hypi njegull*” (XVI, v. 341) || XVII, v. 337; XX, v. 10; XXI, v. 90; XXII, v. 259; XIII, v. 1100; XXV, v. 287; XXVIII, v. 683; XXIX, vv. 138, 326.

ndjehë (me): “me gdhî, me u çue prej gjumit” në “*Kû me ndjehë dote seicilli*” (XVII, v. 77) || *ibid.*, v. 83; XXI, v. 694.

ndokah(ë): “*ndajf.*, në ndonji kahje a drejtim”; shih “*Per me shkrepe ndokahë t’ e vona*” (II, v. 175); “*Kputë ndokah, po shâmej zallit*” (XX, v. 20) || *ibid.*, v. 27; XXX, v. 323.

ndora: “*ndjaf.* mbase një formë e arkaizume e *saora/sa ora*: menjherë, fill”. Shih “*N’ Durmitor, edhë sa ndora*” (XXV, v. 19); “*Edhë âsht zhdukë atÿ sa ndora*” (*ibid.*, v. 124).

ndragë (me): “siç e ka vû re Lu. (165) saktë, përdoret si dubletë, pra në strukturën mbrendarimore, dhe nënkupton me u përbaltë, me u përloçë”, shih edhe De. 497, Gje. 94, Kol. 147-8 në “Lagë e ndragë e djerzët tue i shkue” (VI, v. 11); “Lagë e ndragë, si isht’ kënë i shkreti” (*ibid.*, v. 53).

ndreqë (me): “1. me ba gati, me përgatitë (vaktin/ushqimin), me kthye bukë: zakonisht përdorë nëpër malsina të Veriut; 2. me rregullue; 3. e mbyllun, e goditun [e ndrequn], e mbarueme, përdorë nga Poeti në nëndialektin e Nënshkodrës”. Khs. “Shpejt m’ u a ndreqë darken Drangojve” (XVI, v. 422) || *ibid.*, vv. 473, 488; “Me ndreqë « tabe » edhë llogore” (XXI, v. 397) || XXIII, v. 532; XXVII, v. 112; XXX, v. 125; “Ajo â e ndreqne e hî n’ tebojë” (XXX, v. 124).

ndrik/ëll-lla: “ndrikull, përdorë në poemë në sh. *ndriklla*; nunesha, por në këtë rast e ama e fëmijës, të cilit kumbara i ka marrë flokët. Ky asht akt i njohun në KLD, në nyjen e Shëngjonisë (107, § 709-130), i kodifikuem ndër katolikë dhe i zbatueshëm edhe sot e kësaj dite edhe pse në formë të reduktueme”. Shih “Kan per t’ rá ndriklla e miksha” (XXIV, v. 630).

ngallnim-i: “ngadhënjim-i” në “Veç ngallnimi i njaj ideje” (XXX, v. 248).

ngopë (me): “toskizëm për *me ngî, me fâ barkun*— metafora asht për *me thithë* sikur rriqna; këtë folje e ka edhe *Fj. Bashk.*, 294. Në *LM* asht përdorë krahas edhe në kuptim fig. për *me mbushë, me mbëlue me ar*”. Khs. “*Me gjak t’ onë, qi rrin e ngopet*” (VI, v. 184); “*Por se i cilli me ngopë barkun*” (XXIV, v. 1033); “*Sa per t’ ngopë me ár Parín*” (VI, v. 303).

ngranë (me): “me hangër, me u ushqye”. Simbas modelit të v. “*Dikû ngranë, dikû pá ngranë*” (I, v. 78) përdorë edhe 42 herë të tjera në vepër, tue përfshî edhe format mbiemnore (*i, e, të*) *ngranme* apo pjesore *me ngranun*. Opozicioni vargor i masipërm (*ngranë* vs. *pa nganë*) del edhe në disa raste tjera tue ndërtue kështu një varg të stereotipizuem, gja për të cilat Fishta njihet shumë në veprën e tij poetike.

ngrofë (me): “me nxé, mbajtë ngrohtë, në kuptim fig. me rritë të keqen, metaforikisht e simbolikisht gjarpnin; me i krijue kushte të përshtatshme me u rritë”, shih Lu. 167. Khs. “*Edhë ngrofë gjarpnin në gjí...*” (VI, v. 49). Kjo folje, në këtë strukturë mendimi, asht gati paradigmatiche sepse Poeti e përdorë edhe në poemën e tij të pambaruem, *Mojs Golemi i Dibers e Delì Cena* kur thotë “*Po, dy Turq, dy jeniçerë, / Dy gjarpîj tânë helm e vnerë, / Nder mâ t’ idhtë qi ngrofte Azija*”.

ngurrta: “ndajf. me ngurrim, pjtas: në mënyrë të mpíme” në “*Ngurrta dredhte n’ ajr taganin*” (XXIII, v. 201).

ngutshem: “e kundërta e ma sipër, me ngut, nxitim, hov” në “*E lshon ngutshem m’ i a krasitë*” (XXIII, v. 420).

Nikica: “1. variant i Fishtës përdorë me përtallje për Nikollën e Malit të Zi; në sllavishte përdorë si emën i tij kur ka qenë i ri” 2. antonomazi për malazezët, njerëzit e Knjaz Nikollës, që luftojnë kundër shqiptarëve”; shih De2 86, Lu. 168. Khs. “*Me njat shkrolë qi e shkroi Nikica*” (IV, v. 220); “*Kishte pasë nji farë Nikicet*” (XVIII, v. 685).

Nikollë-a: “Princi e ma vonë Mbreti malazez”. Përdorë dendun nga autori në poemë (58 herë) edhe si *Nikolli*, po të shumtën me parashtesën Knjaz(ë). “*Knjaz Nikolla, ‘i gerxhelí*” (I, v. 50).

nipní: “emën përmbledhës i *nip*, në kuptimin e tanësisë së nipave, këtu mbasardhësve” në “*Qi të mûjshe vetë nipní*” (XXX, v. 7).

nishanxhí-ja: “dikush që ka shêjë të mirë, shenjestër” në “*Por, rrezik ! se ‘i nishanxhí*” (XXVIII, v. 730).

nozull-i: “turq., ushqim, zakonisht ushtrie” në “*S’na vjen nozull as tagji*” (XXI, v. 439); “*Topa e nozull*”

lânë permbra” (XXV, v. 911). Khs. De. 498, Gje. 414, 595, Kol. 155, Lu. 168, Diz. 721, To. 1067.

nzitë (me): “me ngacmue, nxitë, cytë etc.” Khs. “*Por m’e nxitë, por m’e merzitë*” (I, v. 201) || III, v. 288; XVI, v. 284; XX, v. 442; XXII, v. 175; XXIII, vv. 724, 966; XXV, vv. 277, 325; XXIX, vv. 144, 145.

[vijon]